



**QKRMT** Qendra Kosovare për Rehabilitimin  
e të Mbijetuarve të Torturës  
**KRCT** The Kosova Rehabilitation  
Center for Torture Victims

# TË DREJTAT E NJERIUT NË INSTITUCIONET KORREKTUESE NË KOSOVË

**RAPORT MONITORIMI  
2023**

Raporti i pesëmbëdhjetë vjetor  
Prill 2024, Prishtinë

Monitorimi i të drejtave të njeriut  
në institucionet korrektuese mbështetet nga:

**SIGRID RAUSING TRUST**





**QKRMT** Qendra Kosovare për Rehabilitimin  
e të Mbijetuarve të Torturës  
**KRCT** The Kosova Rehabilitation  
Center for Torture Victims

# TË DREJTAT E NJERIUT NË INSTITUCIONET KORREKTUESE NË KOSOVË

## RAPORT MONITORIMI – 2023

Monitorimi i të drejtave të njeriut  
në institucionet korrektuese mbështetet nga:

***SIGRID RAUSING TRUST***

Raporti i pesëmbëdhjetë vjetor  
Prill 2024, Prishtinë

Monitorimi i institucioneve korrektuese dhe sistemit gjyqësor në Kosovë është aktivitet që mbështetet nga Sigrid Rausing Trust (SRT) në kuadër të mbështetjes institucionale të QKRMT-së.

Ky projekt menaxhohet dhe zbatohet nga Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës (QKRMT).

Vlerësimet dhe mendimet e shprehura në këtë raport janë përgjegjësi e Qendrës Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës – QKRMT, dhe jo domosdoshmërisht pasqyrojnë pikëpamjen ose qëndrimet e SRT.

Vlerësimet, konkluzionet dhe rekomandimet në këtë raport janë rezultat i punës monitoruese dhe avokuese të ekipeve multidisiplinare të QKRMT-së gjatë vitit 2023.

2024 © Të drejtat autoriale i përkasin QKRMT-së. Ndalohet kopjimi, ri-prodhimi, publikimi i pa autorizuar, qoftë origjinal apo i modifikuar në çfarëdo mënyre pa lejen me shkrim nga QKRMT.

**Autore:**

Fatmire Haliti

**Kontribues:**

Mehmet Musaj dhe Rrezarta Aliu

**Redaktore:**

Feride Rushiti

**Monitoruesit:**

Feride Rushiti  
Fatmire Haliti  
Fisnik Mehmeti  
Rrezarta Aliu  
Muhamed Abdyli  
Fatime Gërxfhaliu  
Fatmir Musliu  
Arbrore Tërnavë  
Edona Mushica

# PËRMBAJTJA

Shkurtesat .....	7
<b>QKRMT - QENDËR REFERENTE PËR TË DREJTAT E NJERIUT .....</b>	<b>8</b>
<b>PËR HERË TË PARË KOMPENSOHET VIKTIMA E DHUNIMIT NË BURG / Histori suksesi:</b>	
<b>QKRMT përfaqësoi suksesshëm të burgosurin – viktimë e dhunimit në burg .....</b>	<b>10</b>
<b>MANDATI, METODOLOGJIA DHE QËLLIMI I MONITORIMIT .....</b>	<b>13</b>
Mandati .....	13
Metodologjia .....	14
Parimet e monitorimit .....	14
Llojet e vizitave .....	16
Monitorimi i Institucioneve Korrektuese .....	17
Vizitat monitoruese të realizuara në Institucionet Korrektuese gjatë vitit 2023 .....	18

## **AVANCIMI I TË DREJTAVE TË PERSONAVE TË PRIVUAR NGA LIRIA – Progresi gjatë vitit 2023 .....**

1. Rritja e buxhetit vjetor për investime kapitale .....	21
2. Projektimi i ndërtimit të objekteve të reja korrektuese .....	21
3. Emërimi i drejtuesve të institucioneve korrektuese .....	22
4. Rekrutimi i oficerëve të rinjë korrektues .....	22
5. Hapja e Institucionit shëndetësor për trajtimin e personave me nevoja të veçanta .....	22
6. Organizimi i mësimit special për të miturit .....	22
7. Arritjet e Shërbimit Korrektues në luftimin e kontrabandës dhe korrupsionit .....	23
8. Puna e të burgosurve jashtë institucioneve korrektuese – histori suksesi .....	23

## **PËRMbledhja e Gjetjeve të Përgjithshme – 2023 .....**

1. TRAJTIMI I PERSONAVE TË PRIVUAR NGA LIRIA .....	27
1.1. Vendosja dhe trajtimi i kategorive të ndjeshme (kategorizimi) .....	28
1.2. Trajtimi i rasteve të abuzimit seksual .....	30
1.3. Trajtimi i përdoruesve të substancave narkotike .....	33
1.4. Vendosja dhe trajtimi i kryerësve me çrregullime mendore .....	34
1.5. Institucioni Shëndetësor për Trajtimin e Personave me Nevoja të Veçanta në QK Dubravë (Pavioni D) .....	37
1.6. Lëndimet, vetëlëndimet, vetëvrasjet dhe vdekjet në burgje .....	39
1.7. Mbipopullimi .....	41
1.8. Përdorimi i forcës dhe keqtrajtimi .....	44

1.9. Vendosja dhe trajtimi i të paraburgosurve .....	49
1.10. Ekzekutimi i masës së vetmisë .....	50
1.11. Trajtimi i kërkesave dhe ankesave të të burgosurve .....	51
1.12. Bastisjet e qelive .....	52
2. KUSHTET MATERIALE .....	53
2.1. Ushqimi dhe kuzhina .....	56
3. SHËNDETËSIA NË BURGJE .....	58
4. PROGRAMET DHE AKTIVITETET .....	61
4.1.Shkollimi .....	64
5. ÇËSHTJE TJERA TË MONITORUARA .....	65
5.1 Kapacitetet e institucioneve korrektuese dhe kushtet e punës së stafit .....	65
5.2. Marrëveshja me Danimarkën për dhënien me qira të Qendrës së Paraburgimit në Gjilan ..	65
5.3. Puna e Panelit për Lirim me Kusht .....	66
5.4 Monitorimi i seancave gjyqësore .....	67
5.5. Avokimi dhe ndihma ligjore e QKRMT-së .....	67
<b>RAPORTET E VEÇANTA NGA MONITORIMI I INSTITUCIONEVE KORREKTUESE – 2023 ..</b>	<b>69</b>
1. QENDRA KORREKTUESE NË DUBRAVË .....	71
2. BURGU I SIGURISË SË LARTË .....	77
3. QENDRA KORREKTUESE NË SMREKONICË .....	81
4. QENDRA KORREKTUESE PËR FEMRA NË LIPJAN .....	88
5. QENDRA KORREKTUESE PËR TË MITUR NË LIPJAN .....	93
6. QENDRA EDKUKATIVE KORREKTUESE PËR TË MITUR NË LIPJAN .....	96
7. QENDRA E PARABURGIMIT NË PRISHTINË .....	100
8. QENDRA E PARABURGIMIT NË GJILAN .....	106
9. QENDRA E PARABURGIMIT NË PEJË .....	112
10. QENDRA E PARABURGIMIT NË PRIZREN .....	117
<b>Përbushja e rekomandimeve nga Raporti vjetor për vitin 2023 .....</b>	<b>122</b>

# SHKURTESAT

<b>BSL</b>	Burgu i Sigurisë së Lartë
<b>DShB</b>	Departamenti Shëndetësor i Burgjeve
<b>IPFK</b>	Instituti i Psikiatrisë Forenzike të Kosovës
<b>LESP</b>	Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale
<b>MD</b>	Ministria e Drejtësisë
<b>MSh</b>	Ministria e Shëndetësisë

Pavioni D – Institucioni Shëndetësor për Trajtimin e Personave me Nevoja të Veçanta

<b>PGjH</b>	Pavion gjysmë i hapur
<b>PLK</b>	Paneli për Lirim me Kusht
<b>QEK</b>	Qendra Edukative Korrektuese
<b>QK</b>	Qendër Korrektuese
<b>QKF</b>	Qendër Korrektuese për Femra
<b>QKM</b>	Qendër Korrektuese për të Mitur
<b>QKRMT</b>	Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës
<b>QKUK</b>	Qendra Klinike Universitare e Kosovës
<b>QP</b>	Qendër Paraburgimi
<b>ShKK</b>	Shërbimi Korrektues i Kosovës

*I/e burgosur* – i referohet personave të privuar nga liria që gjenden në institucionet korrektuese, duke përfshirë të dënuarit dhe të burgosurit.

# QKRMT - QENDËR REFERENTE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës (QKRMT), këtë vit shënon 25 vjetorin e themelimit. Gjatë ekzistencës së saj, QKRMT ka mbi 17 vjet përvojë në monitorimin e vendeve të privimit nga liria, ku deri më tani ka realizuar mbi 250 vizita monitoruese dhe ka intervistuar mbi 4000 persona të privuar nga liria. Bazuar në gjetjet e vizitave monitoruese, QKRMT ka publikuar raporte të rregullta vjetore. Ky është **Raporti i 15-të vjetor: “Të drejtat e njeriut në institucionet korrektuese.”**

Raportet vjetore janë nxjerrë në bazë të vizitave të drejtpërdrejta monitoruese, kontaktet me familjarët dhe avokatët e të burgosurve, bisedave telefonike me të burgosurit, takimet me stafin e institucioneve korrektuese dhe drejtuesit e Shërbimit Korrektues të Kosovës, si dhe komunikimit me akterët relevant.

Raportet e monitorimit të QKRMT-së shërbejnë për gjenerimin e veprimeve konkrete nga institucionet vendimmarrëse dhe gjetjet e saj janë referencë e raporteve ndërkombëtare, duke përfshirë citimin e rregullt nga Raporti i Departamentit të Shtetit Amerikan mbi Praktikën e të Drejtave të Njeriut; Raporti i Progresit i Komisionit të Bashkimit Evropian; Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës; Raporti vendor i shoqërisë civile për të drejtat e njeriut në Kosovë, etj.





# PËR HERË TË PARË KOMPENSOHET VIKTIMA E DHUNIMIT NË BURG



## Histori sukcesi: QKRMT përfaqësoi suksesshëm të burgosurin – viktimë e dhunimit në burg

QKRMT që nga viti **2014** ka mbështetur viktimën që është dhunuar seksualisht në burgun e Dubravës. Përveç shërbimeve rehabilituese, viktimë është përfaqësuar edhe në proceset gjyqësore në kërkim të drejtësisë për atë se çfarë i kishte ndodhur në vitin 2014.

Në **shtator 2023**, Gjykata Themelore në Prishtinë, pjesërisht ka aprovuar kërkesëpadinë e viktimës dhe ka njohur të drejtën e tij për kompensim të dëmit për shkak të mosveprimit sipas përgjegjësiave ligjore të sigurisë në institucionet korrektuese dhe keqtrajtimin ndaj tij që i kishte ndodhur në vitin 2014. Sipas Aktgjykimit të gjykatës, Ministria e Drejtësisë si përgjegjëse e Shërbimit Korrektues të Kosovës, detyrohet ta kompensojë viktimën për shkak të dhimbjeve shpirtërore, dhimbjeve trupore dhe për shkak të cenimit të dinjitetit dhe nderit.

Pas plotfuqishmërisë së Aktgjykimit, Ministria e Drejtësisë e kompensoi viktimën, ashtu siç ishte paraparë me Aktgjykim.

Ky është rasti i parë i këtij lloji, ku gjykata i bën përgjegjëse institucionet shtetërore për shkeljet e të drejtave të të burgosurve.

Ky rast strategjik do të jetë referencë për çdo shkelje të të drejtave të personave të privuar nga liria.



***Fillimi i një rrëfimi të tmerrshëm: Një djalë i ri u dënua me një gjobë prej 400.00 eurove, duke filluar kështu një rrugëtim ku vuajtjet dhe sfidat do të shndërroheshin në pjesë të padiskutueshme të jetës së tij!***

Një i djalë i ri ishte dënua me dënim me gjobë në shumë prej 400.00 euro. Për shkak të kushteve të dobëta ekonomike nuk kishte arritur që ta paguante gjobën dhe për pasojë gjoha iu shndërrua në dënim me burgim prej 22 ditësh. Në shtator të vitit 2014, me urdhër të gjykatës ishte arrestuar dhe ishte dërguar direkt në Qendrën Korrektuese në Dubravë për ta vuajtur dënimin prej 22 ditëve.

Përshkak të mbipopullimit të burgut, atij ju sigurova vetëm një dyshek dhe u vendos në një dhomë me katër të burgosur të tjerë të cilët kishin dënime të gjata prej disa vitesh duke bërë kështu që në fillim të pranimit të shkelen kriteret bazë për sistemimin e të dënuarve.

I riu që në fillim të vendosjes në këtë dhomë kishte filluar të ngacmohet nga të burgosurit e tjerë, ku përkundër të njoftimit të stafit për këto ngacmime, ata nuk kishin ndërmarrë ndonjë masë. Në orët e mbrëmjes i njëjti ishte **dhunuar seksualisht**.

Pas raportimit, rasti i dhunimit është trajtuar nga Gjykata Themelore në Pejë, ku ishte vërtetuar dhunimi. QKRMT i kishte siguruar avokat mbrojtës viktimës gjatë gjithë procedurës. Ndaj të burgosurit që kishte kryer dhunimin kishte pushuar procedura për shkak se i njëjti ka ndërruar jetë, ndërsa ndaj 3 të burgosurve të tjerë ishte shqiptuar dënim me burgim efektiv për shkak të moslajmërimit të rastit.

Pas përfundimit të gjyqimit ku ishte vërtetuar dhunimi, QKRMT i siguroi një avokat viktimës për ta përfaqësuar në procedurën kontestimore për ***kompensim të dëmit përshkak të mosveprimit sipas përgjegjësisë ligjore të sigurisë në institucionin korrektues dhe keqtrajtimin*** që viktima kishte përjetuar gjatë vuajtjes së dënimin në institucionin korrektues.

Në këtë rast viktima, në cilësinë e Paditësit ka paditur Ministrinë e Drejtësisë / Shërbimin Korrektues të Kosovës, si dhe të burgosurit e tjerë që kanë qenë prezent gjatë dhunimit.

Pas shqyrtimit të rastit, në shtator 2023, Gjykata Themelore në Prishtinë mori Aktgjykim me të cilin aprovoi pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit, viktimës së

dhunimit. Me këtë Aktgjykimi, gjykata detyroi Qeverinë e Republikës së Kosovës – Ministrinë e Drejtësisë, që në emër të kompensimit të dëmit për shkak të mosveprimit sipas përgjegjësive ligjore të sigurisë në institucionet korrektuese dhe keqtrajtimit të përjetuar në shtator 2014, ta kompensojë viktimën për shkak të:

- ***Dhimbjeve shpirtërore;***
- ***Dhimbjeve trupore;***
- ***Cenimit të dinjitetit dhe nderit.***

Edhe pse Padia është aprovuar pjesërisht, në kuptimin e kompensimit monetar që shumica e kompensuar është shumë më e ulët se sa kërkesëpadia, ky Aktgjykim konfirmon përgjegjësinë që shteti e ka pasur në këtë rast. Përkatësisht, ky rast i rikujton institucioneve korrektuese përgjegjësitë shtetërore që kanë për sigurinë dhe mbrojtjen e të drejtave të personave të privuar nga liria. Në mes të tjerash, gjykata ka ardhur në përfundim se: ***“Në rastin konkret është vërtetuar se ka pasur mungesë të angazhimit adekuat nga ana e institucioneve shtetërore për t’i ofruar sigurinë e mjaftueshme paditësit, si dhe duke e vendosur të njëjtin në një dhomë me persona të dënuar për vepra penale me dënime më të gjata, paditësin e kanë ekspozuar para një rreziku i cili ka përfunduar me cenimin e sigurisë, dinjitetit dhe nderit të paditësit, për çka e paditura e parë (Ministria) duhet të mbahet përgjegjëse.*** Po ashtu gjykata shton se: ***Në këtë rast mund të thuhet se Shërbimi Korrektues i Kosovës e dinte ose do duhej të dinte se jeta e një individit ishte në rrezik, në mënyrë që të ndërmerre hapa të tjerë për të ofruar siguri dhe mbrojtje.***

Pas plotfuqishmërisë së Aktgjykimit, Ministria e Drejtësisë / Shërbimi Korrektues i Kosovës e ka zbatuar këtë aktgjykim duke bërë kompensimin e dëmit ashtu siç e ka caktuar gjykata.

Për raste të tilla duhet angazhim i vazhdueshëm, ku QKRMT me vite të tëra i ka ofruar viktimës trajtim sipas nevojës dhe shërbime ligjore me qëllim të arritjes së drejtësisë.

***“Pas traumës... e gjeta veten të braktisur dhe të humbur: Humba të fejuarën dhe miqtë, mendova se kisha arritur fundin. Por ndihma e QKRMT-së më nxori në jetë dhe më bëri më të fortë. Për shkak të kontributit të tyre, unë tani jam më mirë, ata ishin gjithmonë pranë meje; ata kanë qenë një ndihmë e madhe për mua, duke më dhënë forcën të pranoj se jeta duhet të vazhdojë”***  
– deklaratë nga klienti.

# MANDATI, METODOLOGJIA DHE QËLLIMI I MONITORIMIT

Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës (QKRMT) është organizatë e pavarur, joqeveritare dhe jofitimprurëse. E themeluar në vitin 1999, QKRMT ka për mision ofrimin e trajtimit dhe shërbimeve të rehabilitimit për viktimat e torturës dhe të keqtrajtuarve gjatë luftës në Kosovë.

Po ashtu, QKRMT është e angazhuar në promovimin, respektimin dhe avancimin e të drejtave të njeriut për të gjitha etnitetet në Kosovë, si dhe në parandalimin dhe çrrënjosjen e torturës dhe çdo forme tjetër të keqtrajtimit, përmes monitorimit të të drejtave të njeriut në vendet e ndalimit në Kosovë.

## 1. Mandati

Programi për të drejtat e njeriut udhëheq, koordinon dhe planifikon të gjitha aktivitetet e ndërlidhura me misionin për promovimin e respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut dhe ofrimin e ndihmës dhe këshillimeve ligjore për avancimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Në kuadër të mandatit për promovimin dhe avancimin e respektimit të të drejtave të njeriut për personat e privuar nga liria, QKRMT ndërmerr aktivitetin e monitorimit të rregullt në vendet e ndalimit, siç janë: burgjet, qendrat e paraburgimit, qendrat e mbajtjes në stacionet policore, institucionet e shëndetit mendor si dhe promovon praktika dhe standarde legjislative për mbrojtjen dhe avancimin e respektimit të të drejtave të personave të privuar nga liria. Realizimi i vizitave monitoruese në institucionet korrektuese realizohet në bazë të Marrëveshjes së Mirëkuptimit me Ministrinë e Drejtësisë. Marrëveshja aktuale është nënshkruar në muajin qershor 2022 për një periudhë dy vjeçare. Memorandumi përcakton mënyrën e bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë dhe QKRMT-së për qasje në institucionet korrektuese të Kosovës, duke i mundësuar ekipeve të QKRMT-së realizimin e vizitave monitoruese pa paralajmërim në të gjitha institucionet korrektuese.

## 2. Metodologjia

QKRMT bazohet në indikatorët ndërkombëtarë të vlerësimit të të drejtave të njeriut në vendet e privimit të lirisë si: Rregullat Standarde Minimale të Kombeve të Bashkuar për Trajtimin e të Burgosurve (Rregullat e Mandelës); Rregullat Evropiane të Burgjeve (EPR); Normat e Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës (KPT); Rregullat e Bankokut etj., si dhe kornizën ligjore të aplikueshme në Kosovë si Kodi Penal i Kosovës (KPK) dhe Kodi i Procedurës Penale i Kosovës (KPPK), Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale (LESP), Kodi i Drejtësisë për të Mitur, Ligji për Shëndetin Mendor, etj., si dhe aktet e tjera nënligjore. Ekipet e QKRMT janë multidisiplinare (jurist, mjek, punëtor social dhe psikolog), ndërsa qasja në monitorim ka karakter parandalues dhe identifikues të çështjeve lidhur me trajtimin dhe respektimin e të drejtave të njeriut në institucionet e ndalimit.

## 3. Parimet e monitorimit

Monitorimi i vendeve të ndalimit përmes vizitave është një detyrë e ndjeshme dhe delikate. Për arsye etike dhe efikasiteti, është me rëndësi që këto vizita monitoruese të kenë parasysh dhe të respektojnë një numër të parimeve themelore, duke përfshirë:

**Mos-dëmtimi:** Të ndaluarit janë veçanërisht të pambrojtur dhe siguria e tyre çdo herë duhet të kihet parasysh nga monitoruesit, të cilët kurrë nuk duhet të ndër marrin veprime të tilla që mund të rrezikojnë të ndaluarit.

**Praktika e gjyimit të mirë:** Monitoruesit duhet të kenë njohuri mbi standardet dhe rregullat ndaj të cilave ata kryejnë monitorimin. Megjithatë, përkundër çfarëdo numri të tyre, rëndësie, dhe vlere, rregullat nuk mund të zëvendësohen për gjykim të mirë personal dhe logjik. Monitoruesit prandaj duhet të posedojnë dhe ushtrojnë gjykim të mirë në të gjitha rrethanat.

**Respekti ndaj autoriteteve dhe zyrtarëve përgjegjës:** Përveç atëherë kur është ndërtuar respekti reciprok ndërmjet stafit dhe monitoruesve, puna në vendet e ndalimit mund të rrezikohet. Monitoruesit gjithmonë duhet të respektojnë funksionimin e autoriteteve dhe identifikojnë nivelet e hierarkisë dhe përgjegjësisë në mënyrë që të mund të trajtojnë secilin problem në nivelin e duhur.



**Respektimi i personave të privuar nga liria:** Pavarësisht arsyeve të privimit nga liria, të ndaluarit duhet të trajtohen me respekt dhe mirësjellje. Vizitori (monitoruesi) duhet ta prezantojë vetveten.

**Të qenit i besueshëm:** Monitoruesit duhet t'ua bëjnë të qartë të ndaluarve dhe stafit, objektivat dhe kufizimet e punës së tyre monitoruese dhe të sillen në përputhje me rrethanat. Ata nuk duhet të premtojnë dhe të ndërmarrin ndonjë veprim të cilin nuk mund ta qojnë deri në fund.

**Respektimi i fshehtësisë (konfidencialiteti):** Respektimi i fshehtësisë së informatave të marra gjatë intervistave private është thelbësor. Monitoruesit nuk mund të paraqiten si përfaqësues duke përdorur emrin e të ndaluarit pa pëlqimin e tij/saj të shprehur ose të informuar.

**Respektimi i sigurisë:** Është e rëndësishme të respektohen rregullat e brendshme të vendit që vizitohet. Autoritetet mund të kërkojnë që për shkaqe të sigurisë të mos lejohet vizita në vendet e veçanta ose vendosin kushte të veçanta, por është përgjegjësi e monitoruesve, nëse dhe si ata do t'u përmbahen këtyre këshillave. Monitoruesit duhet të shfaqin identitetin e tyre duke vendosur shenjat identifikuese (ID) ose mjetet tjera identifikuese.

**Të qenët i qëndrueshëm, këmbëngulës dhe i durueshëm:** Legjitimiteti i ekipit monitorues është krijuar me kalimin e kohës, kryesisht si rezultat i rëndësisë, këmbënguljes dhe qëndrueshmërisë së punës së tij. Monitorimi i vendeve të ndalimit kërkon efikasitet, rregull dhe vazhdimësi. Kjo nënkupton vizita të rregullta në vende të njëjta, dhe ndërtimin e provave të mjaftueshme për të nxjerrë konkluzione dhe bërë rekomandime. Është thelbësore të qenët këmbëngulës në aktivitetet pasuese të monitorimit.

**Të qenët korrekt dhe i saktë:** Gjatë një vizite është e rëndësishme të mblidhen informata të sakta dhe të shëndosha në mënyrë që të hartohen raporte të dokumentuara mirë dhe rekomandime relevante.

**Të qenët sensitiv:** Veçanërisht kur intervistohen të ndaluarit, monitoruesit duhet të jenë të ndjeshëm në situata të disponimit dhe nevojave individuale, si dhe nevojave për të ndërmarrë hapa të domosdoshëm për të mbrojtur sigurinë e tyre. Në rastet e supozimeve të torturës dhe keqtrajtimit, monitoruesit duhet të jenë të vetëdijshëm për problemet e ri-traumatizimit.

**Të qenët objektiv:** Monitoruesit duhet të përpiqen t'i regjistronjë faktet aktuale, dhe të trajtojnë stafin dhe të ndaluarit në mënyrën e cila nuk është e ngjyrosur nga ndjenjat dhe mendimet paragjyquese.

**Sjellje me integritet:** Monitoruesit duhet t'i trajtojnë të gjithë të ndaluarit,, autoritetet dhe stafin me mirësjellje dhe respekt dhe çdo herë duhet të veprojnë në pajtim me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe mandatin që ata mbajnë.

**Të qenët i dukshëm:** Brenda vendit të ndalimit, monitoruesit duhet të sigurohen se stafi dhe të ndaluarit janë të vetëdijshëm për metodologjinë dhe mandatin e trupave vizitues dhe faktin se ata dinë si t'u qasen atyre (duke mbajtur ID).

Parimet e sipërpërmendura janë marrë nga tetëmbëdhjetë parimet e identifikuara në Manualin e Monitorimit nga Trajnimi i OKB-së për monitorimin e të drejtave të njeriut. Ato janë adaptuar sipas nevojave duke marrë në konsideratë veçoritë e monitorimit të vendeve të ndalimit.

QKRMT, këto parime i ka bërë pjesë të metodologjisë së punës në monitorimin e vendeve të ndalimit dhe të njëjtat i udhëheqin ekipet monitoruese çdoherë gjatë vizitave nëpër vendet e ndalimit.

## 4. Llojet e vizitave

Llojet e ndryshme të vizitave monitoruese mund të definojnë gjerësisht në tri kategori:

**Vizitat sistematike apo të rregullta.** Këto vizita ndërmerren me qëllim të vlerësimit të gjithë ambientit dhe kushteve të jetesës dhe zhvillimit të intervistave private me të dënuarit dhe të paraburgosurit. Përmes këtyre vizitave ekspertët e QKRMT-së kanë mbledhur dhe analizuar informata që ndërlidhen me të gjitha aspektet e trajtimit dhe mbrojtjes së të dënuarve/paraburgosurve dhe kushteve të jetës së tyre. Gjendja e përgjithshme është vlerësuar në bazë të indikatorëve paraprak, rekomandimeve të mëhershme si dhe zhvillimeve të fundit në këto qendra.

**Vizitat përcjellëse** synojnë përcjelljen e aspekteve specifike të burgimit/paraburgimit, rastet individuale ose zbatimin e rekomandimeve të mëparshme.



**Vizitat tematike** ndërmerren për të fokusuar vlerësimin në aspektet si: sistemi i ankesave, menaxhimi i ndëshkimeve disiplinore, kontakti me botën e jashtme, kujdesi shëndetësor, raportet ndërmjet personelit/menaxhmentit dhe të burgosurve/paraburgosurve, personave me nevoja të veçanta, grupeve të rrezikuara etj.

## 5. Monitorimi i Institucioneve Korrektuese

Gjatë vitit 2023, QKRMT ka realizuar nëntëmbëdhjetë (19) vizita në qendrat e paraburgimit dhe qendrat korrektuese. Edhe gjatë këtij viti nuk janë monitoruar shërbimet shëndetësore në burgje, Instituti i Psikiatrisë Forenzike, si dhe Qendra e Paraburgimit në Mitrovicë.

Monitorimi është realizuar brenda fushëveprimit të QKRMT-së dhe në përputhje me Marrëveshjen e Bashkëpunimit me Ministrinë e Drejtësisë. Bazuar në modalitetet e Marrëveshjes së re të bashkëpunimit, vizitat monitoruese janë realizuar pa njoftim paraprak.

Nga vizitat e realizuara, QKRMT vlerëson se gjendja e përgjithshme e trajtimit të të burgosurve mbetet kryesisht e njëjtë si në vitet paraprake.

Edhe gjatë këtij viti sfiduese ka qenë pa mundësia e monitorimit të shëndetësisë në burgje pasi që Marrëveshja e fundit me Departamentin Shëndetësor të Burgjeve (DShB) kishte skaduar më 14.02.2022, dhe që nga ajo kohë ende nuk është arritur të nënshkruhet marrëveshje e re. Mungesa e monitorimit të shëndetësisë në burgje e ka kufizuar monitorimin e plotë dhe pasqyrimin e gjendjes së plotë të trajtimit të burgosurve, pasi që të gjitha çështjet e adresuar nga të burgosurit në raport me shëndetësisë, nuk është arritur që të monitorohen.

Përveç kufizimit të qasjes në monitorimin e shëndetësisë në institucionet korrektuese, QKRMT nuk ka pasur qasje monitoruese edhe në Institutin e Psikiatrisë Forenzike të Kosovës (IPFK).

***Pas çdo vizite monitoruese, QKRMT ka përpiluar raportet e detajuara me gjetjet dhe rekomandimet, të cilat raporte i janë dërguar institucioneve të monitoruara.***

***Në disa raste, udhëheqësit e institucioneve të monitoruara kanë kthyer përgjigje ndaj raportit të dërguar duke sqaruar veprimet e ndërmarra në raport me gjetjet dhe rekomandimet.***

**Megjithatë, gjetjet e paraqitura në këtë raport pasqyrojnë gjendjen e institucioneve korrektuese dhe trajtimin e të burgosurve në ditën e realizimit të vizitës monitoruese. Përmirësimin e kushteve dhe zbatimin e rekomandimeve, QKRMT do t'i paraqesë në raportet pas vizitave të ardhshme monitoruese.**

## 6. Vizitat monitoruese të realizuara në Institucionet Korrektuese gjatë vitit 2023

Nr.	Data e vizitës	Institucioni
1.	22.02.2023	Qendra Korrektuese për Femra në Lipjan
2.	25.05.2023	Qendra Korrektuese për të Mitur në Lipjan
3.	08.06.2023	Qendra e Paraburgimit në Prishtinë
4.	14.06.2023	Qendra Korrektuese në Dubravë
5.	05.07.2023	Qendra Korrektuese për Femra në Lipjan
6.	13.07.2023	Qendra e Paraburgimit në Gjilan
7.	19.07.2023	Qendra e Paraburgimit në Pejë
8.	16.08.2023	Qendra Korrektuese në Dubravë
9.	21.09.2023	Qendra Korrektuese për të Mitur në Lipjan
10.	21.09.2023	Qendra Edukuese Korrektuese në Lipjan
11.	04.10.2023	Burgu i Sigurisë së Lartë në Gërdoc
12.	11.10.2023	Qendra Korrektuese në Dubravë
13.	01.11.2023	Qendra e Paraburgimit në Prizren
14.	09.11.2023	Qendra Korrektuese në Smrekonicë
15.	23.11.2023	Qendra Korrektuese për Femra në Lipjan
16.	07.12.2023	Qendra Korrektuese për të Mitur në Lipjan
17.	07.12.2023	Qendra Edukuese Korrektuese në Lipjan
18.	12.12.2023	Qendra e Paraburgimit në Prishtinë
19.	14.12.2023	Qendra Korrektuese në Dubravë

**AVANCIMI I TË  
DREJTAVE TË  
PERSONAVE TË  
PRIVUAR NGA  
LIRIA**

Progresi gjatë vitit 2023

---



## 1. Rritja e buxhetit vjetor për investime kapitale

Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me Shërbimin Korrektues, kanë përgatitur dhe propozuar buxhetin për vitin 2024 në vlerë prej 8 milionë euro vetëm për investime kapitale. Buxheti për investime kapitale në vitet e kaluar ka qenë rreth 1 milionë euro në vit, ndërsa për vitin 2024 do të jetë tetë herë më i lartë, ku planifikohet të ndërtohen objekte të reja të institucioneve korrektuese, e po ashtu do të bëhen edhe renovime.

## 2. Projektimi i ndërtimit të objekteve të reja korrektuese

Buxheti i ri në vlerë prej 8 milionë euro, parasheh ndërtimin e Qendrës së re Korrektuese për Femra, si dhe Qendrës së re të Paraburgimit në Prizren, në të cilën do të zhvendosen të paraburgosurit nga QP Prizren dhe QP Pejë. Ndërtimi i këtyre institucioneve pritet të fillojë gjatë vitit 2024.

QKRMT në vazhdimësi ka rekomanduar ndërtimin e objekteve të reja për Qendrën Korrektuese për Femra dhe Qendrat e Paraburgimit në Prizren dhe Pejë, prandaj edhe e mirëpret investimin që do të bëhet. Ky investim, do të ndikojë në avancimin e kushteve dhe të drejtave të të burgosurve, si në pikëpamjen e infrastrukturës, po ashtu edhe në mundësinë e shtimit të aktiviteteve të ndryshme. Për më tepër, QKRMT me ftesë të institucioneve korrektuese ka kontribuar në projektimin ideor të këtyre objekteve.

Po ashtu, gjatë vitit 2023 ka filluar ndërtimi i Shtëpisë për Nëna me Fëmijë në Lipjan, pranë Qendrës Korrektuese për Femra në Lipjan. Ndërtimi i kësaj shtëpie ka qenë i domosdoshëm duke pasur parasysh që një shtëpi e tillë ka qenë në ambientet e Qendrës Korrektuese për të Mitur dhe kushtet materiale as për së afërmi nuk kanë qenë të përshtatshme për vendosjes e nënave me fëmijë. Ligji ka paraparë që të burgosurat që janë nëna të fëmijëve deri në 18 muaj, të vendosen bashkërisht me fëmijët e tyre në ambiente të veçanta.

QKRMT në vazhdimësi ka raportuar për kushtet e papërshtatshme të kësaj shtëpie dhe ka rekomanduar ndërtimin e një shtëpie të re që u përshtatet standardeve ndërkombëtare.

### 3. Emërimi i drejtuesve të institucioneve korrektuese

Për disa vite, QKRMT ka raportuar për mungesë të menaxhmentit të qëndrueshëm të ShKK-së dhe institucioneve korrektuese, duke bërë thirrje që udhëheqësit e emëruar në institucionet korrektuese të kenë mandat të plotë.

Gjatë vitit 2023, janë plotësuar disa nga pozitat e drejtorëve me mandat të rregullt, siç është emërimi i Drejtorit të Përgjithshëm të ShKK-së. Po ashtu, në më shumë se gjysmën e institucioneve korrektuese janë emëruar drejtorë me mandat të plotë, si: BSL, QKF, QKM dhe QEK, QP Mitrovicë, QP Pejë. Ndërsa, në institucionet korrektuese si: QK Dubravë, QK Smrekonicë, QP Prishtinë, QP Gjilan dhe QP Prizren, drejtorët ende kanë mandatin e ushtruesit të detyrës.

### 4. Rekrutimi i oficerëve të rinj korrektues

Gjatë vitit 2023 kanë filluar punën 45 gra oficere korrektuese. Po ashtu, ka filluar rekrutimi i 70 oficerëve të rinj korrektues. Numri i oficerëve korrektues ka qenë i mangët në raport me numrin e të burgosurve dhe kapaciteteve të institucioneve korrektuese, prandaj rekrutimi i oficerëve të rinj korrektues do të ndikojë drejtpërdrejt në menaxhimin më të mirë të institucioneve korrektuese.

### 5. Hapja e Institucionit shëndetësor për trajtimin e personave me nevoja të veçanta

Në Shkurt të vitit 2023 është bërë përrurimi dhe hapja e Institucionit shëndetësor për trajtimin e personave me nevoja të veçanta (Pavijonit D), si institucion i veçantë, kryesisht për trajtimin e rasteve me rrezik për vetëvrasje dhe përdoruesve të substancave narkotike. Kapaciteti i këtij institucioni është 60 shtretër.

### 6. Organizimi i mësimit special për të miturit

Pas rekomandimeve të vazhdueshme dhe publikimeve të veçanta nga QKRMT, në vitin shkollor 2023/24 ka filluar implementimi i mësimit special për të miturit që nuk dinin shkrim dhe lexim. Kodi i Drejtësisë për të Mitur parasheh që në raste të tilla duhet të organizohet mësim special, mirëpo deri në vitin 2023 mësimi organizohej vetëm nga klasa e 5-së e tutje.

## **7. Arritjet e Shërbimit Korrektues në luftimin e kontrabandës dhe korrupsionit**

Një ndër sukseset më të mëdha të Shërbimit Korrektues të Kosovës (ShKK) në 2 vitet e fundit ka qenë lufta kundër kontrabandës dhe korrupsionit në institucionet korrektuese. ShKK ka ndërmarrë veprime të vazhdueshme në luftën kundër këtyre dukurive. Gjatë vitit 2023, 53 raste të kontrabandës janë parandaluar. Po ashtu, janë zbuluar 14 raste të korrupsionit të zyrtarëve korrektues, ndaj të cilëve janë ndërmarrë veprime konkrete (suspendim, pushim nga puna).

## **8. Puna e të burgosurve jashtë institucioneve korrektuese – histori sukse**

Udhëzimi Administrativ që përcakton kriteret për angazhim në punë jashtë institucioneve korrektuese ka gjetur zbatim të plotë në Qendrën Korrektuese në Smrekonicë, ku 1/3 e të burgosurve ishin të angazhuar në punë jashtë institucionit korrektues. Atyre u është mundësuar lidhja e kontratave me bizneset private, ndërsa të ardhurat menaxhohen përmes institucionit korrektues. Të burgosurit e angazhuar në punë, dalin nga institucioni në orën 7:00, ndërsa kthehen në orën 16:00 pa përcjellje. Ndërkohë funksionon edhe ekipi monitorues, që përcjellë zbatimin e kontratës së punës, si dhe respektimin e Udhëzimit Administrativ nga ana e të burgosurve.





**PËRMBLEDHJA  
E GJETJEVE TË  
PËRGJITHSHME  
2023**



# 1. TRAJTIMI I PERSONAVE TË PRIVUAR NGA LIRIA

*Keqtrajtimi, tortura apo trajtimi çnjerëzor, degradues ose poshtëruës janë të ndaluara me të drejtën ndërkombëtare dhe vendore. Mbrojtja nga tortura apo trajtimi çnjerëzor ose poshtëruës është e drejtë absolute dhe e drejtë njerëzore e patjetërsueshme, qoftë ajo emergjencë publike, çështje e sigurisë shtetërore apo arsye të tjera.*

Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës (QKRMT), që nga viti 2007 në mënyrë sistematike monitoron institucionet korrektuese, me qëllim të parandalimit të torturës apo formave të tjera të keqtrajtitimit. Si organizatë e pavarur, QKRMT vizitat monitoruese i realizon për qëllim të vlerësimit të respektimit të të drejtave të njeriut në vendet e privimit nga liria. QKRMT ka monitoruar trajtimin e të dënuarve dhe të paraburgosurve, duke i kushtuar vëmendje të posaçme vendosjes, trajtimin të kategorive të ndjeshme; kategorizimin e të burgosurve; planin individual të trajtimit; garancitë procedurale dhe masat disiplinore; rastet e lëndimeve, vetëlëndimeve, tentim-vetëvrasjet, vetëvrasjet dhe vdekjet; konfliktet në mes të burgosurve; përdorimin e forcës dhe keqtrajtimin; mbipopullimin si dhe aspekte të tjera që ndërlidhen me të drejtat dhe trajtimin e të burgosurve.

Disa nga situatat e paraqitura në vijim të këtij raporti, shfaqin indikacione se niveli i trajtimit të të burgosurve duhet të avancohet, përkatësisht veprimet e shtetit duhet të jenë proaktive në parandalimin e çdo mundësie të keqtrajtitimit dhe avancimit të respektimit të të drejtave të personave të privuar nga liria. Veprimet e shtetit apo mosveprimet në parandalimin e disa rasteve siç janë paraqitur në vijim, mund të qojnë në situata që konsiderohen jo humane.

Për më shumë se dy vjet QKRMT-së nuk i është lejuar qasje në monitorimin e shërbimeve shëndetësore në burgje, gjë që përveç monitorimit të shërbimeve shëndetësore që ofrohen në burgje, i ka pamundësuar monitorimin dhe konfirmimin e disa rasteve që kanë pasur indikacione për trajtim jo të duhur në burgje, si p.sh. lëndimet, vetëlëndimet, tentim-vetëvrasjes, rastet e raportuara për përdorim të forcës fizike, rastet me probleme të shëndetit mendor, përdoruesit e substancave narkotike etj. Për këto raste, QKRMT është dashur që përveç takimeve dhe intervistave me të burgosurit të shfrytëzojë burimet e tjera për mbledhjen dhe konfirmimin e të dhënave. Përrjashtimisht, për rastet që QKRMT ka kërkuar informacion mbi trajtimin individual të të burgosurve, Departamenti Shëndetësor

i Burgjeve është përgjigjur pozitivisht duke e ndarë raportin individual mbi rastin përkatës.

**Prandaj, QKRMT i bën thirrje Ministrisë së Shëndetësisë dhe Departamentit Shëndetësor të Burgjeve që të ri-shikojnë kërkesën e QKRMT-së për qasjen në monitorimin e shëndetësisë në burgjeve, në mënyrë që të evidentohen të dhënat e sakta rreth pohimeve apo supozimeve për rastet e trajtimit jo të duhur.**

Në vijim të raportit është pasqyruar trajtimi i të burgosurve sipas fushave specifike.

### **1.1. Vendosja dhe trajtimi i kategorive të ndjeshme (kategorizimi)**

**Vendosja dhe trajtimi i kategorive të ndjeshme apo kategorizimi** në institucionet korrektuese ka qenë në fokus të monitoruesve të QKRMT-së edhe gjatë vitit 2023. Me gjithë përpjekjet e Shërbimit Korrektues dhe Departamentit Shëndetësor të Burgjeve, vendosja dhe trajtimi i të burgosurve sipas kategorive të caktuara ka qenë sfidë edhe gjatë këtij viti.

Në shumë raste, QKRMT ka evidentuar që personat me **sëmundje të ndryshme**, ata me **çrregullime të shëndetit mendor dhe përdoruesit e substancave narkotike** ishin të vendosur pothuajse në të gjitha institucionet bashkë me të burgosurit e tjerë. Përkundër funksionalizimit të Institucionit Shëndetësor për Trajtimin e Personave me Nevoja të Veçanta në QK Dubravë (në vijim të raportit: *Pavijoni D*), i cili ka kapacitet prej 60 shtretër, numri i personave të vendosur në këtë institucion ishte deri në 20 (sipas të dhënave nga vizita e fundit monitoruese në QK Dubravë në muajin Dhjetor 2023), ndërsa personat e tjerë me nevoja specifike shëndetësore vazhdonin të mbaheshin në pavijonet e tjera në QK Dubravë apo në institucionet e tjera korrektuese.

**Gratë** e burgosura janë të vendosura në institucion të veçantë korrektues (Qendra Korrektuese për Femra në Lipjan). Për gratë me probleme të shëndetit mendor nuk ka institucione apo hapësira të veçanta për trajtim. Në Institutin e Psikiatrisë Forenzike të Kosovës (IPFK) nuk ka pavijon të veçantë për gra, dhe në rastet kur domosdoshmërisht duhet të bëhet ekzaminimi psikiatrik në këtë institucion, ato vendosen në disa dhoma të ndara, por që kufizohen në realizimin e aktiviteteve të tjera të këtij institucioni. Po ashtu, me hapjen e Pavijonit D në QK Dubravë, nuk është paraparë hapësirë apo njësi e veçantë për gra.

**Të miturit** janë të vendosur në Qendrën Korrektuese për të Mitur dhe Qendrën Edukuese Korrektuese në Lipjan. Gjithashtu, për të miturit nuk ka institucion të veçantë për trajtimin e të miturve të privuar nga liri që kanë probleme të shëndetit mendor.

QKRMT, ndër vite ka ngritur shqetësimin për vendosjen e të miturve me masë edukative në Qendrën Korrektuese, në vend se ata të vendoseshin në Qendrën Edukuese Korrektuese, e cila është ndërtuar për këtë qëllim. Po ashtu, për të **miturat vajza** nuk ka hapësira të veçanta, ato vendosen në institucion dhe hapësira të njëjta me të dënuarat madhore. Për trajtimin e të miturve shqetësuese është mungesa e punëtorëve social dhe edukatorëve përkatës. Aktualisht është e angazhuar vetëm një punëtorë sociale për të dyja qendrat ndërsa nuk ka asnjë edukator, ashtu siç parashihet me Kodin e Drejtësisë për të Mitur. Për më tepër, deri në vitin 2023 në QEK stafi kanë punuar në rroba civile ndërsa nga viti 2023 është ri-kthyer uniforma.

***QKRMT ri-përsërit rekomandimin se duhet të ketë njësi të veçanta shëndetësore për gra dhe të mitur me probleme të shëndetit mendor. Gjithashtu të gjithë të miturit me Masë Edukative duhet të vendosen në Qendrën Edukuese Korrektuese.***

Institucionet korrektuese ende nuk kanë politika të veçanta për vendosjen dhe kategorizimin e personave të komunitetit **LGBTQI+**. QKRMT ka kërkuar informacion rreth trajtimit të kësaj kategorie të të burgosurve, mirëpo përgjigja ka qenë se nuk ka raste të tilla, dhe nuk ka as procedura për vendosjen dhe kategorizimin e tyre. Mungesa e procedurave për vendosje dhe kategorizim, është një prej arsyeve që nuk dihet nëse ka persona të këtij komuniteti në burgje sepse të njëjtit mund të ndihen të stigmatizuar dhe pa adresë për të kërkuar vendosjen dhe trajtimin e duhur.

Gjatë bisedave me ekipin monitorues, në disa raste të burgosurit kanë ngritur çështjen e të burgosurve që sipas tyre i takojnë komunitetit LGBTQI+ dhe kanë kërkuar që të vendosen në njësi të veçanta. QKRMT i ka adresuar këto kërkesa te menaxhmenti i burgut, mirëpo përgjigja ka qenë se nuk kanë pasur raste të tilla.

Sa i përket të burgosurve **shtetasve të huaj**, në institucionet korrektues vështirësitë kryesore kanë të bëjnë me realizimin e vizitave familjare dhe komunikimit me familjet e tyre. Shërbimi Korrektues i Kosovës për më shumë se dy vjet nuk ka arritur marrëveshje me Postën e Kosovës për mundësinë e realizimit të telefonatave jashtë territorit të Republikës së Kosovës, kështu që të gjithë

shtetasit e huaj nuk kanë mundësi të realizojnë telefonata jashtë vendit, ndërsa sa i përket qasjes në SKYPE (si mjet i komunikimit që aplikohet në institucionet korrektuese), në disa nga vendet prej nga vijnë këta të burgosur nuk aplikohet kjo platformë. Kërkesat e tyre janë që t'u lejohet mundësia e komunikimit përmes WhatsApp, mirëpo nuk ka ndonjë vendim që e lejon komunikimin e tillë.

Të burgosurit e **komuniteteve pakicë** vendosen të përzier me të burgosur të tjerë, por kur ka mundësi dhe hapësira të burgosurit e komunitetit të njëjtë, vendosen bashkërisht. Në përgjithësi trajtohen në mënyrë të barabartë, por nganjëherë ka ankesa se neglizhohen kërkesat e tyre apo edhe ndonjë rast që fyhen nga stafi dhe të burgosurit e tjerë veç pse i takojnë komunitetit pakicë (rom, ashkali ose egjiptian). Sa i përket të burgosurve të **komunitetit serb**, ata janë të ndarë në njësi (pavijone) të veçanta brenda institucioneve korrektuese në BSL, QP Prishtinë, QP Gjilan dhe QP Mitrovicë. Gjatë vizitave monitoruese të QKRMT-së, çdo herë vizitohen edhe të burgosurit serbë, të cilët nuk kanë paraqitur ankesa sa i përket trajtimit të tyre.

Në QK Smrekonicë, institucion i tipit të hapur, vendosen drejtpërdrejt edhe të dënuarit sipas urdhëresës nga gjykata. Pra, përkundër që është institucion ku duhet të vendosen vetëm ata të dënuar që i plotësojnë kriteret për t'u vendosur në institucion të tipit të hapur, aty dërgohen edhe rastet që arrestohen me urdhër të gjykatës, pa kaluar nëpër procesin e vlerësimit paraprak. Kjo ka paraqitur mjaft vështirësi në menaxhimin e tyre. Sipas procedurave të Shërbimit Korrektues, çdo pranim i ri për vuajtje të dënimit fillimisht duhet të vendoset në Pavijonin e veçantë në QP Prishtinë për t'iu bërë vlerësimi paraprak dhe kategorizimi. Ky rregull nuk zbatohet çdo herë, prandaj ndikon edhe në kategorizimin e mirëfilltë të të burgosurve.

## 1.2. Trajtimi i rasteve të abuzimit seksual

*(Përgjegjësia e shtetit për t'i trajtuar dhe mbrojtur të drejtat e tyre)*

QKRMT i kushton rëndësi të veçantë trajtimit të rasteve që janë abuzuar seksualisht apo janë në pozitë të ndjeshme, duke përfshirë monitorimin, identifikimin, trajtimin dhe reagimin ndaj këtyre rasteve.

Edhe pse gjatë vitit 2023, institucionet korrektuese dhe DShB nuk kishin raportuar asnjë rast të abuzimit seksual, gjatë një vizite të rregullt, ekipi monitorues i QKRMT-së e identifikoi njërin prej të burgosurve si viktimë të sulmit seksual brenda burgut.

I burgosuri kishte probleme të shëndetit mendor dhe kishte qenë përdorues i substancave narkotike. I njëjti ishte zhvendosur në disa pavijone të ndryshme, ndërsa me funksionalizimin e Pavijonit D, ishte transferuar atje dhe ishte vendosur bashkë me një të burgosur tjetër. Pavijoni D është hapur pikërisht për trajtimin e rasteve të tilla (me probleme të shëndetit mendor dhe përdorues të substancave narkotike).

Gjatë qëndrimit disa ditë në Pavijonin D, ky i burgosur ishte sulmuar seksualisht nga një i burgosur tjetër. Menjëherë pas sulmit seksual, ai kishte kërkuar të largohet nga ai pavijon, ku edhe ishte vetëlënduar me kërkesë për transfer. Më pas ishte transferuar nga Pavijoni D. Përkundër reagimeve të tij, ai asnjëherë nuk ishte trajtuar për arsyet e kërkesës këmbëngulëse për largim nga Pavijoni D. Ndërsa, sipas Raportit të DShB-së ai ka këmbëngulë që të largohet nga Pavijoni D për shkak të mospërshtatjes së tij në atë pavijon.

Gjatë vizitës monitoruese të QKRMT-së në muajin Gusht 2023, ekipi monitorues në përbërje të një juristi dhe një psikologu, takoi këtë të burgosur. Gjatë bisedës me të, ai ndihej shumë i shqetësuar dhe frikësuar, dhe kishte raportuar se para disa javësh, deri sa ka qenë i vendosur në Pavijonin D është ngacmuar seksualisht nga një i burgosur tjetër. Nga ekipi monitorues është pyetur se a e di dikush tjetër për rastin, i burgosuri ishte përgjigjur se nga frika nuk e ka raportuar askund rastin. Ekipi monitorues ka biseduar me të burgosurin dhe ka kërkuar aprovim nga ai që të adresojë te stafi përgjegjës. I njëjti është pajtuar që ekipi monitorues ta adresojë rastin e tij. Për shkak të specifikave të rastit dhe gjendjes së shëndetit mendor të tij, ekipi monitorues nuk e ka pyetur për detajet e rastit duke u kujdesur që mos të ri-traumatizohet, kështu që pas vizitës monitoruese QKRMT menjëherë e ka adresuar këtë rast në DShB dhe ka kërkuar që të trajtohet me ndjeshmëri për shkak të gjendjes së rënduar emocionale.

Pas kërkesës së QKRMT-së, DShB është përgjigjur se psikiatri dhe psikologu i QK Dubravë e kanë marrë në trajtim rastin, dhe i njëjti edhe para tyre ka pohuar se është ngacmuar seksualisht. Po ashtu, QKRMT e ka njoftuar edhe drejtorinë e QK Dubravë dhe ka kërkuar trajtimin e menjëhershëm të rastit. Ndërkohë, QKRMT është njoftuar nga QK Dubravë se është formuar Komision hetimor dhe rasti është trajtuar sipas procedurave.

Në tetor 2023, QKRMT ka realizuar një vizitë përcjellëse për të parë veprimet që janë ndërmarrë për trajtimin e këtij rasti. Drejtorja e QK Dubravë e ka njoftuar ekipin monitorues se Komisioni hetimor brenda QK Dubravë e ka hetuar rastin, mirëpo nuk ka gjetur se rasti ka ndodhur. QKRMT-së i është lejuar qasja në dosjen

e Komisionit hetimor, të cilët kishin intervistuar palën e dëmtuar dhe kryerësin e dyshuar. Pala e dëmtuar, në këtë rast i burgosuri që ka qenë viktimë e sulmit seksual, para anëtarëve të Komisionit e ka përshkruar në detaje se si kishte ndodhur rasti. Ndërsa i burgosuri i dyshuar për këtë rast, në mënyrë kategorike kishte mohuar që është i përfshirë në rast. Kështu që, Komisioni hetimor e kishte mbyllur rastin.

Gjatë shikimit të dosjes së hetimit, në bazë të përshkrimit të rastit nga i burgosuri, ekipi monitorues vlerësoi se veprimet kundër integritetit seksual ndaj të burgosurit, sipas deklaratës së tij, kanë elemente të veprës penale **“Sulmi seksuale”** sipas nenit 229 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, dhe në vazhdim QKRMT i është referuar si sulm seksual e jo ngacmim seksual.

Pas konfirmimit se nuk është vazhduar me procedura të tjera për ta hetuar këtë rast, QKRMT më datë 16.10.2023 ka paraqitur **kallëzim penal** pranë Prokurorisë Themelore në Pejë. Lidhur me kallëzimin penal, është njoftuar Shërbimi Korrektues dhe Departamenti Shëndetësor i Burgjeve.

QKRMT është interesuar në vazhdimësi për rastin, ku edhe në dhjetor 2023 e ka vizituar të burgosurin - viktimë të sulmit seksual, mirëpo deri në atë kohë viktima nuk është intervistuar prej policisë apo prokurorisë.

Po ashtu në fillim të vitit 2024, QKRMT i është drejtuar Prokurorisë Themelore në Pejë për të kërkuar informacion rreth trajtimit të këtij rasti, mirëpo asnjëherë nuk ka marrë përgjigje.

Është mjaftë shqetësuese mos trajtimi adekuat i këtyre rasteve si nga ShKK, DShB, e po ashtu edhe nga Prokuroria, ku me muaj viktima nuk është marrë në pyetje nga hetuesia lidhur me rastin e raportuar, sidomos për raste të tilla që është dashur të trajtohet me prioritet dhe ndjeshmëri të lartë.

***Përkundër raportimit të rastit nga QKRMT, fillimisht në ShKK dhe DShB në muajin gusht 2023 pastaj në muajin tetor në prokurori, deri në publikimin e këtij raporti ky rast nuk është trajtuar nga organet përgjegjëse, ku viktima vazhdonte të mbahej pa u marrë në pyetje nga organet kompetente.***

*Neglizhenca e tillë nga institucionet gjegjëse për trajtimin e rasteve të tilla, mund të çojë në ri-viktimizim të të burgosurit, e po ashtu nuk garantohet mbrojtja e të drejtave të njeriut për personat e privuar nga liria. Me këtë rast, neglizhenca e trajtimit me kohë të këtyre rasteve nënkupton që viktimat nuk kanë guxim dhe*



*besim t'i raportojnë rastet e tilla sepse nuk garantohej që do të trajtohen me efikasitet dhe profesionalizëm. Dështimi profesional (me urgjencë dhe ndjeshmëri) i trajtimit të rasteve të sulmeve seksuale, mund të jetë shkak i përsëritjes së veprave të tilla dhe mos raportimit të tyre nga viktimat.*

Për më tepër, në raportin e Departamentit Shëndetësor të Burgjeve për vitin 2023 (publikuar në Janar 2024<sup>1</sup>), rasti i sulmit seksual në QK Dubravë nuk është paraqitur fare, përkundër që është raportuar nga QKRMT në DShB. Pra, te pjesa e raportimit dhe rubrika e rasteve të abuzimit seksual për vitin 2023, numri i rasteve të raportuara është zero (0).

***QKRMT u bën me dije të gjitha autoriteteve përgjegjëse se dështimi i trajtimit të rasteve të tilla, bie në përgjegjësi të shtetit, që duhet t'i mbrojë të drejtat e personave të privuar nga liria.***

***QKRMT u rikujton autoriteteve përgjegjëse se gjatë vitit 2023 është nxjerrë Aktgjykimi i parë nga Gjykata Themelore në Prishtinë, i cili e bën shtetin përgjegjës për dështimin e mbrojtjes së të burgosurit i cili ishte viktimë e dhunimit gjatë vuajtjes së dënimit në QK Dubravë në vitin 2014. Rast ky që është përfaqësuar nga QKRMT që nga viti 2014.***

### 1.3. Trajtimi i përdoruesve të substancave narkotike

Numri i të burgosurve ***përdorues të substancave narkotike*** është në trend rritjeje nga viti në vit, ku sipas Raportit vjetor të DShB-së për vitin 2023, numri i të burgosurve që janë përdorues të substancave narkotike (ata që deklarohen) ka arritur në 16.40 % të popullsisë së burgjeve, përdorues në tre vjetët paraprak (2020, 2021 dhe 2022) përqindja ka qenë rreth 14.5%.

Trendi i rritjes së kësaj përqindjeje e bën sfiduese trajtimin e tyre, pasi që të njëjtit janë të shpërndarë në të gjitha institucionet korrektuese dhe për shkak të gjendjes së varshmërisë shpesh janë subjekt i konflikteve në mes të burgosurve dhe subjekt i shkeljeve disiplinore. Në trajtimin e përdoruesve të substancave narkotike aplikohet programi i metadonit. Megjithatë, QKRMT konsideron se mungon kategorizimi i mirëfilltë dhe plani individual i trajtimit për këtë kategori, duke pasur parasysh që nuk ka pasur progres në këtë fushë.

1 <https://msh.rks-gov.net/Department/Index/10?type=1>

***QKRMТ rekomandon që të hartohet një strategji e veçantë për trajtimin dhe parandalimin e përdorimit të substancave narkotike nga të burgosurit, e cila do të ndikonte pozitivisht në rehabilitimin dhe riintegrimin e tyre në shoqëri.***

#### **1.4. Vendosja dhe trajtimi i kryerësve me çrregullime mendore**

Sikurse në vitet e kaluara, edhe viti 2023 ka qenë mjaft sfidues për vendosjen dhe trajtimin e kryerësve me çrregullime mendore. Institucionet korrektuese po përballën me rritjen e vazhdueshme të numrit të burgosurve me çrregullime mendore, përderisa mungojnë kapacitetet njerëzore profesionale dhe infrastrukture të përshtatshme për vendosjen e tyre, kështu që trajtimi për të burgosurit me probleme të shëndetit mendor mbetën nën standard.

Të gjitha institucionet korrektuese ballafaqohen me të burgosur me probleme të shëndetit mendor, në anën tjetër mungojnë kapacitetet për vendosjen e tyre, ashtu siç kërkohet me ligj.

Të burgosurit me probleme të shëndetit mendor të vendosur në institucionet korrektuese ndahen në disa kategori, varësisht prej statusit që kanë:

- Të burgosurit e dënuar, por që kanë çrregullime mendore;
- Të paraburgosurit, disa nga të cilët në pritje për ekzaminim psikiatrik, një numër i tyre të ekzaminuar por që vazhdojnë të mbajnë paraburgimin në institucione korrektuese;
- Të paraburgosurit në ekzaminim në Institutin e Psikiatrisë Forenzike të Kosovës (IPFK);
- Personat me Masë të trajtimit të detyrueshëm psikiatrik me ndalim në Institutin e Psikiatrisë Forenzike të Kosovës (IPFK).

Aktualisht të burgosurit me probleme të shëndetit mendor, vendosen në të gjitha qendrat korrektuese dhe qendrat e paraburgimit, në IPFK, Pavijonin e Spitalit në QK Dubravë, Pavijonin D.

Për shkak të specifikave të secilit institucion, shumë nga të burgosurit vendosen në qendrat korrektuese dhe të paraburgimit, në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi.

Kodi i Procedurës Penale shprehimisht e përcakton që paraburgimi për personat me çrregullime mendore duhet të mbahet në institucione shëndetësore. Neni 509, paragrafi 2 i Kodit të Procedurës Penale: *“Paraburgimi mbahet në institucionin e kujdesit shëndetësor dhe mund të zgjasë për aq kohë sa i pandehuri është i rrezikshëm, por që nuk kalon afatet e parapara për paraburgim në nenin 187 të këtij Kodi”*. Pra, përkundër kësaj dispozite ligjore, paraburgimi i personave me çrregullime mendore vazhdon të ekzekutohet në institucionet korrektuese.

- Në IPFK dërgohen të paraburgosurit vetëm për ekzaminim psikiatrik, ku pritja për ekzaminim është relativisht e gjatë, ka raste që presin me muaj për dërgimin në ekzaminim psikiatrik, për shkak të mungesës së vendeve në IPFK që ka kapacitet vetëm prej 12 shtretërish për ekzaminim dhe 24 shtretër për ekzekutimin e Masës së trajtimit të detyrueshëm psikiatrik me ndalim. Duke pasur parasysh që kohëzgjatja e ekzaminimit zgjatë deri në 4 javë, krijohet listë e pritjes. Kështu që të paraburgosurit vazhdojnë të mbahen në qendrat e paraburgimit, përkundër mungesës së trajtimit adekuat siç parashihet me ligj.
- Në Pavijonin e Spitalit në QK Dubravë, pjesa psikiatrike, që ka 11 shtretër, dërgohen kryesisht rastet e rënda psikiatrike, si të dënuar po ashtu edhe të paraburgosur. Pjesë e Pavijonit të Spitalit është edhe Pavijoni 7 në QK Dubravë, me 21 shtretër, dedikuar për persona me nevoja të veçanta dhe të moshuar. Edhe në këtë pavijon vendosen të burgosur me çrregullime mendore. Përkundër që Pavijoni 7 është pjesë e Pavijonit të Spitalit, aty nuk qëndron asnjë nga stafi shëndetësor, përveç kohës së shpërndarjes së terapisë.
- Në shkurt 2023 është hapur dhe funksionalizuar Institucionin për trajtimin e personave me nevoja të veçanta në QK Dubravë (Pavijoni D), i cili menaxhohet nga Departamenti Shëndetësor i Burgjeve. Popullimi i këtij Pavijoni ka filluar nga muaji korrik 2023. Numri i të vendosurve në këtë pavijon ishte deri në 20 (të dhënat deri në dhjetor 2023).

Në mungesë të Marrëveshjes për monitorim shëndetësisë në burgje, QKRMT nuk ka arritur të monitorojë trajtimin dhe ofrimin e shërbimeve ndaj të burgosurve në Pavijonin D dhe Pavijonin e Spitalit. Po ashtu, QKRMT ende nuk ka marrëveshje për monitorim të IPFK-së.

Numri i personave me çrregullime mendore është shumë më i lartë se sa hapësitrat aktuale në institucionet e veçanta. Gjatë vitit 2023, vetëm në QP Prishtinë janë

trajtuar rreth **240** të burgosur me çrregullime mendore. Gjatë vizitës monitoruese në dhjetor 2023, në QP Prishtinë ishin vendosur **14 persona me çrregullime mendore**, 8 prej të cilëve kishin Urdhëresë nga gjykata për ekzaminim psikiatrik në IPFK Mirëpo, në mungesë të vendeve në IPFK ata mbaheshin në QP Prishtinë. QP Prishtinë ballafaqohet me numrin më të madh të personave me çrregullime mendore, megjithatë me këtë sfidë ballafaqoheshin edhe institucionet e tjera korrektuese (QK Dubravë, QP Gjilan, QP Pejë, QP Prizren, Qendra Korrektuese për Femra në Lipjan, Qendra Korrektuese për të Mitur në Lipjan).

Pra, **zbatimi i paraburgimit për personat me çrregullime mendore** është duke u realizuar në institucione korrektuese, që është në kundërshtim me ligjet në fuqi. Çdo ndalim i personave të tillë në institucione korrektuese përbën shkelje të të drejtave të njeriut.

***Nisur nga fakti që numri i të paraburgosurve me çrregullime mendore është në rritje, QKRMT ri-përsërit thirrjen për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Këshillin Prokurorial të Kosovës, Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Shëndetësisë si dhe mekanizmat e tjerë përgjegjës që të ndërmarrin masa për krijimin e institucioneve të posaçme shëndetësore për vendosjen dhe trajtimin e kryerësve me çrregullime mendore, duke përfshirë zbatimin e masës së paraburgimit ndaj tyre.***

Në mungesë të trajtimit përkatës ndaj personave me çrregullime mendor, shpeshherë ata bëhen shkaktar të incidenteve të ndryshme brenda institucioneve korrektuese, duke rrezikuar jetën e tyre, e shpeshherë duke e vu në rrezik edhe stafin korrektues dhe të burgosurit e tjerë. Një situatë e tillë, ishte në QP Prizren, ku një i paraburgosur kishte djegur dhomën e tij, dhe stafi korrektues në përpjekje për ta ndaluar zjarrin, ishin sulmuar fizikisht nga i paraburgosuri.

QKRMT ka adresuar trajtimin e rasteve me çrregullime mendore, të vështira për t'u menaxhuar, sidomos ata që ishin të vendosur në Pavijonin 5 në QK Dubravë nën vëzhgim permanent. Pra, rastet më të vështira të menaxhueshme, nuk ishin vendosur në Pavijonet që janë nën menaxhimin direkt të mjekëve, siç janë Pavijoni D dhe Pavijoni i Spitalit, por të njëjtit vendoseshin në Pavijonin 5 (krahun e vetmive) dhe në raste të caktuara (kur ishte vendosur mbikëqyrja permanente) ata mbikëqyrreshin për 24 orë nga oficerët korrektues.

***QKRMt e ka kundërshtuar këtë praktikë në QK Dubravë, dhe ka rekomanduar që rastet me çrregullime të rënda mendore duhet të menaxhohen dhe mbikëqyren nga stafi profesional shëndetësor, e jo nga oficerët korrektues.***

*Në një publikim të veçantë, QKRMt trajton obligimet e shtetit për vendosjen dhe trajtimin e kryerësve me çrregullime mendore.*

### **1.5. Institucioni Shëndetësor për Trajtimin e Personave me Nevoja të Veçanta në QK Dubravë (Pavioni D)**

Institucioni Shëndetësor për Trajtimin e Personave me Nevoja të Veçanta në QK Dubravë (Pavijoni D) është inauguruar në fund të muajit shkurt 2023, si institucion për të burgosurit me nevoja të veçanta, mirëpo punën nuk e ka filluar deri në muajin korrik 2023. Ekipi monitorues i QKRMt-së gjatë vizitës monitoruese të dt. 14.06.2023 e ka vizituar këtë pavijon për ta parë se ku qëndron procesi i fillimit të punës. Nga kjo vizitë është evidentuar se përkundër inaugurimit të këtij institucioni, ende kishte punë të pa përfunduara si dhe në disa hapësira mungonte inventarizimi. Tek dhomat e buta në të dy krahët punët ende nuk kishin përfunduar, si muret dhe dyshemeja, si dhe ndriçimi. QKRMt kishte kërkuar informacion rreth funksionalizimit të këtyre dhomave, mirëpo sipas përgjigjes së DShB-së këto dhoma nuk do të aplikohen, sipas rekomandimeve të ekspertëve nga Këshilli i Evropës.

Dhomat e vizitave familjare ishin mjaft të vogla ndërsa hapësira ishte e ndarë me xham të tejdukshëm me disa vrima. Ngjitur me dhomat e vizitave gjendej një korridor i vogël, i cili nuk mbulohej nga kamerat e sigurisë. Gjithashtu, ambientet e kuzhinës ishin të pa rregulluara dhe jashtë funksionit. Ushqimi parashihej të shpërndahet nga kuzhina e përgjithshme e QK Dubravë, e cila ka një distancë të largët prej këtij pavijoni.

Nga vizitat e tjera monitoruese në QK Dubravë, ekipi i QKRMt-së u njoftua se menaxhimin e Pavijonit D e bënë DShB, ndërsa ShKK ka përgjegjësi vetëm për aspektin e sigurisë. Sipas menaxhmentit të QK Dubravë, puna e stafit të ShKK në këtë pavijon kryhet nga 4 ndërrime, në përbërje prej 7 oficerëve në një ndërrim.

Sipas informacionit nga DShB, ky pavijon ka kapacitet për vendosjen e 60 të burgosurve, sipas 3 kategorive:

- 20 shtretër për trajtim të shtuar mental (personat që kanë rrezik vetëvrasje dhe çrregullime akute, të përkohshme, mendore);
- 20 shtretër për trajtimin e personave me sëmundje të varësisë (trajtimi i varësive, trajtimi zëvendësues, terapia okupuese dhe rehabilitimi); dhe
- 20 shtretër për trajtimin e sëmundjeve kronike (trajtimi i personave me sëmundje kronike me kujdes permanent shëndetësor, të monitoruar).

Meqenëse QKRMT nuk kishte qasje në monitorimin e shëndetësisë, nuk ka pasur mundësi që ta vizitojë këtë pavijon pas fillimit të popullimit të tij, mirëpo të dhënat janë marrë nga të burgosurit dhe stafi i QK Dubravë.

Sipas menaxhmentit të QK Dubravë, gjatë vizitës monitoruese në muajin gusht 2023 ishin të vendosur 14 të dënuar me probleme jo të rënda të shëndetit mendor, pra raste të menaxhueshme, përzgjedhja e të cilëve është bërë nga komisioni multidisiplinor. Bazuar në monitorimin e pavijoneve të tjera, ku personat me çrregullime të rënda mendore janë të vendosur, QKRMT konsideron se përzgjedhja e rasteve më të lehta dhe të menaxhueshme për t'u vendosur në Pavijonin D, përderisa rastet e rënda mbesin nëpër pavijone të tjera, mund të jetë kundër qëllimit të ndërtimit të këtij institucioni.

Po ashtu, QKRMT ka evidentuar shumë raste të cilët dërgohen në Pavijonin 5 për vëzhgim permanentet apo çdo 15 minuta për shkak të rrezikut për vetëvrasje, ndërsa të njëjtit nuk ishin vendosur në Pavijon D, i cili është funksionalizuar për këtë qëllim.

Gjatë vizitës monitoruese në muajin dhjetor 2023, ekipi monitorues u njoftua se në Pavijonin D deri ishin vendosur 20 të burgosur.

QKRMT ka evidentuar dy raste të cilët për shkak të mos përshtatjes janë kthyer nga Pavijoni D në Pavijonin 7.

***QKRMT rekomandon që të burgosurit e vendosur në Pavijonin D të vlerësohen paraprakisht dhe të përpilohet plan individual i trajtimit në mënyrë që vendosja e tyre në atë Pavijon ta arrijë qëllimin e trajtimit dhe mbikëqyrjes adekuate.***

***Sa i përket infrastrukturës së këtij Pavijoni, QKRMT rekomandon që të intervenohet në grilat e jashtme të dritareve dhe të njëjtat të përshtaten me qëllim e këtij institucioni.***

Në këtë institucion nuk ka hapësira të veçanta për gra dhe të mitur, prandaj trajtimi i këtyre kategorive do vazhdojë të jetë sfidues.

## 1.6. Lëndimet, vetëlëndimet, vetëvrasjet dhe vdekjet në burgje

Bazuar në indikatorët për ***lëndime, vetëlëndime, vetëvrasje dhe vdekje në burgje***, në mungesë të qasjes së monitorimit të shërbimeve shëndetësore në institucionet korrektuese, ekipi monitorues i QKRMT e ka pasur të vështirë t'i konfirmojë të dhënat e sakta dhe të monitorojë drejtpërdrejt trajtimin shëndetësor të këtyre rasteve. Megjithatë, në bazë të bisedave me të burgosurit dhe takimeve me zyrtarët e institucioneve korrektuese, QKRMT ka evidentuar se dukuria e lëndimeve dhe vetëlëndimeve brenda burgjeve është në rritje.

Sipas raportimeve nga të burgosurit, sidomos për rastet e vetëlëndimeve, arsyet pse i shkaktajnë vetëlëndimet kanë të bëjnë kryesisht me sistemin gjyqësor dhe mungesën e shërbimeve shëndetësore sipas kërkesave të tyre.

Duhet sqaruar se te lëndimet trupore, një numër i tyre janë shkaktuar edhe gjatë punës, gjatë aktiviteteve sportive apo aksidentalisht, mirëpo sipas pohimeve nga të burgosurit pjesa më e madhe e lëndimeve vijnë nga dhuna mes të burgosurve e në disa raste nga përdorimi i forcës fizike nga ana e stafit. Si do që të jetë, është shqetësuese rritja enorme e numrit të ***lëndimeve*** trupore brenda tri vjetëve, ku në vitin 2021 numri i lëndimeve ka qenë 283 ndërsa në vitin 2023 numri ka shkuar në **381** lëndime trupore të evidentuara.

Po ashtu edhe numri i vetëlëndimeve është në rritje të vazhdueshme ku në vitin 2021 janë evidentuar 102 vetëlëndime ndërsa në vitin 2023 kanë ndodhur 189 vetëlëndime brenda institucioneve korrektuese.

Kjo rritje e vazhdueshme e rasteve të lëndimeve trupore dhe vetëlëndimeve është indikacion për ***dhunën në burgje*** dhe mungesën e shërbimeve adekuate profesionale dhe shëndetësore në trajtimin dhe rehabilitimin e tyre.

*Krahasimi i rasteve të lëndimeve dhe vetëlëndimeve sipas viteve, referuar Raportit vjetor të punës së DShB-së për vitin 2023:*

	2020	2021	2022	2023
Lëndime trupore	278	283	341	<b>381</b>
Vetëlëndime	130	102	125	<b>189</b>

Sa i përket **vetëvrasjeve dhe tentim vetëvrasjeve**, në vitin 2023 ka pasur një menaxhim shumë më të mirë të rasteve me rrezik për vetëvrasje, ku ka pasur rënie të theksuar të atyre që kanë tentuar vetëvrasjen. Megjithatë, gjatë vitit 2023 ka ndodhur një vetëvrasje në burg ashtu sikurse edhe në vitin 2022 ku u shënua një rast i vetëvrasjes.

Në këtë drejtim, sipas informacioneve zyrtare, **rol të rëndësishëm në parandalimin e vetëvrasjeve ka pasur zbatimin e Strategjisë për Parandalimin e vetëvrasjeve**, ku vlerësimi sistematik dhe koordinimi lidhur me rrezikun e shtuar për vetëvrasje, ka qenë i vazhdueshëm nga stafi i shëndetit mendor dhe me rezultate të kënaqshme në parandalimin e vetëvrasjeve. Sipas të dhënave zyrtare të publikuara nga DShB, gjatë vitit 2023 janë evidentuar 222 të burgosur me rrezik të lartë për vetëvrasje, të cilët janë trajtuar dhe përcjellur në vazhdimësi. Nga 222 rastet e evidentuara, 24 prej tyre kanë tentuar vetëvrasjen por me reagimin e shpejt të stafit korrektues dhe atij shëndetësor, 23 prej tyre kanë arritur që të shpëtojnë nga vdekja ndërsa një prej tyre fatkeqësisht e ka realizuar vetëvrasjen.

Në bazë të rasteve të evidentuara, vërehet që ekipi multidisiplinar për zbatimin e strategjisë për parandalimin e vetëvrasjeve kanë kryer punë të rëndësishme të cilët kanë ndikuar në rënien e numrit të vetëvrasjeve dhe tentim vetëvrasjeve.

*Në vijim është paraqitur tabela krahasuese me të dhënat e vetëvrasjeve dhe tentim vetëvrasjeve për vitet e fundit, referuar Raportit vjetor të punës së DShB-së për vitin 2023:*

	2020	2021	2022	2023
Tentim vetëvrasje	29	28	34	24
Vetëvrasje	3	3	1	1

**QKRMt inkurajon stafin shëndetësor që të vazhdojë me trajtimin e këtyre rasteve, duke sjellur rezultate konkrete në parandalimin e vetëvrasjeve në burgje.**



Gjatë vitit 2023 janë evidentuar 6 raste të vdekjes së të burgosurve, nga të cilat një vetëvrasje. Numër i njëjtë i regjistruar i vdekjeve ka qenë edhe në vitin 2022. Rastet e vdekjeve në burgje menjëherë janë raportuar në publik nga ShKK dhe DShB, ku janë paraqitur të dhënat se ku kanë ndërruar jetë të burgosurit, pra brenda institucioneve korrektuese apo në spitalet publike, si dhe të dhënat nëse të burgosurit kanë qenë me sëmundje paraprake.

Për rastet e vdekjeve të të burgosurve është obligative kryerja e autopsisë, në mënyrë që të konstatohet shkaku i vdekjes. Ekipi monitorues i QKRMT-së e ka pasur të pamundur të marrë informacione të sakta për rastet e vdekjeve, pasi që institucionet korrektuese nuk posedonin raportin e autopsisë, kështu që në raste të tilla zyrtarisht mbetet i panjohur shkaku i vdekjes.

***QKRMT vlerëson përpjekjet e stafit korrektues dhe atij shëndetësor për ofrimin e ndihmës emergjente ndaj të burgosurve.***

## 1.7. Mbipopullimi

Me ndërtimin e burgjeve të reja dhe kapaciteteve të mjaftueshme për vendosjen e të burgosurve, për vite me radhë mbipopullimi nuk ka qenë fenomen në institucionet korrektuese. Megjithatë, sa i përket qendrave të paraburgimit shpeshherë ka raste kur kapacitet janë të mbushura me të paraburgosur, po ashtu në rastet e renovimeve brenda këtyre objekteve, shfaqen situata të mbipopullimit.

Një situatë të tillë, QKRMT e ka evidentuar gjatë vizitës monitoruese të realizuar në korrik 2023 në Qendrën e Paraburgimit në Gjilan, ku për shkak të defekteve në sistemin e ujit, tre krahët e Pavijonit 2 ishin jashtë funksionit (në pritje të renovimit), ndërsa të paraburgosurit ishin zhvendosur në krahë të tjerë, duke krijuar mbipopullim në këtë institucion. Ekipi monitorues, **vizitoi dhjetë dhoma me nga një shtrat në të cilat ishte vendosur edhe nga një i paraburgosur me dyshekë në dysheme.** Po ashtu, në këto dhoma mungonin edhe karriget dhe tavolina. Përveç që të burgosurve nuk iu ishte siguruar shtrati, ashtu siç është e paraparë me ligj dhe me standardet ndërkombëtare, në atë periudhë temperaturat ishin shumë të larta, rreth 36 gradë celsius, kushte këto që ishin në kundërshtim me çdo standard për vendosjen e të burgosurve, duke pasur parasysh që të burgosurit mbaheshin të mbyllur brenda dhomës gjatë 22 orëve, ndërsa vetëm 2 orë gjatë ditës dilnin në shëtitje në ajër të pastër.

***Standardet ndërkombëtare dhe legjislacioni vendor parashohin që çdo të burgosuri duhet t'i sigurohet shtrati personal si dhe shtrojë e mbulojë e pastër.***

## Normat e Komitetit për Parandalimin e Torturës (KPT)

46. Mbipopullimi është një çështje me rëndësi direkte për mandatin e KPT. Të gjitha shërbimet dhe aktivitetet brenda një burgu do të ndikoheshin keq nëse do të kërkohej të mbaheshin në të më shumë të burgosur nga sa është projektuar të mbajë; cilësia e përgjithshme e jetës në institucion do të ulej, ndoshta konsiderueshëm. Për më tepër, niveli i mbipopullimit në një burg, ose pjesë të veçantë të tij, mundet të jetë i tillë që të jetë në vetvete çnjerëzor ose poshtëruës nga një pikëvështrim fizik.

50. KPT do të shtonte se është veçanërisht e shqetësuar kur gjen në të njejtin institucion një kombinim të mbipopullimit me aktivitete regjimi të varfëra dhe mjedise të papërshtatshme tualeti/larjeje. Efekti përmbledhës i këtyre kushteve mund të jetë skajshëm dëmshjellës për të burgosurit.



## Rregullat e Nelson Mandelës

Rregulli 12. Kur strehimi me fjetje është në qeli ose dhoma individuale, secili i burgosur duhet të kaloj natën i vetëm në qeli ose dhomë. Nëse për arsye të veçanta, si mbipopullimi i përkohshëm, bëhet e domosdoshme që administrata qendrore e burgjeve të bëjë një përjashtim nga ky rregull, nuk është e dëshirueshme që të ketë dy të burgosur në një qeli ose dhomë.

Rregulli 21. Secili i burgosur duhet, në përputhje me standardet vendore ose kombëtare, të ketë një shtrat të veçantë dhe me shtroje të ndara dhe të mjaftueshme që duhet të jenë të pastra kur iu jepen, të mbahen në rregull dhe të ndërrohen shpesh për të siguruar pastërtinë e tyre.



## Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale

Neni 37, paragrafi 3. Personit të dënuar i sigurohet shtrat i veçantë dhe shtresa e mbulesa të mjaftueshme të cilat duhet të jenë të pastra kur i jepen, duhet të mirëmbahen si duhet dhe të ndërrohen rregullisht.



*Bazuar në legjislacionin vendor dhe indikatorët ndërkombëtar në të cilët QKRMT e realizon monitorimin e vendeve të privimit nga liria, vendosja e të paraburgosurve në kushtet të tilla të akomodimit, në këtë rast mbipopullimit brenda dhomave, mund të përbëjë trajtim çnjerëzor ose poshtërues nga pikvështrimi i kushteve fizike, prandaj QKRMT ka kërkuar që QP në Gjilan në koordinim me Shërbimin Korrektues të Kosovës, urgjentisht të bëjë një zgjidhje për vendosjen e të burgosurve në kushte të akomodimit të pranueshme, ashtu siç parashihet me legjislacionin vendor dhe standardet ndërkombëtare, në mënyrë që të mënjanohet shkelja e të drejtave të personave të privuar nga liria.*

*Menjëherë pas vizitës, QKRMT i është drejtua Shërbimit Korrektues, Ministrisë së Drejtësisë, Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Institucionit të Avokatit të Popullit / Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, për ndërmarrjen e masave të menjëhershme për evitimin e asaj gjendje.*

Reagimi i Shërbimit Korrektues ishte i menjëhershëm, të cilët pas adresimit të QKRMT-së, njoftuan se **“të gjithë të burgosurit janë akomoduar në dhomat me shtretër sipas standardeve dhe janë duke u trajtuar si të burgosurit tjerë”**.

Po ashtu, QKRMT u njoftua nga Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës i Avokatit të Popullit, se kanë realizuar një vizitë në Qendrën e Paraburgimit në Gjilan dhe se **“të gjithë personat e privuar nga liria janë kthyer në dhomat e tyre”**.

QKRMT mirëpret reagimet e menjëhershme të institucioneve përkatëse për rastet e tilla, dhe vazhdon të komunikojë me to në frymën e bashkëpunimit në avancimin e standardeve për vendosjen dhe trajtimin e personave të privuar nga liria.

Por, raste të mbipopullimit brenda dhomave kishte edhe në QK Smrekonicë, ku dy dhomat në Pavijonin e Pranimit, të cilat kishin hapësirë nga rreth 20 metra katrore, kishin të vendosur nga 8 shtretër, situatë kjo që ishte në kundërshtime me standardet e akomodimit.

Qendra e Paraburgimit në Pejë funksiononte me kapacitete të plota, ndërsa QKRMT ka pranuar pohime se në raste të caktuara ka mbipopullim, ku përveç 4 shtretërve që janë me të burgosur vendoset edhe nga një tjetër në dyshekë (në dysheme) deri sa të lirohet ndonjë vend. QKRMT e ka kundërshtuar këtë praktikë, duke pasur parasysh kushtet e pa përshtatshme të banimit në këtë qendër, siç

është mungesa e ndriçimit natyror adekuat dhe mungesa e ventilimit. Sidomos gjatë kohës me temperatura të larta, kushtet e vendosjes për 4 persona ishin të pa pranueshme e jo për 5 (4 shtretër + 1 në dysheme, vetëm me dyshek).

Po ashtu, në QK Dubravë, thuajse në çdo pavijon janë të vendosur nga 4 të burgosur në një dhomë, ndërsa në disa krahë janë nga 6 shtretër.

Duke pasur parasysh që ka vende të lira në këtë institucion, përkatësisht pavijone që nuk janë në shfrytëzim, QKRMT rekomandon që të ketë shpërndarje të të burgosurve brenda institucionit dhe të evitohet vendosja e nga katër dhe gjashtë të burgosurve brenda një dhome.

Për më tepër, QKRMT vlerëson se në rast të Ratifikimit të Marrëveshjes mes Kosovës dhe Danimarkës, ku QP në Gjilan do t'i jepet në shfrytëzim Danimarkës, 200 të burgosurit e vendosur aktualisht në QP Gjilan, do të zhvendosen në qendra të tjera të paraburgimit gjë që mund të shkaktojë mbipopullim.

## 1.8. Përdorimi i forcës dhe keqtrajtimi

Institucionet Korrektuese në Kosovë, nga viti në vit kanë avancuar standardet për respektimin e të drejtave të njeriut në institucionet korrektuese. Në përgjithësi, QKRMT vlerëson se në institucionet korrektuese të Kosovës nuk ka torturë, e po ashtu nuk përdoren forma të tjera të keqtrajtimit si masa institucionale ndaj të burgosurve. Megjithatë, në disa raste, QKRMT ka pranuar informata për pretendim të përdorimit të forcës ndaj të burgosurve, duke përfshirë QK Dubravë, QP Prishtinë, QK për Femra në Lipjan dhe QK për të Mitur në Lipjan.

QKRMT me shqetësim i ka pranuar informatat për përdorim të forcës, sidomos në Qendrën Korrektuese për të Mitur, ku i ka hulumtuar dhe monitoruar këto raste.

QKRMT nuk kishte marrë njoftime paraprake nga menaxhmenti i burgjeve për përdorim të forcës ndaj këtyre rasteve, qoftë edhe kur përdorimi i forcës është konsideruar i domosdoshëm. Vetëm pas identifikimit dhe trajtimit të këtyre rasteve nga ekipi monitorues i QKRMT-së, nga menaxhmenti është marrë përgjigja që në rastet e identifikuar, përdorimi i forcës ka qenë proporcional dhe i domosdoshëm, duke u thirrur në dispozitat ligjore që lejojnë përdorimin e forcës proporcionale dhe të domosdoshme.

*Ligji për ekzekutimin e sanksioneve penale parasheh:*

### Neni 114

#### **Përdorimi i forcës dhe mjeteve shtrënguese kundër personave të dënuar**

1. Zyrtari korrektues përdorë forcën dhe mjetet shtrënguese kundër personit të dënuar vetëm kur ajo është e domosdoshme për parandalim të:
  - 1.1. arratisjes;
  - 1.2. sulmit fizik ndaj ndonjë personit tjetër;
  - 1.3. vetëlëndimit;
  - 1.4. shkaktimit të dëmeve materiale;
  - 1.5. rezistencës aktive, apo pasive gjatë ekzekutimit të urdhrave ligjorë nga zyrtari korrektues.

*Për disa nga rastet e identifikuar, QKRMT ka kërkuar hetim nga Inspektorati i Ministrisë së Drejtësisë, por të cilët pas hetimit të rasteve nuk kanë gjetur përdorim të forcës nga ana e stafit korrektues.*

Në vijim janë të përshkruara disa nga rastet e përdorimit të forcës të raportuara në QKRMT:

- Gjatë vizitave të rregullta monitoruese në Qendrën Korrektuese për të Mitur (QKM) në Lipjan, ekipet monitoruese pranuan pohime për përdorim të forcës fizike nga stafi korrektues. Në vizitën e realizuar në **shtator 2023**, ekipi monitorues i ndarë në dy grupe, pranoi informacione nga shumë të mitur se para disa ditësh kishte ndodhur një incident në objektin shkollor në QKM, ku stafi korrektues ka përdorur forcë fizike ndaj disa të miturve. Po ashtu, ekipi monitorues kishte vizituar 3 të miturit që gjendeshin nën “*masën e veçimit*” dhe bisedoi me ta. Sipas të miturve që ishin në veçim (në dhoma të ndara), si dhe të miturve që gjendeshin nëpër pavijonet e tjera, u njoftua se të miturit kanë pasur një incident mes vete në shkollë, me çrast ka intervenuar stafi korrektues për t’i ndarë. Sipas tyre, pasi që është ndalë përleshja, të gjithë të miturit e përfshirë në incident i kanë futur në dhomën e klasës dhe kanë ushtruar dhunë fizike (goditje me shuplaka) ndaj të gjithë të miturve që kanë qenë prezent në ato momente. Sipas të miturve të intervistuar, përveç goditjeve me shuplaka oficerët kanë përdorur edhe fjalë fyese. Si rezultat i këtij incidenti, të miturit e përfshirë (gjithsej 3) gjendeshin në veçim, duke e mbajtur masën disiplinore. Të miturit pohuan se

kanë kërkuar fleta për ankesa, mirëpo nuk iu është dhënë fleta apo formulari për paraqitjen e ankesës. Të miturit kishin disa ankesa për lëndime në qafë dhe kokë (pas veshëve).

- Në vizitën monitoruese të realizuar në **dhjetor 2023**, ekipi monitorues kishte pranuar ankesat nga 2 të mitur në QKM, të cilët pohuan se janë rrahur nga disa oficerë korrektues, pasi njëri nga të miturit kishte pasur një konflikt verbal me një të mitur tjetër. Sipas tyre, incidenti kishte ndodhur një ditë para vizitës monitoruese, ku të dy pohuan se janë futur në zyrën e oficerëve të krahut dhe janë goditur me grushte dhe shqelma si dhe janë ofenduar me fjalë fyese. Njëri i mituri i deklaroi ekipit monitorues disa shenja lëndimi, në pjesën prapa qafës, të cilat deklaroi se i ka nga dhuna e ushtruar nga oficerët korrektues, po ashtu pohoi se ndjente dhimbje në brinjë në anën e majte si dhe në dorën e djathtë. Sipas tyre, nuk u është lejuar që të përdorin telefonin për të kontaktuar me QKRMT, si dhe nuk janë dërguar për kontrollë mjekësore edhe pse një gjë të tillë e kanë kërkuar.
- Po ashtu, gjatë muajit **maj 2023**, QKRMT kishte pranuar informatë për përdorim të forcës ndaj një të mituri në QKM Lipjan. Gjatë vizitës së të miturit, ai kishte deklaruar se pas konfliktit që ka pasur me një të mitur tjetër, kanë intervenuar oficerët korrektues dhe ndaj tij përdorën forcë të tepruar fizike. QKRMT ka kërkuar nga Inspektorati i Ministrisë së Drejtësisë që të hetohet ky rast. Sipas raportit të inspektimit, Inspektorati ka konstatuar: *se janë ndërmarrë të gjitha veprimet ligjore nga udhëheqësit e institucionit ku kanë parandaluar veprimin e të miturve pasi që sipas vlerësimit tek këta dy të mitur vërehet se kanë jo stabilitet dhe probleme shëndetësore dhe konsiderohen si recidivist për thyerje të rendit shtëpiak. Në raportin mjekësor është evidentuar se i mituri ka gjendje psikologjike jo stabile dhe është në terapi të psikiatrit, psikologut. Ndërsa, nga deklaratat e të miturit e dhënë para Inspektoratit, i mituri i kishte kërkuar falje stafit që i ka akuzuar gabimisht. Duke vazhduar se këtë deklaratë është duke e shkruar në prezencë të prindërve të tij, pa kurrfarë presioni dhe se vet është fajtor. Deklaratë kjo e nënshkruar nga i mituri dhe prindërit e tij. Është i rëndësishëm fakti se pas përfundimit të kësaj deklarate, është shtuar edhe një fjali nga i mituri si në vijim: “dhe kërkoj falje inspektorit / kryesor”. Deklarata e tillë e dhënë gjatë hetimit, sidomos kërkim-falja ndaj inspektoratit është marrë me shumë rezervë nga QKRMT sepse çdo i burgosur, në këtë rast të miturit nuk kanë asnjë obligim që t’i kërkojnë falje inspektoratit të cilët e kryejnë inspektimin për çdo rast të dyshuar. Kështu që, ky rast ka vë në dyshim objektivitetin e hetimit nga inspektorati!*

Raste e tilla të paraqitura nga të miturit për përdorim të forcës, si dhe rast e shpeshta të dhunës mes të miturve, janë alarm për institucionet e drejtësisë, dhe se duhet të ndërmerren masa urgjente për rehabilitimin, edukimin dhe riintegrimin e tyre, në mënyrë që kur të dalin në liri të jenë të përgjegjshëm dhe të edukuar, e jo të dalin më sjellje më problematike se sa kur kanë hyrë në burg.

- Ekipi monitorues mori informacion për një rast të përdorimit të forcës në QP Prishtinë në maj **2023**. Gjatë bisedës me të burgosurin, ai ka njoftuar ekipin monitorues lidhur me incidentin e datës 17.05.2023, ku sipas tij, disa oficerë korrektues kanë përdorur forcë fizike ndaj tij. Në bazë të takimit me të burgosurin dhe stafin e QP Prishtinë si dhe shikimit të dokumenteve dhe dosjes, ekipi monitorues ka evidentuar se: me datë 15.05.2023 të burgosurit i është gjetur lëndë narkotike dhe i njëjti është dërguar në veçim (në pritje të procedurave hetimore); pas formimit të komisionit dhe hetimit të rastit, më datë 17.05.2023 i është shqiptuar masa e vetmisë prej 10 ditësh; pas shqiptimit të masës së vetmisë, një oficer korrektues ka shkuar në dhomën ku i burgosuri ka qenë i veçuar dhe e ka njoftuar lidhur me masën disiplinore, ku edhe ka ndodhur incidenti, më pas kanë shkuar edhe dy oficerë të tjerë; të njëjtën ditë ka ndodhur edhe një incident në dhomën e vizitës me avokat; pas incidentit në dhomën e veçimit, më datë 18.05.2023 zv. i drejtorit të QP Prishtinë me Vendim ka formuar Komisionin hetimor për përdorimin e forcës së pretenduar, ku është kërkuar nga Komisioni që të konstatojnë se a është përdorur forca proporcionale për ta vënë situatën në kontroll; tre oficerët korrektues të përfshirë në incident kishin deklaruar se pas hyrjes në dhomë, oficeri është sulmuar nga i burgosuri, pastaj është dashur që ta përdorin forcën reciproke – proporcionale në mënyrë që i burgosuri të mbahet nën kontrollë. Ekipi monitorues ka shikuar edhe fotografitë në dosje, ku vërehej oficeri i lënduar gjatë këtij incidenti. Pas kësaj ngjarje i burgosur ka pasur takim me avokatin e tij, ku gjatë takimit është vetëlënduar me qëllim që t'i fajësojë stafin korrektues për këto lëndime. Pas zbulimit nga kamerat e sigurisë, është vërtetuar që i burgosuri ka shkaktuar vetëlëndime sipas udhëzimeve të avokatit mbrojtës, për çka rasti është iniciuar edhe në Odën e Avokatëve.

Në raportin e Komisionit hetimor të përpiluar me datën 19.05.2023, përveç çështjeve të tjera që janë listuar, sa i përket qëllimit kryesor të punës së këtij komisioni, pra të hetojë se **“a është përdorur forca proporcionale për ta vënë situatën në kontroll”**, në njërin nga pikat e raportit është konstatuar si në vijim: “Momenti kritik i incidentit të pretenduar nuk shihet në kamerë”.

Meqenëse në bazë të hetimeve të brendshme nuk ishte konstatuar se përdorimi i forcës ka qenë proporcional dhe i domosdoshëm apo jo, QKRMT iu drejtua Inspektoratit të Ministrisë së Drejtësisë që ta hetojë këtë rast. Rast ky që sipas procedurave, Inspektorati është dashur ta hetojë edhe pa iniciimin e QKRMT-së.

QKRMT ka kërkuar raportin e Inspektoratit, i cili pas hetimit të rastit vjen në këtë përfundim: *Inspektorati pas shqyrtimit të rastit, administrimit të provave, marrjes së dëshmimeve nga zyrtarët korrektues, bisedën me ish-zv. Drejtorin e institucionit, si dhe shikimit të kamerave konstaton se veprimet e ndërmarra nga Institucioni janë të drejta dhe në përputhje me procedurat ligjore si dhe rregulloreve të Institucionit në aspektin e sigurisë.*

**QKRMT ka analizuar Raportin e Komisionit të brendshëm hetimor dhe Inspektoratit, mirëpo vërehet që hetimi dhe trajtimi i këtij rasti nuk ka pasur përfundime të qarta dhe konkrete se përdorimi i forcës ka qenë proporcional dhe i domosdoshëm.** Përdorimi i forcës ishte evident, po ashtu raportimi dhe fotografitë për lëndimin e oficerit korrektues, mirëpo mungon përfundimi i arsyetuar nga Komisioni dhe Inspektorati që përdorimi i forcës ka qenë në përputhje me ligjin dhe procedurat përkatëse.

Përkundër evidencave zyrtare se i paraburgosuri e ka sulmuar fizikisht oficerin korrektues të dëshmuara edhe përmes fotografive, ekipi monitorues nuk ka evidentuar ndonjë masë disiplinore apo procedurë tjetër ndaj të paraburgosurit, përveç shqiptimit të masës së vetmisë në kohëzgjatje prej 10 ditësh për rastin e gjetjes së kontrabandës – lëndëve narkotike (për çka edhe është njoftuar policia).

Përdorimi i forcës fizike është i lejuar në rrethana të caktuara sipas LESP dhe procedurave të tjera, mirëpo e njëjta duhet të raportohet dhe evidentohet sipas procedurave përkatëse, prandaj edhe iniciimi i këtij rasti ka qenë që të inspektohet se a është përdorur forca fizike konform dispozitave ligjore dhe procedurave përkatëse.

- Po ashtu, në QK Dubravë, të burgosurit kanë pohuar se ka përdorim të forcës, kryesisht duke iu referuar rasteve të të burgosurve të tjerë, mirëpo nuk ka pasur më shumë informata rreth atyre rasteve.
- Gjithashtu, në QK për Femra në Lipjan, një e burgosur ka raportuar për përdorim të forcës fizike ndaj saj. QKRMT ka njoftuar Inspektoratin, të cilët e kanë hapur rastin dhe me rastin e vizitës së të burgosurës, ajo kishte



shkaktuar disa vetëlëndime. Inspektorati kanë konstatuar se vetëlëndimet ishin të freskëta dhe nuk korrespondojnë me pohimet për përdorim të forcës së pretenduar që ka ndodhur para disa ditësh.

## 1.9. Vendosija dhe trajtimi i të paraburgosurve

Masa e paraburgimit ndaj personave të paraburgosur ekzekutohet në qendrat e paraburgimit (Prishtinë, Gjilan, Prizren, Pejë dhe Mitrovicë), në Burgun e Sigurisë së Lartë, në QKM, në QKF si dhe rastet me probleme shëndetësore në Stacionarin e QK Dubravë.

Trajtimi i të burgosurve bëhet sipas Kodit të Procedurës Penale dhe Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, mirëpo për çdo veprim ndaj tyre duhet të njoftohet gjykata dhe gjyqtari kompetent.

Gjatë viti 2023, të gjitha qendrat e paraburgimit kanë qenë duke funksionuar me kapacitete të plota, pra numri i vendeve të lira ka qenë shumë i ulët.

Një prej shqetësimeve që QKRMT adreson në zbatimin e paraburgimit është mbyllja e tepërt e të paraburgosurve, të cilët në mungesë të aktivitete, thuajse gjithë ditën e kalojnë të mbyllur brenda qelive, me përjashtim të 2 orëve shëtitje në ajër të pastër. Pra, ata qëndrojnë të mbyllur brenda qelive për 22 orë.

***QKRMT ka rekomanduar që meqë nuk ka kufizime ligjore, të ri-organizohet rutina për të paraburgosurit, në mënyrë që gjatë ditës të jenë të lirë brenda krahut.***

Po ashtu, në disa qendra të paraburgimit, të paraburgosurve u ndalohe mbajta e orës brenda burgut, ku shpesh të paraburgosurit kanë paraqitur ankesa se nuk kanë se si të orientohen në kohë. Përveç kësaj, në disa qendra numri i kanaleve televizive ishte vetëm 3-4 programe.

Për më tepër, ekipi monitorues ka evidentuar disa raste, të cilët për muaj të tërë ishin pa aktakuzë.

## 1.10. Ekzekutimi i masës së vetmisë

QKRMT i kushton kujdes të veçantë edhe ekzekutimit të masës së vetmisë, përkatësisht kushteve të mbajtjes së vetmisë.

Në QK Dubravë masa e vetmisë ekzekutohet në një krahë të veçantë në Pavijonin 5, ku kushtet nuk janë të përshtatshme as për së afërmi me standardet e të drejtave të njeriut, ndërsa në institucionet e tjera korrektuese, masa e vetmisë ekzekutohet në dhoma të veçanta brenda njësive. Në BSL dhe QP Prishtinë, pavijonet e veçanta të vetmive nuk janë në shfrytëzim për shkak se nuk i plotësojnë kushtet fizike, ndërsa në QP Gjilan masa e vetmisë ekzekutohet në pjesën e veçantë, ku sipas monitoruesve konsiderohet si hapësirë joadekuate për vendosjen e të burgosurve.

Sa i përket vizitave mjekësore të rregullta gjatë ekzekutimit të masës së vetmisë, QKRMT ka evidentuar se në QK Dubravë, të burgosurit në vetmi nuk vizitohen nga mjeku, por vetëm nga infermierët. Kjo praktikë është në kundërshtim me Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, i cili përcakton qartë se të burgosurit duhet të vizitohen çdo ditë nga mjeku gjatë ekzekutimit të masës së vetmisë. Përkatësisht neni 111, paragrafi 3 i këtij Ligji përcakton: *“Personi i dënuar në vetmi vizitohet nga mjeku çdo ditë kurse nga drejtori i institucionit korrektues dhe punëtori social një herë në shtatë (7) ditë, apo kur e kërkon nevoja edhe më shpesh”*. Përveç që të burgosurit nuk vizitohen nga mjeku çdo ditë siç është përcaktuar me ligj, me Udhëzimin Administrativ MD-Nr.10/2023 për Rendin Shtëpiak në Institucionet Korrektuese është përcaktuar që: *“I burgosuri duhet të vizitohet nga personeli mjekësor çdo ditë si dhe nga drejtori i institucionit korrektues një herë në shtatë (7) ditë, varësisht nga nevoja edhe më shpesh, ndërsa zyrtari social të paktën një herë në 3 ditë”*. Me këtë dispozitë të Udhëzimit Administrativ që është në kundërshtim me Ligjin, iu është mundësuar që infermierët të kryejnë vizitat pa praninë e mjekut.

**QKRMT rekomandon që të zbatohen dispozitat ligjore të LESP dhe çdo i burgosur me masë të vetmisë, të vizitohet çdo ditë nga mjeku.**

Një shqetësim tjetër që QKRMT ka adresuar në Qendrën Korrektues për të Mitur, është shqiptimi i masës së vetmisë ndaj të miturve.

Kodi i Drejtësisë për të Mitur ka përcaktuar se të miturve nuk mund t’u shqiptohet masa e vetmisë. Neni 90 paragrafi 2 i Kodit të Drejtësisë për të mitur: *“Të miturit nuk i shqiptohet veçimi në qeli të veçantë si dënim disiplinor”*.

Praktika e shqiptimit të vetmisë, i quajtur “veçim” është shqiptuar vazhdimisht ndaj të miturve si masë disiplinore. Në vizitën në QKM në shtator 2023, kur QKRMT kishte vizituar 3 të mitur në veçim, kërkoi që kjo praktikë të ndalet menjëherë sepse është në kundërshtim me Kodin e Drejtësisë për të Mitur. Në vijim, QKRMT është njoftuar nga menaxhmenti i QKM-së dhe ShKK-së se më nuk është shqiptuar masa e vetmisë / veçimit ndaj të miturve.

***QKRMT ka mirëpritur reagimin e QKM-së dhe ShKK-së, në ndërprerjen e kësaj praktike të kundërligjshme.***

Për më tepër, të miturve që gjendeshin në vetmi u ishte ndërprerë procesi mësimor, po ashtu nuk kishin qasje në libra shkollore.

### **1.11. Trajtimi i kërkesave dhe ankesave të të burgosurve**

Mekanizmi i ankesave të brendshme në institucionet korrektuese ende mbetet në nivelin jo të kënaqshëm në trajtimin e ankesave nga të burgosurit, si në aspektin kohor të trajtimit të tyre po ashtu edhe në mbrojtjen e konfidencialitetit, pra situata është e njëjtë sikurse në vitet paraprake.

Të burgosurit kanë mundësinë që ankesat e tyre t'i paraqesin në dy forma: përmes formularit të hapur, të cilin mund ta dorëzojnë përmes mbikëqyrësit përkatës, si dhe përmes kutive të ankesave.

Ankesat e dorëzuara përmes kutive të ankesave mbrojnë konfidencialitetin sepse është i caktuar vetëm një zyrtar për hapjen e kutive të ankesave dhe ajo adresohet tek personi që i është drejtuar. Mirëpo, në praktikë shumë pak shfrytëzohet kjo mundësi e paraqitjes së ankesave. Sipas të burgosurve, arsyeja e mos dorëzimit të ankesave përmes kutisë së ankesave është se vonohen shumë gjatë përgjigjet në ankesë, e ka raste që nuk marrin asnjëherë përgjigje në ankesë dhe nuk kanë se si të drejtohen për të kërkuar përgjigje.

Sa i përket dorëzimit të ankesave përmes formularëve të hapur, ka raste që përdoret kjo formë, mirëpo e njëjta nuk garanton konfidencialitet, sidomos nëse ankesa ka të bëjë me stafin korrektues brenda Pavijonit apo krahut, pasi që në formë të hapur duhet ta dorëzojë përmes mbikëqyrësit të asaj njësie. Sipas të burgosurve në rastet e tilla kur paraqesin ankesa, nëse janë të përfshirë në ankesë oficerët e njësisë ku janë të vendosur të burgosurit, ata hakmerren ndaj tyre duke mos i trajtuar në mënyrë të barabartë me të burgosurit e tjerë.

Gjatë vizitave monitoruese, ekipi i QKRMT-së ka evidentuar se të dënuarit i sillnin ankesat direkt te zyra e mbikëqyrësit të lartë dhe se nuk kishte kopje kthyese për të burgosurit, po ashtu ankesat ishin të hapura dhe në këtë rast të dhënat e të burgosurve rreth ankesës nuk ishin konfidenciale.

Forma e ankesës është e hartuar në dy gjuhë: shqip dhe serbisht. Sa i përket të burgosurve të komunitetit serb, ata i aplikojnë këto forma dhe ankesën e adresojnë në gjuhën serbe, mirëpo ka raste që përgjigja në ankesë ju kthehet në gjuhën shqipe dhe me këtë rast duhet dikush nga stafi apo nga të burgosurit t’ia përkthejnë përgjigjen në ankesë. Sa i përket të burgosurve shtetas të huaj, nuk ka ndonjë formë të veçantë në gjuhën që e kuptojnë, dhe në këto raste shumë herë të burgosurit nuk arrijnë t’i adresojnë ankesat dhe shqetësimet. Po ashtu, jo çdo herë ka kopje të mjaftueshme të formularëve të ankesave në secilën njësi të institucioneve korrektuese.

## 1.12. Bastisjet e qelive

QKRMT ka pranuar ankesa nga të burgosurit se ka bastisje të shpeshta. Sipas stafit, këto bastisje kryhen me qëllim të luftimit dhe parandalimit të kontrabandës. Të burgosurit kanë pohuar se gjatë bastisjeve nuk lejohet asnjë nga të burgosurit të qëndrojnë brenda qelisë, veprim ky që është në kundërshtim me LESP. Neni 34, paragrafi 9 i LESP: *“Kontrollimi i qelisë së burgut të personit të dënuar ose të paraburgosurit duhet të kryhet me respektimin e pasurisë së tij personale dhe në prani të të dënuarit ose të paraburgosurit, përveç nëse prania e tyre do të paraqiste një kërcënim të menjëhershëm për stafin ose sigurinë e objektit.”*

## 2. KUSHTET MATERIALE

Në përputhje me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, Ligji për Ekzekutimin e Sankcioneve Penale ka përcaktuar kushtet e banimit se *“Personi i dënuar ka të drejtë në banim që i përgjigjet kushteve bashkëkohore higjienike dhe rrethanave vendore klimatike; Hapësirat në të cilat jeton dhe punon personi i dënuar duhet të kenë hapësirë të mjaftueshme ashtu që secili person i dënuar të ketë së paku tetë (8) metra katrorë hapësirë për qeli të vetme dhe katër (4) metra katrorë për të dënuarit në qeli të përbashkëta, dhe sasi të mjaftueshme të dritës natyrore dhe artificiale për punë dhe lexim, ngrohje dhe ajrosje; Hapësirat nuk duhet të kenë lagështi dhe duhet të kenë pajisje sanitare adekuate dhe mjete të tjera të nevojshme për higjienë personale; Në hapësira të përbashkëta vendosen personat e dënuar të cilët janë të përshtatshëm për t’u shoqëruar me të tjerët në kushtet e tilla”*. Po ashtu, edhe për të paraburgosurit është përcaktuar se: *“Të paraburgosurit në institucionin korrektues përkatës qëndrojnë nën kushtet e njëjta sikurse edhe personat e dënuar lidhur me vendosjen, ushqimit, mbrojtjes shëndetësore, përdorimit të masave të dhunës, të masave të veçanta për mbajtjen e rendit dhe sigurisë, dhe kompensimit për dëmin e shkaktuar gjatë kohës së zbatimit të masës së paraburgimit.”*

Nisur nga këto dispozita ligjore që janë në fuqi si dhe standardeve ndërkombëtare, ekipi monitorues i QKRMT-së me vëmendje ka vrojtuar kushtet e banimit në institucionet korrektuese. Standardi i kushteve materiale të vendosjes së të burgosurve ndryshon nga institucioni në institucion, për shkak se edhe objektet ndryshojnë për nga vjetërsia dhe infrastruktura ndërtuese. Në vitet e fundit, me ndërtimin e objekteve të reja të banimit ka pasur ngritje të lehtë të cilësisë së kushteve të banimit, mirëpo nga viti në vit kanë filluar defektet dhe amortizimi edhe i objekteve të reja, siç janë BSL, QP Gjilan dhe QP Prishtinë. Sa i përket objekteve të tjera të banimit në institucionet korrektuese, kushtet e banimit janë jo në nivel të kënaqshëm, duke pasur parasysh vjetërsinë e objekteve dhe nevojën e vazhdueshme për mirëmbajtjen e tyre.

Gjatë vitit 2023 Shërbimi Korrektues ka bërë renovime të vazhdueshme në disa nga hapësirat e institucioneve korrektuese (Pavijoni 3 dhe 5 në QK Dubravë, gëlqerosje në disa qendra të paraburgimit, intervenime në disa pjesë të QK Smrekonicë,etj), megjithatë nga këndvështrimi i përgjithshëm monitorues, në shumë ambiente të banimit mungojnë kushtet e përshtatshme të jetesës, duke përfshirë: lagështinë, defektet në nyjat sanitare, mungesën e ujit të ngrohtë, vjetërsia e dyshekëve (me përjashtimit të furnizimit me dyshekë nëpër disa institucione), mungesën e jastëkëve dhe shtrojës e mbulojës adekuate (në shumë

raste të burgosurit i sjellin nga shtëpia), mungesën e ventilimit, tualetet brenda dhomës pa ndarje fizike (QP Prishtinë), rrjedhjen e ujit nëpër mure (QK Dubravë dhe QK për Femra Lipjan), mungesën e ndriçimit natyral (QP Pejë), mungesa e karrigeve dhe tavolinave në shumë ambiente të banimit, mungesën e inventarit për gjësende personale, etj.

Shqetësuese mbetet edhe gjendja e dusheve në QK Dubravë, ku të burgosurit ende përdorin mjete alternative të rrezikshme për ngrohjen e ujit për pastrim.

Në QP Prishtinë, në disa nga krahët e institucionit, struktura e tualeteve brenda dhomave është pa ndarje fizike. Në disa nga dhoma janë të vendosur nga dy persona ndërsa tualetet janë të hapura, ku përveç kësaj për shkak të statusit si të paraburgosur ata gjatë 22 orëve mbahen të mbyllur në këto ambiente, ku edhe ushqimin e konsumojnë aty.

***QK RMT ripërsërit rekomandimin që sa më parë të kufizohen me mure pjesët e tualeteve brenda dhomave.***

QK RMT vazhdimisht ka rekomanduar që të përmirësohen kushtet e banimit për të burgosurit sepse situata të tilla janë në kundërshtim me standardet e të drejtave të njeriut. Kushtet e pa përshtatshme të banimit mund të qojnë në trajtim çnjerëzor ose poshtëruës nga pikvështrimi i kushteve fizike.

Po ashtu, Pavijoni 2 në QK Dubravë për më shumë se dy vjet ishte jashtë funksionit, në pritje të renovimit. Edhe kati i II-të i Pavijonit 2 në BSL për më shumë se dy vjet ishte jashtë funksionit dhe në pritje të renovimit. Në BSL, korridoret ishin shumë të dëmtuara dhe është i domosdoshme renovimi. Gjithashtu Pavijoni 2 i QP Gjilan ishte jashtë funksionit për shkak të defekteve të njave sanitare.

Në disa institucione, renovimet e bëra kanë dështuar të mirëmbahen për shkak se kompanitë kontraktuese kanë aplikuar pajisje, kryesisht sanitare, të cilat nuk janë të qasshme në tregun vendor, kështu që për një prishje sa do të vogël, ato nuk mund të zëvendësohen.

Në QK Dubravë, dhomat janë kryesisht me nga 4 shtretër, mirëpo ende ka dhoma me nga 6 shtretër.

QP Pejë dhe QP në Prizren janë dy nga institucionet korrektuese më të vjetrat për nga koha e ndërtimit, dhe rekomandimi i vazhdueshëm ka qenë që këto

qendra duhet të mbyllet dhe të zëvendësohen me qendra të reja. Po ashtu në Qendrën Korrektuese për Femra në Lipjan kushtet e banimit as për së afërmi nuk iu përgjigjen kërkesave dhe nevojave të burgosurave në këtë institucion, ku vazhdimisht është rekomanduar për ndërtimin e objekteve të reja për këto institucione.

Në QP Pejë janë të vendosur nga 4 shtretër nëpër dhoma, ndërsa hapësira sipas standardeve është e paraparë për 3 shtretër. Po ashtu, struktura e dhomave është e njëjtë edhe në QP Prizren, mirëpo gjatë vitit 2023 menaxhmenti i ri kishte bërë ristrukturimin e qendrës, ku në çdo dhomë ishin vendosur vetëm nga 3 të burgosur në mënyrë që të krijohet hapësirë më e përshtatshme. Po ashtu, QP në Prizren kishte aplikuar hapjen e dyerve të dhomave në mënyrë që të burgosurit të mund të lëviznin brenda krahut, sidomos gjatë verës kur temperaturat ishin shumë të larta. ***QKRMT i ka mirëpritur këto veprime në QP në Prizren, të cilat sado pak kanë ndikuar në kushte më të mira të akomodimit.*** Gjithashtu, QKRMT ka vlerësuar që përkundër që janë objekte tejet të vjetra (QP Prizren dhe QP Pejë), niveli pastërtisë në këto objekte ishte i kënaqshëm.

Objekti i veçantë për nëna me fëmijë, i cili është i paraparë si i tillë, përveç që ishte jashtë QKF në Lipjan (i vendosur në hapësirat e QKM), kushtet e akomodimit në këtë objekt ishin nën standard. Gjatë vitit 2023 ekipi monitorues ka vizituar një nënë me fëmijë e cila ishte në vuajtje të dënimit, ku vlerësoi se as kushtet elementare nuk ekzistonin. ***Megjithatë QKRMT ka mirëpritur fillimin e ndërtimit të objektit të ri në afërsi të QKF, punimet për ndërtimin e të cilit kanë filluar gjatë vitit 2023.***

***QKRMT e ka mirëpritur planifikimin dhe ndarjen e buxhetit për ndërtimin e qendrave të reja për këto institucione. Kështu që me buxhetin për investime kapitale të ndarë për Shërbimin Korrektues është planifikuar ndërtimi i qendrës së re për gra në Lipjan, si dhe ndërtimi i Qendrës së re të Paraburgimit në Prizren, në të cilën parashihet të vendosen të burgosurit nga QP Prizren dhe QP Pejë.***

***QKRMT rekomandon që të ketë renovime të vazhdueshme, përkatësisht të trajnohen edhe të burgosurit dhe të angazhohen në renovime, në mënyrë që përveç që kontribuojnë në mirëmbajtje të institucioneve, kjo do të ndikonte që të jenë më të kujdesshëm në ruajtjen e objekteve dhe higjienës.***

**Po ashtu, QKRMT rekomandon që të ketë furnizim me karrige dhe tavolina për çdo dhomë, si dhe të ketë furnizim të mjaftueshëm dhe cilësor me dyshekë dhe shtrojë e mbulojë, dhe ventilim adekuat.**

**Renovime të përgjithshme dhe të menjëhershme duhet të bëhen në QP Gjilan, QP Prishtinë, BSL dhe QK Dubravë, ndërsa QP Pejë, QP Prizren dhe QKF Lipjan duhet mirëmbahen deri në ndërtimin e tyre.**

**Ngrohja:** Sa i përket ngrohjes, në fillim të sezonit dimërore ka pasur ankesa nga të burgosurat në QKF, mirëpo pas adresimit të këtij shqetësimi, është siguruar ngrohje e nevojshme. Në institucionet e tjera ka pasur ngrohje të përshtatshme dhe nuk ka pasur ndonjë shqetësim nga të burgosurit.

QKRMT ka evidentuar që aparatet për fikjen e zjarrit në të gjitha institucionet kanë qenë të pa servisuar për më shumë se dy vjet, për arsye të skadimit të kontratës së mirëmbajtjes së tyre.

**QKRMT ka rekomanduar që urgjentisht të ndërmerren masa për servisimin e rregullt të të gjitha pajisjeve për fikjen e zjarrit.**

## 2.1. Ushqimi dhe kuzhina

QKRMT ka monitoruar ushqimin që ju shërbehet të burgosurve si dhe kuzhinën me pajisjet përcjellëse. Në disa nga institucionet e monitoruara janë evidentuar prishje të pajisjeve të kuzhinës, si frigoriferët, pllakat elektrike, makinat për larjen e enëve (QKF, QP Prishtinë, QK Dubravë etj.). Në disa nga institucionet e monitoruara mungonte ruajtja e mostrave të ushqimit sipas procedurave, gjithashtu jo të gjithë të punësuarit në kuzhina kishin të vërtetuara librezat sanitare.

Sa i përket cilësisë së ushqimit, edhe pse herë pas here kishte ankesa nga të burgosurit, QKRMT vlerëson se ushqimi i përgatitur dhe shërbyer ishte i pranueshëm për nga cilësia dhe sasia. Përgjatë, në disa raste QKRMT ka pranuar pohime të rastet e dietave të përcaktuara nga mjeku, se institucioni jo çdo herë iu përmbahet këtyre dietave.



QKRMT ka pranuar disa ankesa sa i përket produkteve të kantinës, të cilat janë me pagesë për të burgosurit. Sipas tyre, çmimet janë më të shtrenjta se sa në tregun jashtë institucioneve; nuk ka shumë zgjedhje të produkteve; në disa raste në listën e ofertave shënohet vetëm lloji i produktit pa e përcaktuar emrin e prodhuesit, ndërsa pas porosisë ju sjellin produktet më pak kualitative. Përveç kësaj, ekipi monitorues ishte dëshmitar se një prej llojeve të orizit me të cilin furnizoheshin të burgosurit në QK Dubravë, brenda qeses së mbyllur përmbante insekte të gjalla (të lëvizshme). QKRMT e njoftoi menjëherë stafin e pavijonit dhe menaxhmentin e QK Dubravë dhe kërkoi që urgjentisht të largohet ky produkt nga përdorimi.

***QKRMT rekomandoi që Komisionet për pranimin e produkteve të jenë më profesional dhe të bëjnë verifikimin e produkteve para se t'i pranojnë nga kompanitë e kontraktuara.***

***Pranimi i pakove ushqimore nga familja*** – Me Ligjin e ri për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, i cili ka hyrë në fuqi nga viti 2022, të burgosurve të dënuar u lejohet pranimi i pakove ushqimore nga familja. Kjo e drejtë nuk ishte zbatuar deri kah mesi i vitit 2023 kur është nxjerrë Rregullorja e veçantë që i përcakton kushtet për zbatimin e kësaj të drejtë. Sipas ligjit, personit të dënuar i takon një pako ushqimore nga familja dhe atë njëherë në tre muaj, me kusht që artikujt ushqimor nuk do të shërbehen brenda institucionit korrektues. Me akt nënligjor u përcaktua se të dënuarit i takon një pako ushqimore çdo tre muaj në sasi prej 3 kg, ndërsa ushqimi duhet të konsumohet gjatë kohës së vizitës, përkatësisht në sallën e vizitave. Aplikimi i kësaj të drejtë ka paraqitur shumë sfida në menaxhim, për shkak të hapësirave të pa përshtatshme në sallat e vizitave, e po ashtu i ka vu në situatë të pa përshtatshme të dënuarit e tjerë që kanë qenë në të njëjtën kohë në sallë të vizitave, ku disa të burgosur kanë konsumuar ushqim, ndërsa të tjerët i kanë shikuar. Po ashtu, edhe nga vetë të burgosurit janë paraqitur ankesa se është kohë e pa përshtatshme dhe e kufizuar që në prani të vizitorëve t'i konsumojnë 3 kg produkte ushqimore.

***QKRMT rekomandon që të rishikohet kjo dispozitë ligjore, dhe në momentin e parë që të bëhen plotësim dhe ndryshimet e ligjit, të ndryshohet kjo dispozitë dhe të burgosurve t'u lejohet marrja e ushqimit brenda dhomës pasi që praktika aktuale është vështirë e zbatueshme.***

### 3. SHËNDETËSIA NË BURGJE

Kanë kaluar më shumë se dy vjet që QKRMT nuk ka qasje në monitorimin e shëndetësisë në burgje, ku raportet mes QKRMT-së dhe DShB-së kanë mbetur të pa ndryshuara në aspektin progresiv të bashkëpunimit. Pas skadimit të marrëveshjes me Ministrinë e Shëndetësisë më 14.02.2022, QKRMT edhe gjatë vitit 2023 nuk ka pasur qasje në monitorimin e shëndetësisë në institucionet korrektuese sipas metodologjisë së punës. Sa i përket shërbimeve shëndetësore ndaj të burgosurve QKRMT ka bërë vlerësimin dhe raportimin nga intervistat me të burgosurit, familjarët e tyre dhe stafin e institucioneve korrektuese. Pra, monitorimi i zakonshëm që përfshinë takimin me mbikëqyrësin e Njësisë së Shëndetësisë, shikimin e dosjeve, protokolleve dhe të tjera, edhe gjatë viti 2023 nuk është realizuar.

Arsyeja e mos nënshkrimit të Marrëveshjes me Departamentin Shëndetësor të Burgjeve (DShB) / Ministria e Shëndetësisë (MSh) ishte ndryshimi i Marrëveshjes me Ministrinë e Drejtësisë për monitorimin e institucioneve korrektuese, e cila nga viti 2022 i mundëson QKRMT realizimin e **vizitave pa paralajmërim**. Realizimi i vizitave pa paralajmërim, nuk është lejuar nga Departamenti Shëndetësor i Burgjeve, me ç'rast edhe nuk është nënshkruar marrëveshja.

QKRMT vlerëson se për arritjen e qëllimit të monitorimit, është e nevojshme qasja në shërbimet shëndetësore për të burgosurit. QKRMT mbetet e gatshme për të vazhduar bashkëpunimin dhe është në pritje të përgjigjes së MSh-së për vazhdimin e marrëveshjes së bashkëpunimit.

Gjatë vizitave monitoruese, sikurse viteve të tjera edhe gjatë vitit 2023, QKRMT ka vazhduar të pranojë pakënaqësi në drejtim të shërbimeve shëndetësore. Ankesa dhe pretendime nga të burgosurit janë paraqitur sa i përket qasjes dhe trajtimit jo me seriozitet të kërkesave të tyre, vonesa dhe humbje të termineve në trajtimin e kërkesave për kontrolle specialistike jashtë institucionit, vonesa në realizimin e kontrolleve, ankesa në shërbimet stomatologjike, etj. Meqenëse të gjitha këto pretendime nuk janë vërtetuar për shkak të mungesës së qasjes monitoruese në shëndetësi, ekipi monitorues ka konstatuar se në disa raste, terapia nuk shpërndahej sipas rregullit, pra nga infermierët, por e njëjta u jepej të burgosurve në mëngjes për tërë ditën, e në disa raste terapia u lihej stafit korrektues që t'ia shpërndajë të burgosurve, praktikë kjo që është në kundërshtim me të gjitha protokollat për trajtimin e të burgosurve. Raste të tilla janë evidentuar në institucionet ku gjatë natës nuk kujdestaron çdo herë stafi

shëndetësor, siç ishte rasti me QK në Smrekonicë. Kjo praktikë ka vazhduar që nga vitet e mëhershme.

Sa i përket ankesave të lartcekura në drejtim të shërbimit shëndetësor, QKRMT i ka vërtetuar edhe gjatë prezencës së vizitave monitoruese, si në vijim:

- Mungesa e vizitave të rregullta ndaj të burgosurve nën masën e vetmisë në QK Dubravë, me përjashtim të vetëm disa mjekëve që i realizojnë këto vizita ashtu siç është obligim sipas ligjit;
- Ekipi monitorues gjatë vizitave nëpër dhomat e të burgosurve ka evidentuar sasi të konsiderueshme të medikamenteve të cilat janë grumbulluar nga të burgosurit, për shkak të keqmenaxhimit të shpërndarjes së terapisë. Raste të tilla paraqesin rrezik për tentim-vetëvrasje;
- Në anën tjetër ka pasur shumë ankesa që terapia e përshkruar ka munguar dhe në rastet që të burgosurit nuk kanë mundur të sigurojnë përmes familjes, kanë mbetur pa terapi. Ka pasur raste që për dy muaj kanë munguar barnat për trajtimin e trigliceriteve dhe kolesterolit;
- Gjatë një vizite monitoruese në QK Dubravë, në Pavijonin 4, një i burgosur me çrregullime mendore në vazhdimësi kërkonte që të vizitohet nga psikiatri, mirëpo përgjigja që i jepej ishte se është njoftuar mjeku mirëpo nuk është në radhë për t'u trajtuar;
- Ekipi monitorues ishte dëshmitar që një i burgosur që rezultoi me scabies, përkundër kërkesave për trajtim nuk ishte vizituar nga mjeku. I njëjti e ndalon mjekun në korridor dhe vetëm pasi ia tregon shenjat në trup, ndermirën veprime për trajtimin dhe izolimin e tij;
- Po ashtu, një i burgosur tjetër u ankua se kishte një muaj që i janë shfaqur disa shenja në trup. Vetëm njëherë e kishte kontrolluar mjeku, i kishte dhënë një krem për lyerje dhe asnjë vizitë tjetër. I burgosuri vazhdonte me ankesa të njëjta si: kruarje, temperaturë, dhimbje etj., mirëpo nuk vizitohej më nga mjeku;
- Ankesa të vazhdueshme kishte për mungesë të shërbimeve adekuate stomatologjike, sidomos në QK Dubravë;
- Të burgosurit që kanë qenë përdorues të substancave narkotike shpesh janë ankuar për mungesë të trajtimit, ku si pasojë janë ballafaquar më kriza të vazhdueshme;
- QKRMT, gjithashtu përmes telefonatave nga të burgosurit ka pranuar ankesa të shumta për mungesë të shërbimeve shëndetësore përkatëse: mos dërgimin për kontrole specialitike jashtë institucionit, ku raportojnë se janë trajtuar vetëm me medikamente për ndalimin e dhimbjeve (në shumë raste raportojnë se përdorin vetëm Trodon); humbje të terminëve pa e ditur

shkakun; vendosja e personave me probleme shëndetësore në dhoma me nga 6 shtretër / të burgosur; ankesa se ju kanë humbur rezultatet e analizave / ekzaminimeve, etj..

Në disa raste specifike kur ka pasur ankesa direkt nga të burgosurit, QKRMT i ka adresuar këto shqetësime në DShB nga të cilët ka marrë përgjigje për rastet në fjalë.

***Nisur nga ankesat e raportuara nga të burgosurit rreth shërbimeve dhe tretmanit shëndetësor, QKRMT e konsideron të domosdoshme qasjen në monitorimin e shërbimeve shëndetësore në institucionet korrektuese, me qëllim të adresimit dhe sqarimit të këtyre ankesave.***

***Prandaj, QKRMT ri-përsëritë kërkesën për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Departamentin Shëndetësor të Burgjeve, që ekipit monitorues të QKRMT-së t'i lejohet qasja sipas metodologjisë monitoruese.***

## 4. PROGRAMET DHE AKTIVITETET

Në të gjitha qendrat korrektuese ofrohen programe të ndryshme përmes trajnimeve profesionale, varësisht prej tipit të institucionit si dhe kategorisë së të burgosurve. Megjithatë në bazë të monitorimit vlerësohet se ka nevojë për më shumë programe varësisht prej vlerësimit individual të të burgosurve.

Megjithëse ekziston një plan individual i trajtimit, QKRMT e konsideron si mjaftë të mangët, pasi që në praktikë ofrimi i programeve, sidomos rehabilituese është i përgjithësuar, e jo në bazë të nevojave individuale të të burgosurve.

Në gjithë sistemin korrektues zbatohen tre programe të rregullta rehabilituese: “TOPS”, “Menaxhimi i zemërimit” dhe “Biseda për ndryshim”. Kohëve të fundit janë ofruar edhe disa trajnime, si: programi kundër dhunës në familje, Programi “Y+” dhe Programi “Trajtimi ndaj varesise”. Po ashtu, ka filluar zhvillimi i programit specifik për trajtimin e të burgosurve me varësi nga substancat narkotike, në të cilin kanë përfituar 6 persona.

QKRMT ka pasur rastin që të kontribuojë në fillet e tre programeve të para, ku ka qenë organizatë partnere në ngritjen e kapaciteteve të stafit për këto programe, në kuadër të projektit të mbështetur nga Komiteti Holandez i Helsinkut.

Trajnimet e organizuara gjatë vitit 2023 kanë qenë: instalimi i ujit, instalimi i elektros, instalimi i ngrohës, ndertimtari, IT, kuzhinieri, axhustator/saldues, zdrukhtari, rrobaqepësi dhe ndihma e parë. Në këto trajnime kanë marrë pjesë 175 të burgosur.

Në QK Dubravë, BSL, QKM dhe QKF ekzistojnë punëtoritë e ndryshme për prodhim të cilat janë funksionale dhe ka të burgosur të kualifikuar për angazhim. Megjithatë ka pasur raste që gjatë vizitave monitoruese ka pasur mungesë të materialeve bazë për punë, kështu që herë pas herë këto punëtori nuk mund të funksiononin plotësisht.

Në BSL të burgosurit janë të angazhuar në punëtoritë për produktet e drurit, të geseve dhe të letrës së tualetit. Të gjitha prodhimet janë shfrytëzuar për nevojat e institucioneve korrektuese.

Në QKF, gratë kryesisht janë të angazhuara në floktari dhe rrobaqepësi ku prodhojnë çarçafë për nevojat e institucioneve korrektuese, po ashtu u mundësohet edhe trajnimi për IT. Për një periudhë të gjatë ka pasur mungesë të trajneres së rrobaqepësisë në këtë qendër.

Të miturit në QEK kanë disa mundësi për t'u aftësuar, si në rrobaqepësi, floktari, kulinari, printim dhe dizajn, IT, etj. Gjatë vizitës monitoruese mungonte materiali për punë në këtë qendër, të cilët ishin në pritje të bashkëpunonin me UNICEF në mënyrë që të sigurohet material punues. Po ashtu, të miturve në QKM iu mundësohet organizimi i trajnimeve profesionale për instalues të ujit, ndërtimtari, IT, kuzhinier edhe elektro.

Për të miturit organizohen edhe aktivitete të ndryshme kulturore dhe turistike, ku u mundësohet realizimi i këtyre aktiviteteve edhe jashtë qendrës.

Në QK Dubravë gjatë vitit 2023, është hapur ferma e shpezëve, ku tani kanë mundësi që përveç angazhimit të të burgosurve në punë, këto shpezë të përdoren për nevojat e institucioneve korrektuese. Po ashtu, në QK Dubravë funksionon edhe stalla e bagëtive.

Përveç punëve profesionale, të burgosurit angazhohen në punët e përditshme të institucioneve korrektuese siç janë: pastrimi, lavaxantaria, kuzhina dhe bujqësia.

Për të gjitha angazhimet e të burgosurve në punë, ata shpërblehen me 1.00 euro për ditë pune, pavarësisht natyrës së punës që e kryejnë, shumë kjo e cila nuk është ndryshuar prej vitesh.

***Duke pasur parasysh mundësitë për angazhimin e të burgosurve, si dhe nevojat e institucioneve korrektuese për punë, QKRMT ripërsërit rekomandimin që sa më parë të funksionalizohet Njësia Ekonomike, ashtu siç është paraparë me ligj. Në këtë drejtim kërkohet ndërmarrja e veprimeve adekuate për përmirësimin e kushteve të punës për të dënuarit, përfshirë ngritjen e pagës si dhe pagesën e kontributeve.***

## Histori sukcesi

### **Katër (4) të burgosur të BSL-së që nga viti 2019 janë angazhuar për shtrimin e epoksidit në të gjitha institucionet korrektuese**

Kjo është një punë mjaftë profesionale, ku me gatishmërinë e tyre të burgosurit i kanë shërbyer Shërbimit Korrektues për shtrimin e epoksidit në disa institucione korrektuese, duke përfshirë: BSL, QK Dubravë, QK Lipjan, QP Mitrovicë.

Deri më tani, ky ekip i të burgosurve kanë shtruar rreth 12000 metra katrorë epoksid në institucionet korrektuese, ku vlera e këtyre punimeve llogaritet qindra mijëra euro.

Megjithatë, përkundër angazhimit profesional, dhe duke pasur parasysh mungesën e kapaciteteve për këtë profesion, të burgosurit e angazhuar në këtë punë paguhen sikur të burgosurit që kryejnë punë tjera, si p.sh. ai që pastron në krah. Pra, pagesa që marrin është rreth 24 euro në muaj.

### **QK Smrekonicë zbaton Udhëzimin Administrativ për punë jashtë institucionit**

Gjatë vizitës monitoruese në QK Smrekonicë, institucion korrektues i tipit të hapur, rreth 30 të burgosur apo 1/3 e të burgosurve të këtij institucioni gjendeshin në punë jashtë institucionit korrektues.

Puna jashtë institucioni është e rregulluar me Udhëzimin Administrativ MD-Nr.04/2023, i cili i rregullon kushtet dhe procedurat e veçanta për dhënien e lejes për të dënuarit që të punojnë jashtë institucionit korrektuese. Të dënuarit e interesuar për punë jashtë institucionit, duhet fillimisht të paraqesin kërkesë te Paneli i QK Smrekonicë, i cili bënë vlerësimin e kërkesave të tyre dhe jep propozime për ose kundër lejimit për punë jashtë institucionit. Drejtori i QK Smrekonicë vendosë më pas për dhënien e lejes ose jo. Ndër kriteret kryesore është edhe sigurimi i kontratës nga një biznes i regjistruar.

## 4.1.Shkollimi

Në Qendrën Korrektuese për të Mitur organizohet shkollim fillor dhe i mesëm. Deri në vitin 2023 shkollimi është ofruar nga klasa e 5-të e tutje. Pas rekomandimeve të vazhdueshme të QKRMT-së, në vitin e ri shkollor 2023/24 ka filluar organizimi i mësimi special për klasat 1-4, për të miturit që nuk dinin shkrim dhe lexim. QKRMT e ka mirëpritur zbatimin e këtij rekomandimi, i cili njëkohësisht zbaton dispozitat e Kodit të Drejtësisë për të Mitur me të cilin parashihet organizim i mësimi special për këtë kategori.

Një prej shqetësimeve, që QKRMT ka pranuar është se të miturve nuk u lejohej të kishin akses në librat e tyre. Pra, qasje në libra kanë vetëm gjatë orarit mësimor në ambientet shkollore. Po ashtu, të miturve që gjendeshin në veçim gjatë zbatimit të masës së veçimit, nuk u lejohej qasja në tekste mësimore.

Disa të miturve u është lejuar edhe angazhimi në studime jashtë institucionit korrektues.

Edhe në QK Dubravë organizohet shkollimi i mesëm. Ndërsa grave të burgosura nuk u mundësohet shkollim gjatë kohës së qëndrimit në institucion korrektues.



## 5. ÇËSHTJE TJERA TË MONITORUARA

### 5.1 Kapacitetet e institucioneve korrektuese dhe kushtet e punës së stafit

Gjatë vitit 2023, janë rekrutuar dhe kanë filluar punën 45 oficerë korrektuese gra, po ashtu janë në proces të rekrutimit edhe 70 oficerë korrektues të cilët janë duke vijuar procesin në Akademinë për Siguri Publike. Me rritjen e numrit të stafit korrektues, Shërbimi Korrektues ka ngritur cilësinë e shërbimit në institucionet korrektuese duke pasur parasysh që rekrutimi i stafit të ri tani e ka ulur moshën mesatare të stafit korrektues.

QKRMT ka evidentuar se për pesë vjet oficerët korrektues nuk ishin të furnizuar me uniforma të kompletuara. Procesi i furnizimit me uniforma ka filluar në disa qendra në fund të viti 2023. Po ashtu, në ambientet e punës së oficerëve korrektues mungonte inventari i kompletuar për punë të përditshme, në disa raste edhe kompjuterët ishin jashtë funksionit.

Sa i përket punëtorëve social, ende nuk janë përmbushur të gjitha pozitat e nevojshme me punëtor social në raport me kërkesat sipas numrit të burgosurve.

### 5.2. Marrëveshja me Danimarkën për dhënien me qira të Qendrës së Paraburgimit në Gjilan

Traktati i nënshkruar me datë 24.04.2022 në mes të Republikës së Kosovës dhe Mbretërisë së Danimarkës nuk ka filluar të zbatohet, për shkak se ende nuk është Ratifikuar nga Kuvendi i Kosovës. Kushtetuta e Republikës së Kosovës parasheh që çdo Marrëveshje ndërkombëtare duhet të ratifikohet në Kuvend me 2/3 e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit të Kosovës.

Kjo Marrëveshje disa herë ka qenë në rend të ditës në Kuvendin e Kosovës për Ratifikim, mirëpo në mungesë të kuorumit (2/3 e deputetëve) ka dështuar të votohet. Mos pjesëmarrje e deputetëve të opozitës në seancën e votimit për këtë Marrëveshje ka qenë për arsye politike, pra për shkak të mos pajtimeve me partinë qeverisëse, e jo për shkak se është kundërshtuar përmbajtja e Marrëveshjes.

Kjo Marrëveshje ka pasur kundërshtime në nivel ndërkombëtar duke u konsideruar se mund të përbëj shkelje të të drejtave të njeriut.

Raporti i Komitetit të OKB-së kundër Torturës i publikuar me datë 8 dhjetor 2023<sup>2</sup>, shton se: *“Komiteti është i shqetësuar për planet e përmendura nga shteti për të burgosur jashtë territorit të tij qytetarë të vendeve të treta që kanë kryer krime para deportimit të tyre. Në mënyrë të veçantë, Komiteti merr parasysh qëllimin e deklaruar të shtetit palë për të dhënë me qira një burg në Kosovë dhe është i shqetësuar për pasojat që kjo mund të ketë në aksesin e të burgosurve në kujdesin shëndetësor dhe vizitat familjare. Komiteti është gjithashtu i shqetësuar që edhe pse shteti ka deklaruar se burgu do të jetë subjekt i juridiksionit danez, pyetje mbeten në lidhje me autoritetin disiplinor dhe juridiksionin penal për akte torturimi apo keqtrajtimi që mund të kryhen nga stafi i burgut, aksesin e mekanizmave të monitorimit dhe kompetencat hetimore në rastet e tilla. Komiteti është gjithashtu i shqetësuar për natyrën potencialisht diskriminuese të regjimit të propozuar, i cili sipas pretendimeve përfshin dallimin në trajtimin e të arrestuarve në bazë të nacionalitetit dhe statusit familjar (në pikat 2, 3, 5, 11–13 dhe 16)”*.

Shqetësime të ngjashme rreth të drejtave të njeriut i ka paraqitur edhe QKRMT në analizën dhe hulumtimin e publikuar në Mars 2022: *“Marrëveshja në mes të Kosovës dhe Danimarkës për transferimin e të burgosurve në Kosovës – Implikimet në Standardet e të Drejtave të Njeriut”*.

### 5.3. Puna e Panelit për Lirim me Kusht

QKRMT ka vazhduar të pranojë ankesa përmes të burgosurve kundrejt punës së Panelit për Lirimi me Kusht, përkundër që ShKK dhe institucionet korrektuese kanë raportuar për një bashkëpunim shumë të mirë me Panelin për Lirim me Kusht gjatë vitit 2023. Në QK Smrekonicë kanë raportuar se 90% e të burgosurve që i kanë plotësuar kushtet, janë liruar nga Paneli për Lirim me Kusht.

Ekipi monitorues ka pranuar ankesa nga të burgosurit, kryesisht në QK Dubravë dhe BSL, e po ashtu edhe nga qendrat e paraburgimit, se refuzimi nga Paneli bëhet pa ndonjë arsye të veçantë përveç arsytimit shabllon që është për çdo të burgosur. Disa të burgosur kanë raportuar që përkundër sjelljeve të mira gjatë qëndrimit në burg, ndjekjes së të gjitha programeve të ofruara, pa shkelje disiplinore, përsëri u refuzohet kërkesa për lirim me kusht. Të burgosurit kanë bërë krahasime me disa të burgosur të tjerë që sipas tyre, lirohen edhe ata që kanë pasur probleme gjatë vuajtjes së dënimit, ndërsa refuzohen ata që kanë sjellje të mira. Sipas tyre, ka raste që janë liruar nga PLK edhe të burgosur me mbetje prej 7 vjet të dënimit.

<sup>2</sup> Komiteti ka konsideruar raportin periodik të tetë të Danimarkës në takimet e tij të 2050-të dhe 2053-të, të mbajtura më 8 dhe 9 nëntor 2023, dhe ka përshtatur observimet përfundimtare aktuale në takimin e tij të 2067-të, mbajtur më 22 nëntor 2023

QKRMT ka analizuar të dhënat e publikuara nga Paneli për Lirim me Kusht, ku ka evidentuar që në rastet e refuzimit arsyetimi është shabllon / thuajse i njëjtë për të gjithë: *“Pesha e krimit është një tregues i nevojës për të mbrojtur shoqërinë përmes parandalimit të kryerjes së veprave tilla apo të ngjashme penale”*. Po ashtu, janë evidentuar disa raste se të dënuarit e refuzuar në përshkrimin e Aktvendimit nuk kishin asnjë vërejtje për sjelljet gjatë qëndrimit në burg, mirëpo prapë refuzoheshin. Sipas raportimeve të burgosurve, janë liruar të burgosur për vepra të rënda siç janë për dhunime e janë refuzuar ata për vepra shumë më të lehta (p.sh. për vjedhje). Nga evidencat e PLK-së, QKRMT ka analizuar disa raste të dhunimit dhe sulmit seksual, të cilat kryesisht ishin liruar nga paneli.

Sa i përket arsyetimit të përgjithshëm se *“Pesha e krimit është një tregues i nevojës për të mbrojtur shoqërinë përmes parandalimit të kryerjes së veprave tilla apo të ngjashme penale”* QKRMT rekomandon Panelin për Lirim me Kusht që të rishikohet ky arsyetim i përgjithshëm sepse ligji në përgjithësi nuk kufizon lirimin me kusht vetëm sipas veprave penale.

#### 5.4 Monitorimi i seancave gjyqësore

QKRMT ka vazhduar monitorimin e seancave gjyqësore, për të paraburgosurit, kryesisht raste të evidentuara gjatë vizitave monitoruese. Të paraburgosurit kanë kërkuar që të monitorohen këto seanca, sidomos në rastet me paraburgime të gjata, apo edhe rastet në rigjykime për disa herë. QKRMT ka monitoruar disa raste të tilla, të cilat për vite të tëra përballen me procesin gjyqësor. Të burgosurit që janë në proces të rigjykimit nuk mund të trajtohen si të dënuar, gjë që i kufizon në realizimin e të drejtave të parapara për të dënuarit.

Monitorimi i seancave gjyqësore realizohet në bazë të Marrëveshjes mes Këshillin Gjyqësor të Kosovës (KGJK) për monitorimin e seancave gjyqësore.

#### 5.5. Avokimi dhe ndihma ligjore e QKRMT-së

Me qëllim të mbrojtjes dhe avancimit të të drejtave të personave të privuar nga liria, QKRMT ka ndërmarr aktivitete avokuese, si për rastet individuale, njashtu edhe për ndryshimin e politikave në nivele institucionale.

Rastet e shkeljeve individuale të evidentuara gjatë vizitave monitoruese apo pas raportimit përmes kanaleve të tjera, janë adresuar tek organet kompetente, dhe është kërkuar trajtimi i duhur i këtyre rasteve.

QKRMT ka vazhduar komunikimet me autoritetet gjyqësore çdo herë kur ka pasur ankesa dhe shqetësime nga të burgosurit. Komunikim të vazhdueshëm avokues QKRMT ka pasur edhe me institucionet korrektuese dhe DShB. Sa i përket avokimit publik, QKRMT ka adresuar shkresa publike tek institucionet përkatëse, të pasuara me komunikata për media.

***Në fund të vitit 2023, QKRMT së bashku me pesë organizata të tjera joqeveritare janë përzgjedhur nga Agjencia për Ndhimë Juridike Falas, si organizata për të ofruar ndihmë juridike falas.***

**RAPORTET E  
VEÇANTA NGA  
MONITORIMI I  
INSTITUCIONEVE  
KORREKTUESE –  
2023**

(Raportet monitoruese për secilin institucion)

---



# 1. QENDRA KORREKTUESE NË DUBRAVË

Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës (QKRMT), me datë 14 qershor, 16 gusht 2023 dhe 14 dhjetor 2023 ka realizuar vizita të rregullta monitoruese në Qendrën Korrektuese në Dubravë.

Gjatë vizitës së fundit në këtë qendër gjendeshin 678 të burgosur, nga të cilët 10 të paraburgosur, ndërsa 1 prej tyre gjendej në trajtim mjekësor jashtë institucionit (në IPFK). QK Dubravë, vazhdon me trendin pozitiv sa i përket vendosjes dhe trajtimit të të burgosurve, duke akomoduar të paraburgosur vetëm për arsye shëndetësore, përkatësisht në Pavionet ku trajtohen të burgosurit me probleme shëndetësore (të vendosur në Pavionin e Spitalit dhe Pavionin 7).

Ekipi monitorues gjithashtu vërejt se në QK Dubravë ka të akomoduar edhe të dënuar me dënime më të gjata se 15 vite, të cilët janë vendosur në këtë institucion për arsye shkollimi dhe shëndetësore.

Sfiduese mbetet rritja e numrit të burgosurve përdorues të narkotikëve, të cilët shpeshherë janë problematikë dhe vështirë të menagjueshëm, sidomos në rastet kur ka mungesë të medikamenteve për trajtimin e tyre.

Projekti për furnizim me rreth 2000 pula, nga i cili pritet që të kenë furnizim me vezë ka filluar, ku QK Dubravë furnizon edhe qendrat tjera sipas nevojës. **QKRMT e mirëpret një projekt të tillë që i mundëson angazhim të të burgosurve në punë në këtë lëmi si dhe ndikon në uljen e shpenzimeve të ShKK-së për furnizim me ushqim.**

QK Dubravë vazhdon të përballet me rastet e kontrabandës, edhe pse muajt e fundit ka pasur rënie të numrit të rasteve. Lidhur me këtë dukuri janë organizuar bastisje rregullisht si ndaj të burgosurve ashtu edhe ndaj anëtarëve të stafit, ku tek ata të cilët janë gjetur kontrabandë janë inicuar procedurat ligjore dhe janë ndërmarr masat disiplinore. Në QK Dubravë bastisjet ishin të shpeshta. **Stafi i QKRMT-së u informua se gjatë bastisjeve nuk lejohet që të paktën njëri nga të burgosurit të qëndrojë në dhomë.**

QK Dubravë ashtu sikurse edhe qendrat tjera vazhdon ta ketë si një ndër sfidat më të mëdha menaxhimin e të burgosurve me probleme të shëndetit mendor. Kjo kategori e të burgosurve paraqet shqetësim si për stafin korrektues ashtu edhe për të burgosurit të tjerë. Ekipi i QKRMT-së gjatë vizitës së dt. 14.06.2023 ka vizituar Pavionin D, ku parashihej vendosja e disa të burgosurve me probleme të shëndetit mendor. Gjatë asaj vizite Pavijoni D ende nuk ishte funksionalizuar

ndërsa gjatë vizitës së datës 16.08.2023, u njoftuam se Pavijoni D kishte filluar punën dhe aty ishin akomoduar 14 të burgosur me probleme të shëndetit mendor, me çrregullime jo të rënda, për të cilët ka vendosur komisioni multidisciplinor.

QK Dubravë vazhdon të përballlet me mungesën e menaxhimit të qëndrueshëm të stafit. Pozita e drejtorit ushtrohet nga zëvendësues. Me qëllim të fuqizimit të menaxhimit të qëndrueshëm, *QKRMT përsërit rekomandimin për Ministrinë e Drejtësisë dhe ShKK-në që në pozita udhëheqëse të emërohen personat me mandat të plotë.*

QK Dubravë ka mungesë të stafit korrektues. Gjithsej janë 522 zyrtarë, prej të cilëve 457 staf të uniformuar dhe 65 staf civil. Përveç numrit jo të mjaftueshëm, një numër i stafit është i moshuar dhe një pjesë e tyre kanë probleme shëndetësore. Në QK Dubravë pritet që të angazhohen 20 persona staf i ri mirëpo gjatë vizitës së fundit u informuam që vetëm 4 zyrtarë të gjinisë femërore kishin filluar punën në QK Dubravë, të cilat janë transferuar nga qendrat tjera korrektuese.

QKRMT ka pranuar disa ankesa nga të burgosurit për sjellje jo të mirë nga stafi korrektues. Sipas disa të burgosurve sjelljet e stafit nuk kanë qenë korrekte dhe të njëjtit kanë shprehur ankesa edhe kundër shqiptimit të masës së vetmisë ndaj tyre.

Incidentet mes të burgosurve, duke përfshirë edhe përleshjet fizike mes vete mbeten prezent, megjithëse sipas udhëheqësve të qendrës, muajve të fundit janë në numër më të vogël dhe jo të natyrave të rënda.

Një nga të burgosurit e komunitetit jo-shumicë është ankuar se është ngacmuar vazhdimisht nga të burgosurit tjerë lidhur me etninë, pastaj sipas ti për shkak ngacmimit të vazhdueshëm nga të burgosurit e tjerë ka pirë mjete higjienike, dhe për këtë arsye gjendej nën vëzhgim.

*QKRMT rekomandon që rastet e ndjeshme të trajtohen me profesionalizëm nga stafi dhe të akomodohen përshtatshëm në mënyrë që të shmangen ngacmimet nga të burgosurit e tjerë.*

Ka pasur raste të vetëlëndimeve, ku si arsye më të shpeshta kanë qenë mungesa e medikamenteve të cilat mungojnë herë pas here. Gjatë vizitës monitoruese u njoftuam që në Pavionin 5 ka pasur një rast të tentim vetëvrasjes. QKRMT takoi të burgosur të cilët posedonin sasi të tabletave që i kanë ruajtur, të cilat mund të paraqesin rrezik nëse grumbullohen në sasi më të mëdha nga të burgosurit.



QK Dubravë përballet me fenomenin e akomodimit të të burgosurve me probleme mendore dhe përdoruesve të substancave narkotike. Për shkak të mungesës së ambienteve adekuate për vendosjen e këtyre kategorive, këto grupe janë të vendosur thuajse në të gjitha pavionet e QK Dubravë. Mungesa e shërbimeve profesionale dhe e ambienteve adekuate, paraqet problem në menaxhimin e kësaj kategorie. Pavioni D përkundër faktit që ka filluar me akomodim të të burgosurve, deri më tani aty janë vendosur të burgosur me probleme jo të rënda mendore. Përveç programit të metadonit, për të burgosurit me vartësi nga substancat narkotike, QK Dubravë nuk ofron mundësi tjera për trajtimin e tyre.

Nga disa të burgosur u paraqitën ankesa për vonesa në përgjigje të kërkesave si dhe në raste të caktuara nuk marrin përgjigje fare. Në mesin e të intervistuarve pati të burgosur që u ankuan për punën e punëtorëve social dhe zyrtarëve ligjor, sipas tyre nuk po ua ofrojnë ndihmën e nevojshme për rastet kur po kanë nevojë. QK Dubravë ka numër të vogël të punëtorëve social dhe zyrtarëve ligjor, duke pasur parasysh numrin e të burgosurve që janë të vendosur në këtë qendër, andaj konsiderohet që duhet të shtohet numri i tyre, në mënyrë që të burgosurve t'ju ofrohen shërbime kualitative.

Po ashtu, mekanizmi aktual i ankesave nuk ofron mundësinë për paraqitjen e ankesës në mënyrë që të ruhet konfidencialiteti dhe të trajtohet në mënyrë objektive.

Ekipi monitorues i QKRMT-së ka evidentuar një rast që ka pohuar për sulm/ngacim seksual gjatë qëndrimit të tij Pavionin D. **Trajtimi i këtij rasti është bërë përmes një raporti të veçantë.**

Përkundër renovimeve të bëra, monitoruesit e QKRMT-së vërejtën se kushtet materiale në QK Dubravë ende janë në nivel jo të duhur ngase në disa dhoma në banjo nuk funksiononin mire baterit e ujit, kishte rrjedhje uji, lagështi në disa mure dhe dysheme të dëmtuar, gjithashtu pranuan ankesa për gjendjen e dyshekëve, me ç'rast në disa dhoma të vizituara edhe vet ekipi monitorues evidentoi se kishte dyshekë të dëmtuar të cilët kishin nevojë që të ndërroheshin. Pavioni 2 ende është jashtë funksionit, ndërsa punimet pritet të përfundojnë në muajin dhjetor 2023. Ky Pavion ka më shumë se 2 vite që është jashtë funksionit. Gjithashtu renovime janë bërë në Pav. 3 dhe Pav. 5, ku punët janë kryer nga vet të burgosurit, ndërsa kryesisht renovime janë bërë duke gëlqerosur muret, në nyjet hidrosanitare, në dysheme dhe janë ndërruar dyshekët sipas nevojës. Në Pavionin 5 përkundër renovimeve, kishin filluar defektet në sistemin hidrosanitar, ku në dhomat e vetmive kishte problem me ujin, po ashtu në njërin nga sallat e përbashkëta kishte rrjedhje uji. Për më tepër, në krahun e vetmive dhe atë regjimit (V1 dhe V2) nuk ka banjo të përbashkët, ku të burgosurit duhet të

pastrohen në banjot brenda dhomave të tyre, ku edhe kishte mungesë të ujit të ngrohtë. Në Pavionin 1, nëpër dhoma u vërejtën kushtet shumë të dobëta, të burgosurit nuk kishin gjërat elementare si jastëk dhe ishin të detyruar që nga dyshekët të merrnin një pjesë të sfungjerit dhe ta përdornin si jastëk, nuk kishte ujë mjaftueshëm të nxehtë. Në Pavionin 6, kishte ankesa të shumta sa i përket kushteve të akomodimit në këtë pavion. Banjot e përbashkëta në këtë pavion nuk ishin në nivelin e duhur. Në dhoma kishte probleme në disa banjo, ku nuk punonte uji në tualete, po ashtu mungonte ventilimi. Sallat e ushqimeve ishin të mbuluara nga myku, nuk punonte uji sepse kur lëshohej uji rridhte dhe këto salla nuk ishin në nivelet e duhura për të qëndruar në to.

Të burgosurit u ankuan për mungesën e ujit të nxehtë dhe stafi i QKRMT-së ishte dëshmitarë kur të burgosurit nxehnin ujin me metoda klasike në mënyrë që ta përdornin për tu pastruar. Ngrohja e ujit në këto mënyrë paraqet rrezik për vet të burgosurit. Të burgosurit e pavionit 6 u ankuan edhe për mungesë të produkteve higjienike për pastrim brenda pavionit.

Përveç kushteve për vendosjen e të burgosurve, QK Dubravë ballafaqohet edhe me mungesën e inventarit (tavolina, karrige) dhe pajisjeve bazike për punë për zyrtarët korrektues, edhe nga ato që kanë në dispozicion, një pjesë e tyre është vjetërsuar dhe dëmtuar. Po ashtu në Pavionin 5, kompjuteri i udhëheqësit të pavionit ishte jashtë funksionit. **QKRMT konsideron se mungesa e kushteve adekuate të punës ndikon drejtpërdrejtë në punën e stafit dhe menaxhimin të burgosurve.**

Në krahun V1 në këtë Pavion maksimumi i ditëve për të qëndruar është 28 ditë, por kishte raste që e kishin kaluar këtë periudhë dhe ende nuk ishin zhvendosur nga aty.

Stafi monitorues i QKRMT-së gjatë vizitës së fundit morri disa ankesa mbi ushqimin në kantinë. Gjatë vizitës, në Pavionin 6, të burgosurit treguan që ushqimet e tyre që i kanë marrë nga kantina po u vinë me insekte (buba). Ata ia dëshmuan stafit të QKRMT-së, duke hapur disa nga pakot e orizit, njëra ishte (800g) me afat deri më 13.10.2024, ndërsa tjetra (800g), e importuar nga jashtë, nuk i shënonte askund afati i përdorimit. Gjatë hapjes së tyre u pane insekte (buba), të cilat vetëm shkonin duke u shumuar. Kjo kishte shkaktuar shqetësim shumë të madh tek të burgosurit dhe nuk ndiheshin të sigurtë të konsumonin ushqimin e blerë nga kantina. Sipas tyre, këto produkte vijnë që një kohë kështu mirëpo nuk është ndërmarrë asgjë.

***Ekipi monitorues i QKRMT-së menjëherë e ka raportuar këtë gjendje tek menaxhmenti i QK Dubravë dhe ka kërkuar që urgjentisht të ndërmerren masa për evitimin e këtij produkti dhe të informohen mekanizmat e prokurimit në mënyrë që ky lloj i produktit mos të jetë i qasshëm në kantinë pa u vlerësuar nga organet kompetente.***

Po ashtu në dhomat e të burgosurve kishte sasi të mëdha të ushqimeve të grumbulluara, sidomos konserva peshku (rreth 20 copë në një dhomë) të cilat janë mjaftë të rrezikshme të konsumohen pas qëndrimit në temperatura të nxehta.

Përderisa po zhvillohej vizita monitoruese, u njoftuam që një i burgosur në Pavionin 5 (J1) ishte identifikuar se është infektuar me scabies (zhgjebë). Sipas udhëheqësit të Pavionit i njëjti është veçuar, mirëpo QKRMT nuk mori informata për procedimin e mëtejshëm të rastit, p.sh. kontrollën e të burgosurve të tjerë të dhomës si dhe masat e tjera për parandalimin e përhapjes së infeksionit.

QK Dubravë, si institucion korrektues, ofron një numër të aktiviteteve për të dënuarit. Për të dënuarit ofrohen trajnime profesionale, shkolla si dhe mundësia për tu angazhuar në punë.

Në QK Dubravë ofrohet mundësia për shkollimin e mesëm. Përveç shkollimit, në dispozicion për të dënuarit janë edhe disa lloje të trajnimeve profesionale, përfshirë edhe trajnime për teknologji informative, si dhe programi për menaxhimin e zemërimit për të dënuarit në Pav. 8.

Lloji i punëve që janë në dispozicion për të dënuarit janë pastrimi, puna në kuzhinë, mirëmbajtja e oborrit, punët bujqësore, etj. Numri i të dënuarve të punësuar ndryshon varësisht nga sezoni. Mbetet kërkesë e vazhdueshme ofrimi i më shumë opsioneve për punë. Mundësi e mirë pritet të ofrohet për të dënuarit në Pavijonin Gjysmë të Hapur, ku pas përfundimit të Udhëzimit Administrativ, parashihet që t'iu mundësohet punësimi jashtë institucionit. QKRMT e vlerëson se kjo mundësi do të ndikojë në përgatitjen e të dënuarve që sa më lehtë të riintegrohen në shoqëri pas lirimit të tyre.

Të burgosurit e kanë edhe rutinën ditore, që përfshinë shëtitjet në ambient të hapur dhe aktivitetet sportive. Të burgosurit që janë të vendosur në Pavionin e pranimit (1) kanë shëtitje brenda ditës dy here nga 45 minuta.

Kohë pas kohe në QK Dubravë organizohet gara në sport mes të burgosurve, si aktivitete shtesë me qëllim të rehabilitimit të tyre. Ndërsa si risi tjetër është që pritet formimi i një grupi muzikor nga të burgosurit, nga i cili planifikohet të organizohen aktivitete kulturore dhe argëtuese në QK Dubravë.

Sa i përket kontaktit me jashtë, të burgosurit i realizojnë vizitat me familje, telefonatat, dhe SKYPE për ata të burgosur që kanë familjarët jashtë vendit, kurse të dënuarit me privilegje edhe mundësinë për vikende jashtë institucionit.

Ekipi monitorues nuk ka pasur qasje dhe nuk i ka monitoruar ambientet shëndetësore në QK Dubravë, për arsye të skadimit të afatit të marrëveshjes me Ministrinë e Shëndetësisë mirëpo nga intervistat e realizuara me të burgosurit është raportuar një numër i konsiderueshëm ankesash sa i përket shërbimeve mjekësore, si vonesa në caktimin e termineve, trajtim jo i duhur nga stafi shëndetësor, kontrole mjekësore jo adekuate, mos furnizim me medikamente për një periudhë kohore gjë që ka sjell shqetësime serioze tek të burgosurit, ku disa nga ta në trajtim mjekësor për narkotik, treguan se e kanë pasur shumë të vështirë ballafaqimin gjatë asaj kohe, si dhe vonesa në terapitë e përshkruara nga mjeku me orar të caktuar. Po ashtu ka pasur ankesa të shumta edhe për mos trajtim nga stomatologu.

Gjatë vizitës në muajin dhjetor, stafi monitorues i QKRMT-së ishte dëshmitar i një të burgosuri i cili u ankua se kishte kohë që i janë shfaqur disa puçrra nëpër trup. Mjeku vetëm i kishte dhënë një krem për ta lyer dhe asgjë më shumë, mirëpo vazhdonte me ankesa të njëjta. I burgosuri tregoi që ishte duke pasur shumë temperature, kruarje, dhimbje dhe djegie të shenjave mirëpo nuk ishte duke u trajtuar më shumë.

Shqetësuese mbetet mos realizimi i kontrollave të rregullta ditore ndaj personave që gjenden nën masës e vetmisë, ashtu siç parashihet me procedura. Sipas të burgosurve dhe disa anëtarëve të stafit, vetëm disa mjek janë të rregullt në vizita ditore, ndërsa shumë të tjerë i vizitojnë vetëm sipas nevojës.

*QKRMT rikujton se vizitat mjekësore ndaj të burgosurve me masën e vetmisë janë obligative që të zhvillohen çdo ditë.*

Gjatë vizitës në muajin Qershor në Pavionin 4, ekipi monitorues ishte dëshmitarë kur një i burgosur (me çrregullime mendore) vazhdimisht kërkonte që të vizitohet te psikiatri, mirëpo përgjigjia që i jepej ishte se është njoftuar mjeku dhe ka thënë që nuk është në rrallë për tu trajtuar. QKRMT, konsideron se kjo është neglizhencë e kërkesave për trajtim sipas nevojës së të burgosurve.

Po ashtu, në vizitën e muajit Gusht, i burgosuri që rezultoi me scabies ka arritur që në korridor ta ndaloj mjekun dhe ta pyet për shenjat në lëkurë, dhe pasi që mjeku e ka parë e ka ftuar për vizitë mjekësore në stacionar ku edhe ka rezultuar me scabies.

Ekipi monitorues takoi një të burgosur që kishte hyrë në grevë urie dhe ishte vendosur në krahun e vetmive. Sipas tij nuk kishte realizuar vizitë mjekësore para se të vendosej në krahun e vetmive.

## 2. BURGU I SIGURISË SË LARTË

Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës (QKRMT), me datë 14 tetor 2023 ka realizuar një vizitë të rregullt monitoruese në Burgun e Sigurisë së Lartë (BSL).

Në ditën e monitorimit prezent në BSL ishin gjithsej 197 të burgosur, nga të cilët 53 me statusin e të paraburgosurve. BSL në aspektin e kushteve materiale ka kapacitete për akomodimin e një numri edhe më të madh të të burgosurve, mirëpo jo edhe sa i përket stafit. Duke përfshirë edhe zyrtarët civil, BSL aktualisht ka 173 anëtarë të stafit. Me gjithë rekrutimin e fundit, për të përmbushur numrin e nevojshëm të stafit, nevojitet të pranohet numër më i madh i zyrtarëve.

BSL si institucion i sigurisë së lartë, ka të dënuar dhe të paraburgosur të cilët janë të kategorizuar me rrezikshmëri të lartë apo edhe me rrezikshmëri shumë të lartë. Siguria në BSL vazhdon të jetë në nivel të menaxhueshëm. Gjithashtu edhe aspekti i parandalimit të dukurive si kontrabanda vlerësohet si i suksesshëm. Ka raste shumë të rralla kur tentohet kontrabandimi. Gjatë vitit 2023 nuk kanë pasur raste të tentim kontrabandës.

Nga vrojtimit dhe bisedat e zhvilluara me të burgosurit dhe stafin, QKRMT vlerëson se në përgjithësi ekziston një klimë e mirë ndërmjet të burgosurve dhe zyrtarëve korrektues. Sa i përket raportit ndërmjet të burgosurve, ka pasur disa incidente të izoluar.

Mbetet kërkesë e vazhdueshme që në listën e produkteve ushqimore të përfshihen edhe ushqime me vlera më të mira ushqyese.

Të burgosur me çrregullime mendore janë të vendosur edhe në BSL. Përkundër deklaratimit se nuk janë raste të rënda dhe janë të menaxhueshëm, QKRMT vazhdon të avokojë se vendosja e personave me çrregullime mendore në këto institucione është joadekuate, si dhe vazhdon të paraqesë njërën nga sfidat më të mëdha për Shërbimin Korrektues të Kosovës. Përveç vështirësive dhe rrezikut që paraqesin kjo kategori e të burgosurve për zyrtarët korrektues, gjithashtu janë duke shkaktuar pakënaqësi dhe shqetësime të ndryshme edhe tek të burgosurit tjerë. Në BSL ishin të vendosur rreth 30 raste me terapi psikiatrike.

Për dallim nga vizitat e kaluara ku në BSL kanë qenë të vendosur edhe të burgosur të dënuar për veprën penale të terrorizmit, kjo kategori e të dënuarve ishte transferuar në QK Dubravë.

Sipas disa të burgosurve, në disa raste ka favorizime nga menaxhmenti dhe stafi i BSL, në kuptimin e trajtimit dhe realizimit të të drejtave, praktika të tilla përmendën në rastet e angazhimit në punë dhe realizimit të beneficioneve.

Ekipi monitorues ka vizituar edhe të paraburgosurit dhe të dënuarit e komunitetit serb, të cilët janë të vendosur në krah të veçantë. Gjatë bisedës me ta, nuk pati ndonjë ankesë sa i përket trajtimit apo diskriminimit. Ankesat e tyre kanë të bëjnë kryesisht me proceset gjyqësore. Po ashtu, kanë qasje në bibliotekë por sipas tyre është e mangët në tituj. Njëri nga të burgosurit e ka furnizuar bibliotekën me disa tituj në gjuhën serbe.

Sa i përket formës së kërkesave dhe shkresave, ato janë në dy gjuhët (shqip dhe serbisht), mirëpo sipas të burgosurve, përgjigjet kthehen në gjuhën shqipe.

Nga të dënuarit pati ankesa për punën e Panelit për Lirim me Kusht, sipas tyre edhe pse kanë sjellje korrekte, janë shfrytëzues të beneficioneve po vazhdojnë të refuzohen kërkesat nga PLK.

BSL vazhdon të ofrojë një nivel kryesisht të kënaqshëm të kushteve materiale për vendosjen e të burgosurve, edhe pse vazhdimisht ballafaqohet me nevojën për renovime të vazhdueshme, sidomos në dysheme për shkak të kualitetit të dobët të punimeve. Të burgosurit janë të vendosur në dhoma njëshe. Ky është viti i dytë që Pavioni 2 nuk është plotësisht funksional për shkak të pritjes për renovim. Gjatë vizitës monitoruese, kati i dytë i këtij Pavioni ishte jashtë funksionit.

***QKRMt përsëritë rekomandimin për ShKK-në që sa më parë të furnizoj BSL-në me material përkatës, në mënyrë që të vazhdon renovimi i ndërprerë në katin e dytë të Pavionit 2.***

Nga një pjesë e të burgosurve të intervistuar ekipi monitorues pranoi ankesa lidhur me gjendjen e fushës sportive, ku sipas tyre është dëmtuar dhe nuk po mund të zhvillojnë aktivitetet sportive si duhet, madje sipas tyre ka raste kur të burgosurit janë lënduar për shkak të këtyre dëmtimeve në fushë.

Gjatë vizitës së krahut A1 në Pavionin 1 ekipi monitorues vërejti lagështi dhe dëmtime në tavanin dhe pllakat e banjove, përkundër faktit që sipas zyrtarit të krahut, të njëjtat ishin renovuar kohëve të fundit.

Të paraburgosurit e njoftuan ekipin monitorues se gjatë verës iu ka mundur hapja e derve të jashtme për shkak temperaturave të larta, dhe kërkuan që edhe në vazhdim herë pas herë gjatë ditës të ju hapen dyert për ajrosje më të mirë.

Ankesa pati edhe në BSL për mos funksionimin e pakos për thirrje jashtë vendit, ashtu që po detyrohen që të komunikojnë përmes SKYPE dhe si rezultat po iu humbet mundësia e realizimit të vizitës nga familjarët tjerë brenda vendit, sepse sipas të burgosurve të intervistuar, komunikimi me SKYPE iu llogaritet si zëvendësim i vizitës familjare.

Të burgosurit në BSL realizojnë shëtitjet, sportin (futboll gjatë shëtitjes) dhe sallën e fitnesit, shah dhe pingpong për të dënuarit me regjim të avancuar si dhe mundësinë për angazhim në punë.

Të dënuarve u mundësohet të punojnë në punëtoritë për prodhimin e letrës së tualetit, qeseve, produkteve të drurit, renovimet e ambienteve të institucionit, pastrim kuzhinë, etj. Punimet për prodhimin e letër tualetit si dhe punimet e dyshemeve me epoksid shpeshherë janë ndërprerë shkaku i mungesës së lëndës së parë për arsye financiare. Punimet e drurit kryheshin në Punëtorinë 1, ndërsa në Punëtorinë 2 kryheshin punët për prodhimin e qeseve. Një pjesë e Punëtorisë 2 është e adaptuar si hapësirë për fitnes, ku është e pajisur me pajisje për ushtrime, të cilat i shfrytëzojnë të dënuarit.

Të burgosurit që i plotësojnë kushtet ligjore, mund t'i shfrytëzojnë vizitat e lira, ku në këtë institucion janë 3 dhoma të veçanta për realizimin e vizitave të lira. Në përgjithësi, të burgosurit shprehin ankesa për mungesë të aktiviteteve në këtë institucion.

Në BSL ka një pako televizive që përfshinë më shumë se 20 kanale, duke përfshirë edhe 3 kanale televizive në gjuhën serbe.

Për të paraburgosurit, edhe për shkak të kufizimeve ligjore për këtë kategori, në dispozicionin e tyre është një numër më i kufizuar i aktiviteteve. Vazhdon të jetë kërkesë e tyre shtimi i aktiviteteve.

QKRMT vazhdon të avokoj tek Ministria e Drejtësisë dhe ShKK për nevojën për reforma dhe avancim të Njësisë Ekonomike. Në këtë drejtim kërkohet ndërmarrja e veprimeve adekuate, për përmirësimin e kushteve të punës për të dënuarit, përfshirë ngritjen e pagesës si dhe pagimin e kontributeve.

*4 të burgosur të BSL-së janë të që nga viti 2019 janë angazhuar për shtrimin e epoksidit në të gjitha institucionet korrektuese, ku ka pasur nevojë. Kjo është një punë mjaftë profesionale, ku me gatishmërinë e tyre të burgosurit i kanë shërbyer Shërbimit Korrektues për shtrimin e epoksidit në disa institucione korrektuese, duke përfshirë: BSL, QK Dubravë, QK Lipjan, QP Mitrovicë.*

Gjatë vizitës monitoruese 12 persona ishin të angazhuar në kuzhinë, 4 prej të cilëve zyrtar kurse pjesa tjetër të dënuar që punojnë. Furnizimi me produkte ishte i mirë, duke përfshirë pemët dhe perimet. Ambienti i kuzhinës ishte i mirëmbajtur dhe pajisjet funksionale përveç një frigoriferi që ishte prishur së fundmi. Mostrat e ushqimit ishin të ruajtura. Librezat sanitare gjatë vizitës nuk ishin prezent dhe sipas kryekuzhinierit librezat i ka dorëzuar para rreth 2 javësh për vazhdim të afatit të vlefshmërisë, mirëpo nuk i kanë pranuar ende. Rezervat e ushqimit ruhen mirë dhe nuk u evidentuan ushqime pa afat të qëndrueshmërisë.

Në BSL vazhdon të ketë të burgosur të cilët janë me regjim ushqimi, si rrjedhojë nga stafi i kuzhinës u tha se është mjaft sfiduese kjo, megjithatë janë duke u munduar që brenda kapaciteteve ti zbatojnë rekomandimet e mjekëve.

Me hyrjen në fuqi të Rendit të ri shtëpiak, të dënuarve iu lejohet edhe nga një pako ushqimore çdo tre muaj, mirëpo sipas legjislacionit në fuqi, ushqimi i sjellur nga familja duhet të konsumohet gjatë vizitës, përkatësisht në sallën e vizitave. Ky modalitet ka shfaq shumë sfida në realizimin e kësaj të drejtë pasi që është mjaftë vështirë e menaxhueshme që 3 kg ushqim të konsumohen gjatë vizitës familjare.

Nga bisedat me të burgosurit, u paraqiten ankesa në shërbimet shëndetësore që ju ofrohen. Kishte ankesa se terapitë nuk ju sigurohen me rregull, vizitat jashtë institucionit ju vonoheshin si dhe pati ankesa se stafi shëndetësor i neglizhon kërkesat e tyre dhe nuk trajtohen si duhet.



### 3. QENDRA KORREKTUESE NË SMREKONICË

Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës (QKRMT), me datë 9 nëntor 2023 ka realizuar një vizitë të rregullt monitoruese në Qendrën Korrektuese të Smrekonicës.

QK Smrekonicë, si institucion i tipit të hapur, ka kapacitet të akomodojë 200 të dënuar. Gjatë vizitës monitoruese, 104 të dënuar gjendeshin në këtë qendër. Edhe pse sipas Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, QK Smrekonicë është institucion korrektues i tipit të hapur, ende vazhdon të udhëhiqet nga rregullat dhe rendi shtëpiak i njëjtë me të institucioneve tjera korrektuese.

**QKRMT përsërit rekomandimin për Ministrinë e Drejtësisë dhe SHKK-në që të marrin veprimet e nevojshme për nxjerrjen e udhëzimeve adekuate dhe të rendit shtëpiak që i përshtatet regjimit të hapur të këtij institucioni.**

Nga vizita monitoruese, QKRMT vlerëson se në përgjithësi ekziston një klimë e mirë në QK Smrekonicë në aspektin e trajtimit, raporteve mes të dënuarve dhe raporteve mes të dënuarve dhe stafit të qendrës. Megjithatë ekipi monitorues hasi në disa të burgosur të cilët u ankuan ndaj disa zyrtarëve korrektues për sjellje jo të mira (ankesat e të burgosurve lidhur me këtë çështje, janë paraqitur tek kapitulli i Trajtimi).

Edhe gjatë kësaj vizite ekipi monitorues u njoftua se në QK Smrekonicë ka një koordinim më të mirë me Panelin për Lirim me Kusht (PLK). Përveç që kanë lirime më shumë, edhe dorëzimi i vendimeve është i rregullt nga ana e PLK-së. PLK ka filluar që në vendimet e tyre të paraqes edhe këshillën juridike që të dënuarve u lejohet ankesa në Gjykatën Supreme ndaj vendimeve të PLK-së. Të dënuarit paraqesin ankesa privatisht, duke i angazhuar avokat, pasi që LESP-i nuk parasheh mundësi që institucioni të asistojë në këtë aspekt. Koha e pritjes së vendimeve nga PLK është shkurtuar, ndërsa rreth 90% e të dënuarve përfitojnë nga lirimi me kusht. Së fundmi kishte të burgosur që janë liruar me kusht duke pasur mbetje të dënimeve për disa vite, ku një nga rastet e fundit ishte liruar me kusht me 7 vite mbetje dënimi. Lidhur me këtë rast kishte disa ankesa nga të burgosurit e tjerë që janë refuzuar nga PLK, sipas të cilëve paneli nuk po i trajton drejtë të gjitha kërkesat.

Në QK Smrekonicë numri i të burgosurve të cilët punojnë jashtë institucionit është në rritje e sipër, 33 të burgosur janë me punë jashtë institucionit përkatësisht 1/3 e të gjithë të burgosurve punojnë jashtë institucionit, sipas orarit nga ora

6:30 deri në 17:30. Marrëveshja e paraparë me KEK-un nuk është implementuar ende, arsyet nuk dihen, ngase kjo çështje është në kompetencën e SHKKK-së me Ministrin e Drejtësisë.

**QK RMT e vlerëson shumë pozitivisht mundësinë që ju ofrohet të dënuarve në QK Smrekonicë që të angazhohen me punë jashtë institucionit, duke ndikuar drejtpërdrejt në risocializimin dhe riintegrimin e tyre në shoqëri. Numri i atyre që i kanë shkelur rregullat për punë jashtë institucionit korrektues është jashtëzakonisht i ulët, andaj kjo është një mundësi e mirë për risocializimin e të dënuarve.**

Ankesat më të mëdha të të dënuarve ndërlidhen me punën e Panelit për Lirim me Kusht, kushtet materiale të vendosjes, nevojën për më shumë aktivitete dhe mundësi për punësim, si dhe mungesën e një mjeku kujdestarë dhe të infermierëve në vazhdimësi.

Në QK Smrekonicë gjatë vitit 2023, nuk ka pasur raste të kontrabandës. Ndërsa sa i përket incidenteve, ekipi monitorues u njoftua se ka pasur, por ka qenë një numër i vogël dhe jo të natyrës së rëndë. Për këto incidente dy nga të burgosurve u është shqiptuar masa e vetmisë dhe tjerat masa më të lehta, kryesisht qortime. Gjithsej janë shqiptuar 9 masa disiplinore për vitin 2023 (deri në ditën e vizitës monitoruese).

Bazuar në kriteret për vendosjen e të dënuarve në këtë qendër, secili që ka mbajtur gjysmën e dënimit në institucionet e tjera korrektuese dhe ka vlerësime pozitive, mund të transferohet në QK Smrekonicë. Përveç këtij kriteri, sipas një vendimi të Drejtorisë së Përgjithshme të SHKK-së, edhe personat me dënime më të ulëta se gjashtë muaj, mund të dërgohen drejtpërdrejt në këtë qendër. Këta të dënuar nuk kalojnë përmes Njesisë për Vlerësim në QP Prishtinë, por dërgohen direkt në QK Smrekonicë, kryesisht nga ana e Policisë. Sipas vlerësimit të QK RMT-së, por edhe të vet stafit të QK Smrekonicë, kjo praktikë është jo e mirë, pasi që persona të cilët nuk kanë asnjë vlerësim paraprak dërgohen direkt në QK Smrekonicë. Në shumë raste, përdorues të substancave narkotike vendosen direkt nga liria në QK Smrekonicë.

**QK RMT vlerëson se kriteret për vendosjen e të dënuarve në QK Smrekonicë duhet të jenë më specifike dhe t'i mundësojnë shumicës së të dënuarve me sjellje të mira të përfitojnë nga ky regjim në funksion të qëllimit të dënimit – rehabilitimit dhe re integrimin të të dënuarve.**

**QKRMT rekomandon që sa më parë të ndryshohet praktika e dërgimit në vuajtje të dënimit në QK Smrekonicë e personave direkt nga liria, pa një vlerësim paraprak.**

QK Smrekonicë përballet me mungesë të stafit. Për këtë arsye disa nga zyrtarët duhet ti mbulojnë pozitat tjera, çka paraqet ngarkesë shtesë për ta. Janë vetëm dy oficerë korrektuese femra. Së fundmi në këtë institucion ishin angazhuar edhe 6 oficerë të ri, prej të cilëve 4 janë femra ndërsa 2 janë transferuar nga qendrat tjera. Numri total i stafit ishte 57 nga të cilët 37 me uniformë, ndërsa moshë mesatare e stafit është mbi 55 vjeç.

Stafi korrektues i angazhuar në QK Smrekonicë, sikurse edhe në institucionet tjera, përballet me kushte jo të mirat të punës. Ka mungesë furnizimi me uniforma prej shumë vitesh. Këpucët është dashur ti sigurojnë vet.

Sikurse në qendrat tjera edhe në QK Smrekonicë, ekipi monitorues evidentoi se aparatet për fikjen e zjarrit nuk janë servisuar për një kohë prej më tepër se 2 vite, data e fundit e servisimit në aparatet e zjarrit në QK Smrekonicë ishte 03.09.2021, andaj konsiderojmë se kjo çështje duhet trajtuar më me seriozitet nga Shërbimi Korrektues ngase ndërlidhet drejtpërdrejtë me sigurinë e institucionit.

Në përgjithësi vërehej një klimë e mirë brenda institucionit, meqenëse pranuar ankesa nga disa të burgosur për sjellje jo të mira nga ana e disa oficerëve, të cilët sipas tyre i provokojnë me fjalë të ndryshme dhe i kërcënojnë me largim nga QK Smrekonicë për në QK Dubravë nëse të njëjtit nuk janë të dëgjueshëm ndaj stafit.

QK Smrekonicë e ka edhe Pavionin e Pranimit, me kapacitet prej 16 vendeve, në të cilin duhet të vendosen fillimisht të gjithë të dënuarit kur pranohen në këtë qendër. Qëndrimi në këtë Pavion zgjatë deri në 28 ditë. Janë dy dhoma me nga 8 shtretër. Gjatë vizitës monitoruese, Pavioni i Pranimit kishte 7 persona, të vendosur në dy dhoma. Sipas të burgosurve ka raste kur ky pavion mbushet me kapacitet të plotë.

Në Pavionin e Pranimit ishte vendosur kutia e ankesës. Një veprim të tillë e mirëpret QKRMT, pasi që ishte rekomandim i vitit paraprak. Disa të dënuar u shprehën se nuk janë njoftuar me mirë me rendin shtëpiak, p.sh. sa i përket rutinës së pastrimit. Ankesa pati për kushte të këqija materiale.

Në QK Smrekonicë vazhdon të ketë rastet që për shkak të shkeljeve disiplinore transferohen në institucione tjera korrektuese, e më së shpeshti në Qendrën Korrektuese në Dubravë. I'u shqiptohet masa disiplinore, e në të njëjtën kohë edhe transferimi në qendrat tjera.

QKRMT përsërit vlerësimin se shqiptimi i masës disiplinore, si dhe largimi nga QK Smrekonicë për shkak të shkeljeve disiplinore, paraqet masë disiplinore të dyfishtë. Vet fakti i largimit nga QK Smrekonicë, është një veprim që ndikon negativisht te të dënuarit. Transferimi/largimi nga një institucion, në një institucion tjetër nuk parashihet si masë disiplinore me LESP. Kjo praktikë nuk është e rregulluar me dispozita ligjore, andaj edhe rekomandohet që QK Smrekonicë të ketë kujdes në mënyrë sesi vepron me personat të cilët bëjnë shkelje disiplinore.

Për dallim nga institucionet tjera korrektuese, QK Smrekonicë nuk ka të dënuar që kanë probleme mendore. QKRMT e vlerëson pozitivisht këtë aspekt, pasi që as kjo qendër nuk ka kushte infrastrukturore e as njerëzore për trajtimin adekuat të të dënuarve me probleme mendore.

Gjithashtu çështja e dhënies së terapisë mjekësore nga stafi korrektues, sidomos gjatë ndërrimit të natës, në mungesë të infermiereve, vazhdon të jetë prezente në QK Smrekonicë. QKRMT përsëri e sjellë në vëmendje këtë çështje e cila duhet të adresohet, pasi që kjo praktikë është e papranueshme. Oficerët korrektuese nuk janë kompetent e as nuk e kanë përgatitjen profesionale për administrimin e terapisë mjekësore.

Një ndër aspektet më të rëndësishme për vlerësimin e trajtimit të të dënuarve është edhe aspekti i kushteve materiale për banim për të dënuarit. QK Smrekonicë nuk është në nivel të kënaqshëm. Ka një oborr dhe hapësirë të madhe dhe shumë të mirë për kalimin e kohës jashtë qelive, mirëpo kushtet e banimit nëpër Pavione janë nën nivelin e kërkuar. Disa nga dhomat ku janë të vendosur të dënuarit i kanë nga 6 e 8 krevate.

Gjatë vitit 2023, janë bërë disa renovimeve të cilat QK Smrekonicë i ka kryer duke i angazhuar të dënuarit, kryesisht në pjesët e jashtme të pavioneve si gëlqerosje dhe izolimi, duke përfshirë edhe rregullimin e kulmit të pavionit. QK Smrekonicë ka nevojë për renovim të plotë të hapësirave të banimit për të dënuarit. Muret e hapësirave të dhomave, korridoreve dhe të banjove janë të dëmtuara nga lagështia dhe duhet të renovohen.

Dhomat në Pavionin e Pranimit janë të dëmtuar nga lagështia dhe myku. Banjot e dy dhomave duhet të renovohen për shkak të dëmtimeve. Gjithashtu batanijet e të dënuarve në këtë Pavionin ishin të papastërta, TV nuk punonin, banjot e dhomave pa ventilim, lagështi në muret e koridorit dhe në muret e banjos për pastrim, gjithashtu në banjot për pastrim tushat ishin të dëmtuar, vetëm njëri prej tyre funksiononte dhe uji i ngrohët vinte me mjaftë vonesë.

QKRMT rekomandon që në Pavionin e Pranimit të bëhen intervenime më përmbajtësore për përmirësimin e kushteve materiale.

Të dënuarit u shprehën të pakënaqur me sasinë dhe cilësinë e produkteve higjienike. Në mënyrë që ti mbajnë hapësirat në nivel të kënaqshëm, kërkuan që institucioni ti furnizojë më shpesh me produkte higjienike.

Dy dhomat e Pavionit të Pranimit me nga 8 shtretër, nuk plotësojnë kërkesat minimale për hapësirën e nevojshme për vendosjen e të dënuarve. Sipas LESP-it, në qeli të përbashkëta, secili person duhet të ketë së paku 4 metra katror hapësirë. Dhomat në Pavionin e Pranimit i kanë më pak se 20 metra katror secila. ***QKRMT vazhdimisht ka theksuar faktin se në institucionet korrektuese nuk ka mbipopullim, mirëpo, vendosja e nga 8 personave në dhoma që kanë më pak se 20 metra katror, është në kundërshtim me kriteret ligjore që parasheh LESP-i, por edhe me standardet ndërkombëtare nga fusha e mbrojtjes së të drejtave të njeriut.***

Të dënuarit në QK Smrekonicë janë të hapur dhe mund të lëvizin brenda objekteve dhe në oborr gjatë shumicës së kohës. Nga kjo mundësi, përjashtim bëjnë të dënuarit e vendosur në Pavionin e Pranimit, të cilët përveç shëtitjeve dhe kohës së ngrënies, pjesën tjetër e kalojnë të mbyllur.

Në dispozicion për të dënuarit janë telefonatat, vizitat familjare, vikendet jashtë institucionit, sallat rekreative, disa trajnime dhe mundësia për angazhim në punë. **Megjithatë, QKRMT përsërit rekomandimin se QK Smrekonicë, si institucion korrektues i tipit të hapur, duhet të ketë më shumë aktivitete për të dënuarit, sidomos mundësi dhe lloje më të shumta për angazhim në punë edhe brenda institucionit. Kjo është kërkesë edhe e vet të dënuarve.**

Puna jashtë institucioni është e rregulluar me Udhëzimin Administrativ MD-Nr.04/2023, i cili i rregullon kushtet dhe procedurat e veçanta për dhënien e lejes për të dënuarit që të punojnë jashtë institucionit korrektuese. Të dënuarit e interesuar për punë jashtë institucionit, duhet fillimisht të paraqesin kërkesë

te Paneli i QK Smrekonicë, i cili bënë vlerësimin e kërkesave të tyre dhe jep propozime për ose kundër lejimit për punë jashtë institucionit. Drejtori i QK Smrekonicë vendosë më pas për dhënien e lejes ose jo. Ndër kriteret kryesore është edhe sigurimi i kontratës nga një biznes i regjistruar.

Sipas këtij Udhëzimi Administrativ, të dënuarve nuk u lejonet të punojnë jashtë institucionit në bizneset e tyre apo të familjarëve. Kishte ankesa nga të dënuarit se ka raste që disa të dënuarve iu lejonet të punojnë në bizneset e regjistruara në emrin e familjarëve, kurse të tjerëve jo.

Të dënuarit e punësuar jashtë institucionit monitorohen nga një ekip i QK Smrekonicë, të cilët janë në kontakt me punëdhënësin, për tu siguruar që të dënuarit e përmbushin obligimin e tyre.

***QK RMT e konsideron si storie suksesi procesin e angazhimit të të dënuarve në punë jashtë institucionit, ku 1/3 e të dënuarve në këtë qendër vazhdojnë punën jashtë institucionit duke i'u përmbajtur rregullave dhe Udhëzimit Administrativ për këtë qëllim.***

Sa i përket beneficioneve shtesë që u ofrohen të dënuarve me Ligjin e ri për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, është filluar me zbatimin e ditëve/vikendeve shtesë. Gjithashtu ka filluar edhe lejimi i pakove ushqimore sipas rendit të ri shtëpiak, vetëm në sallën e vizitave, për çka të dënuarit shprehën pakënaqësi ngase sasia e lejuar është e pamundshme që të konsumohet gjatë kohës së vizitës dhe nuk po ndjehen rehat në prani të familjarëve.

Të dënuarit përveç telefonave kanë në dispozicion edhe Skype, i cili u lejonet me raste të veçanta, kur nuk kanë vizita.

QK Smrekonicë ofron disa mundësi trajnimesh për të dënuarit, siç janë automekanik, saldim, floktari, etj.

Objekti për aktivitete të lira/rekreative – QK Smrekonicë gjithashtu të burgosurve i'u ofron edhe mundësinë për angazhim me aktivitete të lira/rekreative si: sallën e fitnesit, sallën për aktivitete fetare, sallat e trajnimeve si dhe biblioteka.

Të dënuarit e vendosur në Pavionin e pranimit e kalojnë shumicën e kohës brenda. Përveç shëtitjeve dhe kohës së ngrënies, kohën tjetër e kalojnë të mbyllur në dhomat e tyre. Ky tretman vlen si për personat që vijnë nga liria ashtu edhe për ata që vijnë nga institucionet tjera korrektuese. **Edhe pse është Pavion i**

**pranimit, me faktin se është në QK Smrekonicë, institucion i tipit të hapur, QKRMT konsideron se është më se e nevojshme që këta të dënuar të kenë kohë më të gjatë jashtë dhomave të tyre dhe gjithashtu tu ofrohen aktivitete më shumë në dispozicion përveç shëtitjes.**

Ekipi i QKRMT gjatë monitorimit ka vizituar hapësirat e kuzhinës duke përfshirë edhe depon ushqimore. Gjatë vizitës ekipi u prit nga kryekuzhinieri, i cili njoftoi lidhur me gjendjen aktuale në kuzhinë. Meqenëse kuzhina në QK Smrekonicë është renovuar rishtazi pajisjet ishin funksionale dhe hapësirat ishin mjaft të gjëra për punë dhe të mirëmbajtura.

Aktualisht në kuzhinë janë të angazhuar gjithsej 9 të burgosur me punë të ndryshme dhe 3 staf. Mostrat e ushqimit mbaheshin me rregull, sikurse edhe librezat sanitare.

## 4. QENDRA KORRKETUESE PËR FEMRA NË LIPJAN

Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës (QKRMT), me datë 22 shkurt 2023, 05 korrik 2023, dhe 23 nëntor 2023 ka realizuar vizita monitoruese në Qendrën Korrektuese për Femra në Lipjan (QKFL).

QKFL akomodon të paraburgosura si dhe të dënuara me dënime të ndryshme dhe të gjata. Në vizitën e datës 5 korrik 2023 ishte një e mitur me masë edukative në të njëjtin vend me të dënuarat madhore. Të burgosurat janë të vendosura në katër paviojne të ndryshme: pavioni B për të paraburgosurat dhe ato me regjim themelor, pavioni D për të dënuarat me regjim standard, si dhe pavioni A dhe C me të dënuarat me privilegje. Të dënuara në momentin e kësaj vizite monitoruese ishin 17, kurse të paraburgosura ishin 6, në mesin e të cilave edhe me çrregullime të shëndetit mendor dhe përdoruese të drogave.

Bazuar në monitorimin sistematik ndër vite në këtë institucion, ky është numri më i ulët i të burgosurve femra që ekipi monitorues ka evidentuar, pra gjithsej 23 femra të privuara nga liria.

Një ndër çështjet më shqetësuese të observuara nga ekipi monitorues por gjithashtu problem i ngritur nga vetë stafi korrektues vazhdon ende të jetë mbajtja në QKFL e të burgosurve me çrregullime të shëndetit mendor. Personat me çrregullime të shëndetit mendor, për shkak të pamundësisë për t'u mbajtur në një institucion të mbyllur që do të ofronte kushte konform nevojave të tyre, me përkujdesje psikiatrike të rregullt, akomodohen në QKFL bashkë me të paraburgosurat/dënuarat e tjera gjë që shkakton pakënaqësi në mesin e të paraburgosurve/dënuarave për shkak të prishjes së qetësisë dhe rregullit në pavijone, dhe me raste mund të jenë burim i konflikteve mes tyre. Stafit korrektues iu mungon përgatitja profesionale për t'u kujdesur për raste të tilla, ngaqë nuk janë të trajnuar për t'u përballur me raste psikiatrike, e po ashtu ky institucion përballlet me numër të pamjaftueshëm të stafit korrektues në përgjithësi. Në anën tjetër Instituti i Psikiatrisë Forenzike të Kosovës (IPFK) është i dedikuar për të bërë vlerësimin dhe ekspertizën psikiatrike dhe trajtimin detyrueshëm psikiatrik, mirëpo ky institucion ka numër të vogël shtretërisht për t'iu përgjigjur nevojave reale që ekzistojnë.

Ekipi monitorues ka vërtetuar që në momentin e vizitës në QKFL ishin të vendosura një numër i konsiderueshëm i të burgosurve me çrregullime të shëndetit mendor.



***QKFL nuk ofron kushte adekuate për trajtimin e kësaj kategorie, as nga aspekti i burimeve njerëzore profesionale sa i përket stafit shëndetësor dhe korrektues, por as nga kushtet materiale ekzistuese.***

Ka pasur një rast tentim-vetëvarje, por me intervenimin e menjëhershëm të stafit është arritur që të parandalohet vetëvrasja.

Një bastisje e përgjithshme është bërë ku nuk është gjetur asgjë. Por sipas pohimeve brenda QKFL, ka raste kur qarkullojnë mjetet e ndaluara / kontrabanduara, duke përfshirë telefonat celular.

Nga observimet e bëra, QKRMT vlerëson se në QKFL ka mosmarrëveshje herë pas here mes të paraburgosurave/dënuarave mes vete ndërsa me stafin korrektues në përgjithësi raporti është i mirë.

Po ashtu kishte një numër të të burgosurve që janë apo kanë qenë përdoruese të substancave narkotike, ndaj të cilave kishte ankesa nga të burgosurat e tjera për sjelljet e tyre. Duke përfshirë edhe ankesat për vjedhje të gjëseneve nëpër dhomat e tyre, sidomos në dhomat ku të burgosurat janë në punë. Nga to u kërkua që gjatë kohës sa janë duke punuar, stafi ti mbyllë dhomat e tyre në mënyrë që mos të kenë qasje personat e tjerë.

**Bazuar në këto ankesa, QKRMT rekomandoi që gjatë kohës kur të burgosurat të jenë në punë dhomat e tyre të jenë të mbyllura dhe të sigurt nga hyrjet e personave të tjerë.**

Sa i përket ekzekutimit të masës së vetmisë dhe qëndrimit në regjim themelor, pati ankesa se të gjitha të burgosurat nuk trajtohet njësoj, pra ka dallime në trajtim nga ana e stafit.

Infrastruktura e ndërtesës së QKF-së nga vizita e fundit nuk ka pasur ndonjë përmirësim. QKFL është e vendosur në objekt të vjetër. Të gjithë janë të pakënaqur duke përfshirë stafin korrektues dhe të paraburgosurat/dënuarat me kushtet e institucionit.

**Në këtë institucion përkundër vizitës së fundit të rregullt ku mungonte dhoma për vizita të lira, në këtë vizitë kjo dhomë ishte rregulluar/improvizuar brenda ambienteve të qendrës korrektuese, duke iu mundësuar realizimi i të drejtës së shfrytëzimit të vizitave të lira siç është paraparë me LESP. QKRMT me vite e ka adresuar pamundësinë e realizimit të kësaj të drejtë, prandaj mirëpret këtë zhvillim në QKFL.**

Të paraburgosurat dhe të dënuarat ishin të vendosura kryesisht nga një në dhomë. Pastërtia mbahej nga vetë të paraburgosurat/dënuarat dhe ishte në nivel të mirë. Ekipi monitorues ka observuar që banjot ku pastrohen të paraburgosurat/dënuarat në pavijonin B ishin në gjendje të pakënaqshme. Edhe pse kishte ujë të nxehtë vetëm dy nga gjashtë dushet punonin. Në këtë vizitë monitoruese është vërejtur që kishte TV në gati çdo dhomë, megjithatë numri i kanaleve në gjuhën shqipe ishte i vogël, 3-4 kanale, andaj edhe pati pakënaqësi nga të burgosurat, sidomos ato në paraburgim.

Po ashtu, sikurse edhe në çdo vizitë tjetër, u evidentua se në pavionin C kishte rrjedhje uji në korridor dhe në banjo nga të reshurat.

Ekipi monitorues i QKRMT-së u njoftua nga menaxhmenti se është paraparë një shumë prej 60,000 euro për renovimin e objektit të veçantë për qëndrim të nënave me fëmijë. Ndërtimi i këtij objekti ka filluar në fund të vitit 2023. Gjatë vitit 2023 ka qenë një rast kur është nevojitur shtëpia e nënave dhe sipas vizitës së QKRMT-ës kushtet nuk kanë qenë adekuate për një nënë dhe një fëmijë që jetonin aty. Stafit dhe drejtoria janë detyruar që nënë me fëmijën e saj të e dërgojnë në qendrën për të mitur ku ishte i vendosur objekti i veçant.

Sipas QKRMT-së objekti se ku janë të vendosura të paraburgosurat dhe të dënuarat nuk i plotëson kushtet adekuate të infrastrukturës. Objekti, është mjaft izolues, andaj mirëpret zbatimin e rekomandimit për ndërtimin e një objekti të ri, i cili është planifikuar me buxhetin për vitin 2024.

Në QKFL, në Pavijonin B, ishin 3 dhoma në vëzhgim të kamerave që momentalisht ishin pa ndonjë të paraburgosur/dënuar dhe ishte një dhomë e vetmisë e cila po ashtu ishte pa ndonjë të burgosur.

Në QKFL, në Pavijonet B-C-D janë të vendosura nga tri kutia (ankesa, kërkesa dhe kutia e ankesës për Avokatin e Popullit). Në Pavijonin A ishin gjithashtu tri kutia.

Të paraburgosurat/dënuarat u ankuan për mungesën e aktiviteteve të ndryshme dhe një salle fitnesi. Ato gjatë 24 orëve kanë dy herë shëtitje nga një orë. Në shëtitore është ndërtuar një strehimore që në rastet e kushteve klimatike ekstreme të e përdorin gjatë kohës së shëtitjes.

Të dënuarat të cilat dëshirojnë të punojnë janë të angazhuara me punë brenda QKFL-së, në kuzhinë, pastrim, serra ose në furrë. Përveç të dënuarave, me lejen e gjykatës punojnë edhe të disa të paraburgosura për shkak se nevojiten më shumë të burgosurave për punë.

Furra e QKFL-së furnizon edhe dy qendra tjera korrektuese:, Qendrën Korrektuese për të Mitur dhe QEK-un.

Aktivitet e tjera janë shumë të mangëta. Dhoma e rrobaqepësisë e cila ishte duke u përdorur deri në vizitën e kaluar nuk ishte duke u përdorur më sepse instrukturja kishte dalë në pension.

**QKRMT rekomandon që sa më shpejtë të bëhet zgjidhja për angazhimin e një instruktore për rrobaqepësi.**

Po ashtu, 5 nga të dënuarat në QKFL kanë përfunduar programin për bizhuteri me filigram dhe as ky program nuk ishte duke u vazhduar si mungesë e materialit dhe planifikimeve për zhvillimin e këtij aktiviteti, ndërsa 7 nga të dënuarat vazhdojnë të mbajnë kurs për teknologji informative. Është duke u planifikuar të mbahet edhe aktiviteti “Bisedë për ndryshim” që do ketë për qëllim pjesëmarrjen e të paraburgosurave/dënuarave që ishin përdoruese të drogave. Në vijim ishte planifikuar të fillojë edhe trajnimi për dhunë në familje ku do marrin pjesë 7 të burgosura.

Në këtë qendër është shëtitörja për realizimin e aktiviteteve sportive por në kushte shumë të nxehta ose shumë të ftohta ato aktivitete nuk është e mundur të realizohen, andaj krijimi i ndonjë salle për realizimin e këtyre aktiviteteve do ishte shumë i nevojshëm.

**Infrastruktura e kësaj qendre pamundëson organizimin dhe realizimin e aktiviteteve të ndryshme, përderisa ka kërkesa të vazhdueshme nga të dënuarat që të kenë mundësi të realizimit të këtyre aktiviteteve.**

Përkundër objektit të vjetër, hapësira e kuzhinës ishte e mirëmbajtur. Gjatë monitorimit është evidentuar që përveç një nga frizat e mëdhenj që nuk punonte dhe nga katër pllakat dy nuk nxehnin gjatë vizitës së fundit, në këtë vizitë nuk punonte as makina për larjen e enëve dhe enët duhej të laheshin me dorë.

**Në kuzhinë shqetësuese ishte mungesa e librezave sanitare, ato mungonin për rreth dy muaj. Sipas stafit ato janë vazhduar nga institucionet kompetente mirëpo stafi nuk i kishte marrë ende.**

Gjendja e depos ishte në gjendje jo të mirë. Hyrja e depos ishte mykur dhe shumë lehtë mund të hynin brejtësit.

Pati ankesa sa i përket ushqimit se një kohë ka pasur mungesë të furnizimit me pemë dhe perime.

Nga bisedat me të dënuarat/paraburgosurat u evidentua se ka pakënaqësi më stafin mjekësor, pasi që jo çdo here i trajtojnë kërkesat e tyre. Në shumicën e rasteve atyre ju duhet vetë të blejnë terapitë sepse mungon furnizimi me barna.

## 5. QENDRA KORREKTUESE PËR TË MITUR NË LIPJAN

Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës (QKRMT), me datë 25 maj 2023, 21 shtator 2023 dhe 07 dhjetor 2023 ka realizuar vizita monitoruese në Qendrën Korrektuese për të Mitur në Lipjan (QKM).

Gjatë vizitës së fundit monitoruese, në QKM ishin të vendosur gjithsej 35 të mitur. Dy Pavionet e vetme funksionale ishin Pavioni A, në të cilin janë vendosur të miturit me masë edukative, si dhe Pavioni D në të cilin janë të vendosur të miturit e dënuar dhe të paraburgosur. Sipas menaxhmentit të QKM, Pavioni B vazhdon të jetë në renovim.

QKRMT u njoftua se gjatë këtij viti është zbuluar një rast i kontrabandës (futje e lëndës narkotike) nga një i mitur, ndërsa kanë zbuluar edhe një rast tjetër kur njëri nga trajnerët ishte futur me telefon në hapësirat ku nuk lejohet. Gjatë vizitës monitoruese të dt. 21/09/2023, tre të mitur gjendeshin në veçim, si masë disiplinore ndaj tyre.

Në QKM edhe gjatë vitit 2023 vazhdon të mos ketë të vendosur madhor të dënuar, gjë që është për tu vlerësuar dhe dëshmon punën e QK për të Mitur në përputhje me misionin dhe qëllimin e saj, si dhe me parimet për vendosjen adekuate të të burgosurve.

Në vizitën e fundit QKRMT u njoftua se në QKM aktualisht ka të vendosur një të mitur me probleme të lehta mendore ndërsa 3 ishin gjatë vizitës së dt. 21/09/2023, kurse është vetëm një numër i vogël përdorues të narkotikëve. QKM nuk ofron kushte adekuate për trajtimin e personave me probleme mendore e as atyre përdorues të substancave narkotike, andaj menaxhimi me raste të tilla është mjaft i vështirë, megjithëse gjendja aktuale konsiderohej e menaxhueshme.

QKM gjithashtu ofron disa programe rehabilituese dhe risocializuese të cilat të miturit mund ti ndjekin, si: Programi “Bëhu burrë”, programi TOPS, Programi “Biseda për ndryshim” si dhe Programi për pasojat e përdorimit të drogave. Të gjitha programet udhëhiqen nga instruktorët lokal.

Ekipi i QKRMT-së u njoftua se në QKM janë duke u bërë disa renovime përveç atyre në pavionin B, ku renovimet janë duke u bërë tek dritaret, muret, dyshemeja, në banjo si dhe në ndriçim. Në QKM janë vendosur 2 kaldaja të reja, andaj gjatë këtij vitet pritet që të mos ketë probleme me ngrohjen sikurse kishte vitin e

kaluar. QKM sikurse shumica e institucioneve tjera korrektuese, vazhdon të ballafaqohet me mungesë stafi si dhe me ndërrime të menaxhmentit. Si mungesë evidente është numri i pamjaftueshëm i punëtorëve social në raport me numrin e të miturve, ku aktualisht në këtë qendër punon vetëm një punëtor social. Po ashtu, nuk ka asnjë edukatorë, përkundër që parashihet me Kodin e Drejtësisë për të mitur që të ketë të angazhuar edhe edukatorë.

QK për të Mitur dhe QEK në Lipjan janë dy qendra të ndryshme të cilat menaxhohen nga i njëjti menaxhment. Nëse merren parasysh nevojat e të miturve në QEK janë krejtësisht të ndryshme me ato të atyre në QKM dhe rrjedhimisht mund të konkludohet që **QEK duhet të ketë një menaxhment të veçantë bazuar në natyrën e qendrës dhe nevojat specifike të të miturve.**

Monitoruesit e QKRMT-së kanë vizituar ambientet e banimit të të miturve si dhe hapësirat e tjera ku të miturit e kalojnë kohën e lirë. Pas vërtetimeve dhe bisedave me të miturit, QKRMT pranoi ankesa nga disa të mitur sa i përket trajtimit të tyre nga ana e stafit korrektues.

***Këto raste janë trajtuar në një pjesë të veçantë të këtij raporti.***

Sipas të dhëna zyrtare nga QKM-së, gjatë periudhës janar-gusht 2023 janë evidentuar 29 shkelje disiplinore, nga të cilat janë shqiptuar 21 masa “ndarje nga të miturit e tjerë”, 13 masa “qortime”, 2 masa “ndalimi i sportit”, dhe 2 masa “vërejtje me gojë”.

Ekipi i QKRMT-së gjithashtu pranoi nga shumica e të miturve pakënaqësi rreth ushqimit. Sipas tyre ju servohet ushqimi i ftohtë. QK për të Mitur nuk ka kuzhinë të veten. Ushqimi përgatitet dhe sjellët nga Qendra Korrektuese për Femra, e cila është me distancë të afërt. Edhe pse distanca mes institucioneve nuk është e largët, kjo paraqet sfida për shkak se ushqimi mund të ftohet deri sa të vijë tek të miturit. Në rast se të miturit kërkojnë ushqim shtesë kjo vështirë se mund tu realizohet pasi që ushqimi dërgohet në porcione të caktuara.

Në disa nga dhomat, dritaret janë të dëmtuara dhe nuk mbyllen mirë. Në dhomat e Pavioni A, dritaret janë të metalit, e shumë nga to nuk ofrojnë mbrojtje të duhur nga i ftohti. Gjithashtu në disa banjo të dhomave vërehej formim i lagështisë. Ekipi monitorues vërejtë gjithashtu se në disa shtretër dyshekët ishin në gjendje të dobët dhe jo të përshtatshëm për fjetje. Në Pavionin D të QKM-së, në disa raste të miturit e paraburgosur nuk kishin jastëk.

Nga bisedat me të miturit sikurse më herët edhe kësaj radhe u paraqit kërkesa për t'ju ofruar më shumë produkte higjienike dhe pajisje tjera për mirëmbajtje të higjienës.

QK për të Mitur ofron disa lloje aktivitete për të miturit, përfshirë mundësinë për shkollim, trajnime për hidro, elektro, floktarit, rrobaqepësi, aktivitete sportive, kulturore, etj.

Të miturit realizojnë vizita të rregullta familjare, shfrytëzimi i vikendeve iu mundësohet, bisedat telefonike sipas rendit shtëpiak dhe në pamundësi të vizitave familjare iu mundësohet kontakti me familjarët përmes Skype.

Në QKM procesi arsimor ka filluar në Shtator 2023 nën udhëheqjen e DKA Lipjan, ndërsa numri i nxënësve ishte 21 dhe pritej të rritet në vazhdim deri sa të rregullohet leje kalimi për disa të mitur. Dy të mitur janë duke vijuar studimet, njëri i dënuar ndërsa tjetri me masë edukative.

Risi gjatë vitit 2023 paraqet fillimi i mësimi special për të miturit që nuk kanë vijuar shkollimin nga klasa 1 deri 5. Gjatë vizitës monitoruese të 21.09.2023, për nxësit që ndjekin mësim special nuk kishte libra, mirëpo sipas stafit ishte pilot projekt dhe pritet të rregullohet ndërkohe edhe kjo çështje. Për sigurimin e librave problemi ishte edhe për arsye të subvencionimit të teksteve mësimore nga Ministria e Arsimit, gjë që paraqiste vështirësi për këtë kategori.

***QKRMT e ka mirëpritur organizimin e mësimi special për të miturit që nuk dinë shkrim dhe lexim, ku edhe ka qenë rekomandim i vazhdueshëm që të organizohet mësim special ashtu siç parashihet me Kodin e Drejtësisë për të Mitur.***

Gjithashtu rreth 30 të mitur janë të angazhuar në aftësim profesional në gjithsej 5 lëmi si: instalues i ujit, ndërtimtari, IT, kuzhinieri dhe elektro.

Sipas menagjmentit numri i të miturve në QKM që janë të angazhuar në punë është 30, të cilët punojnë kryesisht në kuzhinë, pastrim dhe në kopsht.

Të miturit kanë TV të cilët duhet si sigurojnë vet, por vazhdojnë të ankohen se kanë pak programe televizive në dispozicion. Marrë parasysh se tashmë nuk ka as gazeta/revista, mënyra e vetme për tu informuar të miturit mbetet përmes programeve televizive, andaj ***QKRMT rekomandon që të ndërmerren veprime konkrete që të miturve tu ofrohet qasje në më shumë programe.*** Për më tepër shqetësuese mbetet mungesa e programe për të miturit në paraburgim, të cilët përveç 2 shëtitjeve gjatë ditës, 22 orë të tjera i kalojnë të mbyllur brenda dhomës, ku disa nuk kishin as televizor në dhomë.

## 6. QENDRA EDUKATIVE KORREKTUESE PËR TË MITUR NË LIPJAN

Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës (QKRMT), me datë 25 maj 2023, 21 shtator 2023 dhe 07 dhjetor 2023 ka realizuar vizita të rregullta monitoruese në Qendrën Edukative Korrektuese për të Mitur në Lipjan (QEK).

QEK është institucion i veçantë për ekzekutimin e masës edukative për të miturit dhe ende funksionon nën menaxhimin e Qendrës Korrektuese për të Mitur (QKM). Kapaciteti i QEK është 36 vende, kurse në ditën e vizitës me dt. 21.09.2023 gjendeshin 12 të mitur, ndërsa gjatë vizitës së dt. 07.12.2023 gjendeshin vetëm 9 të mitur, përderisa 16 të mitur me Masë Edukative gjendeshin në QKM. Bazuar në kriteret e përcaktuara për vendosje në këtë institucion, paneli multi-disiplinar jep rekomandim drejtorit se cilët të miturit i plotësojnë kriteret për tu vendosur në QEK. Për të miturit të cilët nuk i përmbahen rendit shtëpiak dhe bëjnë shkelje disiplinore, ekziston mundësia për kthimin e tyre nga QEK për në QK për të Mitur. Në mesin e shkeljeve për të cilat të miturit mund të largohen nga QEK janë tentimi dhe arratisja nga QEK, kontrabanda, apo shkaktimi i ndonjë incidenti më të rëndë. QEK e ka një Pavion të ndarë për të miturat femra, mirëpo ky pavion asnjëherë nuk është banuar me të mitura.

Hapësirat e QEK janë miqësore ndaj të miturve dhe nuk e japin ndjesinë e një burgu. Megjithatë Ekipi i QKRMT-së, për dallim nga vizitat e mëhershme, gjatë këtyre vizitave vërejtë se stafi korrektues kishin të veshur uniformën e SHKK-së.

**QKRMT konsideron se një hap i tillë nuk është i duhur dhe paraqet regres në aspektin e ofrimit të një ambienti sa më miqësor dhe rehabilitues për të miturit dhe si i tillë nuk i kontribuon qëllimit të QEK. QKRMT rikujton që edhe gjatë hapjes së qendrës sikurse edhe në webfaqen e SHKK-së<sup>1</sup>, theks i veçantë i është dhënë pikërisht kësaj pjese, ku stafi janë me rroba civile dhe ka paraqitur një arritje pozitive sa i përket trajtimit të të miturve në këtë institucion dhe në qendër ka pasur interesin më të mirë të të miturit, duke pasur parasysh që nuk ka të angazhuar edukator, ashtu siç parashihet me ligj.**

1 Pjesë nga webfaqja e SHKK-së rreth QEK: ...”Është për t’u theksuar se në QEKL-ë me një vendim të Zyrës Qendrore SHKK-së i gjithë stafi është duke punuar me rroba civile (përfshihen edhe zyrtar korrektues, përveçse kur mbështetemi nga njësi tjera).”



Gjatë 2023 një të mituri i është gjetur lëndë narkotike në QEK dhe si pasojë është kthyer në QK për të Mitur. Gjithashtu kanë ndodhur 5 raste të largimit nga QEK, prej të cilave një i mitur nuk është kthyer nga vikendi ndërsa 4 të tjerë janë larguar nga qendra. Katër nga këto raste janë larguar nga qendra ndërsa njëri nuk është kthyer nga vikendi.

QEK ka gjithsej 23 anëtar të stafit. Aktualisht dy anëtar të stafit janë duke ndjekur trajnimin nga EULEX, për menaxhim rasti. Problematike mbetet mungesa e punëtorit social me ç'rast aktualisht zëvendësohet nga punëtori social i Qendrës Korrektuese për të Mitur, për të cilin kjo paraqet ngarkesë shumë të madhe dhe nuk jep mundësi tu ofrojë shërbimet e nevojshme dy qendrave.

QKRMT e vlerëson pozitivisht raportin e mirë mes të miturve dhe stafit të QEK, megjithëse veshja e uniformës nga ana e zyrtarëve korrektues, për disa të mitur ka ndikuar që ambienti në QEK të i'u ngjasoj më shumë me ambientin e një burgu. Të miturit paraqiten disa ankesa sa i përket ushqimit që ju servohet. Sipas tyre ushqimi shpesh është i ftohtë. QEK e merr ushqimin nga Qendra Korrektuese për Femra, pasi që nuk ka kuzhinë të veten.

QEK është një nga institucionet korrektuese të ndërtuar së voni, andaj edhe ofron kushte infrastrukturore të kënaqshme për të miturit. Gjithsesi, gjatë vizitës monitoruese është evidentuar se disa nga dyshekët për të miturit nuk janë mjaftueshëm të mirë, pasi që ishin deformuar. Gjithashtu në disa nga dhomat e vizituara kishte dëmtime të dorezave të derës së banjove, tavani i banjos në njërin dhomë ishte i dëmtuar, i mungonin pllakat, dëmtime këto të evidentuar edhe gjatë vizitës së kaluar, ndërsa vërehej që muret ishin gëlqerosur rishtazi.

Të miturit edhe gjatë kësaj vizite paraqitën kërkesë që tu ofrohen produkte higjienike më shumë, pasi që ato që ju ofrohen shpesh nuk ju mjaftojnë për mirëmbajtjen e higjienës së ambientit të banimit.

Sipas zyrtarëve përgjegjës në QEK, janë ndërruar dy pompa termike dhe janë në pritje edhe të disa investimeve tjera, gjë që parashihet që gjatë kësaj sezone dimërore të mos ketë probleme me ngrohjen e mjaftueshme, ashtu sikurse ka pasur në të kaluarën. QKRMT e vlerëson pozitivisht investimet në këtë aspekt, ngase e konsideron shumë të rëndësishme ofrimin e ngrohjes adekuate për të miturit gjatë sezonës së dimrit. Gjatë vizitës së dt. 07.12.2023, ekipi monitorues u njoftua se ngrohja është funksionale në pjesën më të madhe të objektit, duke përfshirë pjesën e banimit nga të miturit, gjithashtu edhe nga bisedat me të miturit, të njëjtit u shprehën se është mjaftueshëm ngrohët.

QEK ofron disa mundësi për të miturit sa i përket aktiviteteve që mund ti zhvillojnë brenda dhe jashtë institucionit.

Të miturit i realizojnë me rregull vizitat familjare, të cilat ju takojnë 1 herë gjatë javës. Gjithashtu ju lejohen bisedat telefonike. Sipas nevojës atyre u lejohen edhe më shpesh vizita familjare. Të miturit janë shfrytëzues të vikendeve. Ata janë të pajisur me TV dhe gjithashtu ju lejohen video-lojëra.

Shkollimi organizohet në Qendrën Korrektuese për të Mitur, së bashku me të miturit e kësaj qendre mësojnë në klasa të përbashkëta.

**Ankesa pranuar nga disa të mitur të cilët vijonin shkollimin se nuk po i'u lejohet që librat të i marrin me vete në dhoma por vetëm gjatë orëve mësimore në klasë, gjë që për ta paraqiste problem mësimi dhe përgatitja sa më e mirë për njësitë mësimore.**

Përveç shkollës, QEK ofron disa mundësi për të miturit për tu aftësuar. Punëtoritë për rrobaqepësi, floktari, kulinari, printim-dizajn, gjithashtu edhe kursi për IT, janë disa nga mundësitë në dispozicion për të miturit. Punëtoritë në QEK janë të rregulluara dhe ofrojnë kushte shumë të mira për ti zhvilluar aftësitë e të miturve. Në QEK të miturit e kanë në dispozicion edhe bibliotekën.

Aktualisht punëtoritë janë jashtë funksionit dhe si arsye kryesore mbete mungesa e materialit për punë (materiali për rrobaqepësi dhe për printim). Pritet që në bashkëpunim me UNICEF të sigurohet materiali dhe kjo çështje të rregullohet.

**QKRMT rekomandon që ShKK të gjejë mundësinë për furnizim të rregullt me material punues, në mënyrë që angazhimi i të miturve në punë të jetë i pandërprerë.**

Me të miturit, QEK vazhdimisht organizon aktivitete jashtë qendrës, të natyrave të ndryshme si vizita kulturore, turistike etj. Si aktivitet i radhës pritej të bëhet një vizitë në Shpellën e Gadimes. QKRMT i konsideron shumë të qëlluara këto aktivitete dhe mjaftë të nevojshme në procesin e rehabilitimit dhe risocializimit të të miturve.

## REKOMANDIM I PËRGJITHSHËM

***QKRMT përsërit rekomandimin ndaj Shërbimit Korrektues që të rishikojë procedurat e vendosjes së të miturve me masë edukative, në atë mënyrë që të gjithë të miturit me masë edukative të vendosen në Qendrën Edukative Korrektuese, meqë ky institucion është ndërtuar për këtë qëllim dhe ofron kushte shumë të mira për rehabilitimin e tyre. QEK ka kapacitet prej 36 shtretërve, ndërsa vetëm 12 të mitur me masë edukative janë të vendosur në këtë qendër, përderisa 16 të mitur me masë edukative janë të vendosur në Qendrën Korrektuese për të Mitur.***

***Po ashtu, QKRMT rekomandon ShKK-në që të rishikon Vendimin për uniformimin e stafit në QEK, dhe të kthehet Vendimi siç ka qenë, duke i mundësuar gjithë stafit në QEK që të punojnë në rroba civile.***

## 7. QENDRA E PARABURGIMIT NË PRISHTINË

Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës (QKRMT), me datë 8 qershor dhe 12 dhjetor 2023 ka realizuar vizita të rregullta monitoruese në Qendrën e Paraburgimit në Prishtinë.

Nga vërtetimet dhe bisedat e zhvilluara me të burgosurit dhe stafin, QKRMT vlerëson se në përgjithësi ekziston një klimë e mirë ndërmjet të burgosurve dhe zyrtarëve korrektues. Sa i përket raportit ndërmjet të burgosurve gjithashtu nuk u raportua se ka incidente në mes tyre.

Ankesat kryesore të të paraburgosurve ndërlidhen me sistemin prokurorial dhe gjyqësor. Përkundër faktit që kohëve të fundit vërehet zvogëlim i rasteve me paraburgime të gjata, megjithatë në këtë institucion u evidentuan disa raste që ishin në paraburgim më gjatë se 24 muaj.

Gjatë vitit 2023 ka pasur raste të kontrabandës në QP Prishtinë, e po ashtu edhe raste të parandalimit të kontrabandës.

QP Prishtinës pritet t'i shtohen oficerë të rinj korrektues, të cilët janë duke përfunduar trajnimin në Akademinë për Siguri Publike. Kjo është një lëvizje pozitive, pasi që edhe QP Prishtinë përballet me mungesën e stafit të mjaftueshëm. Në QP Prishtinë kanë qenë të angazhuar 132 anëtar stafi. Moshë mesatare e stafit është mbi 50 vjeçare.

Sa i përket Panelit për Lirim me Kusht, zyrtarët e QP Prishtinë deklaruan se kanë një bashkëpunim të mirë, sidomos sa i përket pjesës së koordinimit (dërgimit të vendimeve të PLK-së me kohë).

QP në Prishtinë akomodon të paraburgosur, por edhe të dënuar. Gjatë vizitës së fundit në QP Prishtinë ishin gjithsej 245 të burgosur, nga të cilët 63 të dënuar kurse të tjerët me statusin e të paraburgosurve. 6 nga të burgosurit ishin jashtë institucionit, prej të cilëve një në QKUK dhe 5 në IPFK. Në QP Prishtinë ndodhet Njësia e Vlerësimit për të pranuarit e ri. Gjithashtu, bëhet edhe pranimi i personave të cilët paraqiten vullnetarisht për ta vuajtur dënimin. Për këto arsye edhe ka shumë lëvizje të të burgosurve nga QP në Prishtinë, qoftë për shkak të pranimeve të reja, transportit nëpër gjykata dhe spitale, transfereve, etj.

Sikurse edhe institucionet tjera korrektuese, edhe QP Prishtinë vazhdon të përballet me mungesën e menaxhmentit të qëndrueshëm. Pozita e drejtorit

ushtrohet nga zëvendësues, ndërsa nuk kishte zv. drejtor. Zëvendësuesi i Drejtorit është transferuar nga QP Gjilan disa ditë vizitës monitoruese të datës 08.06.2023. Me qëllim të fuqizimit të menaxhimit të qëndrueshëm, QKRMT përsërit rekomandimin për Ministrinë e Drejtësisë dhe ShKK-në që në pozita udhëheqëse të caktohen personat me mandat të plotë. Përshkak të ndërrimeve të shpeshta të udhëheqësve (kryesisht çdo gjashtë muaj), shpeshherë ka vështëri në përcjelljen e rasteve nga monitoruesit.

Vendosja e të paraburgosurve me probleme mendore vazhdon të mbetet ndër sfidat kryesore në sistemin korrektues në Republikën e Kosovës. QKRMT ka vërejtur se kjo është më e shprehur në QP në Prishtinë për shkak të fluksit të lartë të të paraburgosurve dhe afërsisë me IPFK-në dhe Gjykatën Themelore në Prishtinë.

Megjithëse QP në Prishtinë është e destinuar si qendër e paraburgimit, akomodon edhe një numër të konsiderueshëm të të dënuarve, duke përfshirë edhe të dënuar me dënime të gjata. Ekipi monitorues gjatë vizitës ka takuar një të dënuar me dënim të gjatë prej 18 vjet, ku deri më tani i ka mbajtur 8 vjet, por i cili është i angazhuar në punë.

Numri i lartë i personave me probleme mendore vazhdon të jetë prezent edhe në QP Prishtinë. Kishte raste që personat të cilët me vendim të Gjykatës do të duhej të trajtoheshin në IPFK, mirëpo si rezultat i mungesës së hapësirave ata vendosën në QP Prishtinë. Në shumë raste Gjykata nxjerr vendim për caktim të paraburgimit, në të cilin urdhërohet QP Prishtinë që të paraburgosurit t'i dërgojë për ekzaminime në IPFK, por që të njëjtit mbahen në QP Prishtinë pasi që IPFK ua kthen me arsyetimin se nuk kanë vende të lira. Numri i kësaj kategorie të burgosurish ka shënuar rritje në krahasim me vitin e kaluar, ku vetëm gjatë vitit 2023 thotë se 240 raste me çrregullime mendore janë trajtuar në QP Prishtinë, andaj menaxhimi i tyre paraqet mjaft vështirësi për stafin sikurse edhe pakënaqësi tek të burgosurit e tjerë. Ditën e vizitës monitoruese, më 12 dhjetor 2023, 14 persona me çrregullime mendore ishin të vendosur në QP Prishtinë, të cilët kanë aktvendim nga gjykata për trajtim në IPFK, ndërsa 8 persona ishin me urdhëresë për ekzaminim.

Sipas stafit menaxhues, gjatë 2023 nuk është raportuar për ndonjë rast të përdorimit të forcës nga zyrtarët korrektues. Megjithatë ekipi monitorues gjatë vizitave tek të paraburgosurit pranoi informata se një rast i tillë ka ndodhur ndaj një të burgosurit. **Trajtimi i këtij rasti është zhvilluar në një pjesë të veçantë të këtij raporti.**

Gjatë 2023 nuk është raportuar për ndonjë incident të rëndë në mes të të burgosurve.

Lidhur me masat disiplinore, nga stafi i QP Prishtinë u tha se e drejta në ankesë ndaj vendimeve të Komisionit Disiplinor shfrytëzohet shumë rrallë, po ashtu edhe në rastet e tjera të drejtën në ankesë të burgosurit e aplikojnë shumë rrallë. QKRMT rekomandon QP Prishtinë që të ndërmerr veprime në drejtim të përmirësimit të perceptimit të të burgosurve mbi të drejtën e tyre në ankesë, përfshirë edhe ankesën ndaj masave disiplinore. Gjatë vizitës monitoruese, ekipi monitorues evidentoi se të dënuarit i sillnin ankesat direkt te zyra e mbikëqyrësit të lartë dhe se nuk kishte kopje kthyesë për të burgosurit, po ashtu ankesat ishin të hapura dhe në këtë rast të dhënat e të burgosurve rreth ankesës nuk ishin konfidenciale.

Ndërsa sa i përket kutisë së ankesave, ajo hapet një herë në javë, ku gjatë periudhës së parë të vitit 2023 janë pranuar vetëm 3 ankesa.

QP Prishtinë ka 3 dhoma të pajisur me kamerë, që përdoren për rastet e observimit. Sa i përket vendosjes së të burgosurve, shqetësuese mbetet dizajni i tualeteve nëpër dhomat e tyre. Në shumë prej dhomave tualetet janë krejtësisht të hapura, pa kurrfarë ndarje fizike, kurse në shumicën e dhomave janë të vendosur nga dy persona. Ushqimi ju shërbehet brenda dhomave. QKRMT konsideron se kjo gjendje duhet të përmirësohet, pasi që prek në mënyrë të drejtpërdrejtë dinjitetin e të burgosurve. Një trajtim i tillë mund të konsiderohet edhe si formë jo-humane dhe denigruese e trajtimit të të dënuarve. QP Prishtinë duhet të ndërmerr veprime për përmirësimin e këtyre kushteve.

QP Prishtinë ka kryer disa renovime gjatë vitit 2023, konkretisht ka bërë gëlqerosjen e disa hapësirave, ku edhe gjatë vizitës monitoruese vazhdonin të kryheshin punimet.

Ekipi monitorues gjithashtu vërejti se në dhomat e vizituara shumica e dyshekëve ishin të deformuar dhe shumica e krevateve nuk kishin shkallë për të lehtësuar ngjitjen në shtretërit e sipërm. Gjatë kësaj vizite janë evidentuar disa raste që ishin shtuar shkallët në shtretërit e sipërm, me çrast QKRMT rekomandon që të gjithë shtretërit të kenë shkallë për ngjitjen në shtratin e sipërm.

Gjithashtu në dhomat e vizituara kishte mungesë të karrigeve. Ekipi monitorues pranoi ankesa në lidhje me pastrimin e batanijeve dhe mbështjellëseve të dyshekëve, sipas tyre të njëjtat pastrohen shumë rrallë, deri me muaj të tërë.

Në njërën nga dhomat e vizituara, tavani i dhomës ishte i dëmtuar nga pikja e ujit dhe ishte formuar lagështi. Ekipi monitorues pranoi ankesa edhe lidhur me gjendjen e dusheve, ku sipas tyre baterit e dusheve janë shumica të dëmtuara dhe si alternative i kanë rregulluar me shishe plastike.

Lidhur me numrin e vogël të kanaleve televizive, ekipi i QKRMT-së pranoi ankesa nga të gjithë të burgosurit e intervistuar, ndërsa shqetësim më të madh paraqiten të paraburgosurit, ku sipas tyre janë të detyruar të qëndrojnë për 22 orë të mbyllur dhe shtimi i numrit të kanaleve do t'ua lehtësonte sado pak këtë gjendje. Dhomat e vetmisë gjenden në pavijonin B4, gjithsej janë 4 dhoma të vetmisë dhe janë jashtë përdorimit për shkak të kushteve jo të mira, pasi që mungon drita natyrale, ka lagështi, vendi i shëtitjes është jo adekuat dhe nuk i plotëson kushtet e përshtatshme në infrastrukturë. Këto dhoma nuk janë përdorur as më herët, pasi që struktura e ndërtimit të tyre nuk lejon qasje në ajër të pastër. Në korridorin tek dhomat e vetmisë ka kamera, ndërsa në korridorin e gjatë tek dhomat e vetmisë nuk ka kamera. Sa i përket ekzekutimit të masave disiplinore, masa e vetmisë mbahet në qelitë ku të burgosurit janë të vendosur.

Krahu A5 nuk është funksional pasi që janë duke u vendosur kamera dhe çipa për hapjen e dyerve. Një kompani private i ka dhuruar donacion TV dhe kamera. Në atë krahë gjenden 16 dhoma në total, ku në secilën dhomë do të vendosen çipa. Në këtë pavijon gjithashtu është një dhomë/sallë e gjykatës ku do të zhvillohen seancat gjyqësore prej burgut dhe ka një kamerë. Lidhur me këtë ende nuk është e definuar se si do të funksionojë kjo metodë e punës, mungon një plan i punës si p.sh: avokati a do të merr pjesë aty në sallë apo në gjykatë, a duhet zyrtarët korrektues të marrin pjesë në seancë a jo. Drejtoria Qendrore duhet të bëjë planin se si të veprohet me këto raste në të ardhmen.

QP Prishtinë ofron një numër të kufizuar të aktiviteteve për të burgosurit. Përveç shëtitjeve, për një pjesë të të dënuarve ofrohet edhe mundësia e punësimit në kuzhinë, saldim, pastrim, lavanderi dhe kopsht. Kjo situatë ndikon që të burgosurit të vazhdojnë të paraqesin kërkesa për shtimin e aktiviteteve në këtë qendër, edhe pse këtë vit salla e fitnesit që gjendet në krahun A6 është aktive ku të burgosurit ndahen në dy grupe nga 4 persona për ta shfrytëzuar nga ora 16:00 deri ora 18:00.

Të paraburgosurit kanë vizita dhe telefonata, kurse të dënuarit edhe mundësinë për vikende. Për të burgosurit të cilët nuk kanë vizita, QP Prishtinë u ka mundësuar që si zëvendësim të përdorin Skype.

Të paraburgosurit u ankuan në izolimin e tepërt dhe mungesën e aktiviteteve të lira. Kjo si rezultat i ndalesave dhe kufizimeve ligjore për këtë kategori, pasi që legjislacioni në fuqi nuk parasheh mundësi për ofrimin e aktiviteteve shtesë apo angazhimit në punë për të paraburgosurit. Gjatë 24 orëve, 22 orë janë të mbyllur në dhomat e tyre.

Meqenëse QP Prishtinë është qendër e paraburgimit, nuk ka programe rehabilituese dhe aktivitete tjera as për të dënuarit. Një pjesë e tyre janë të angazhuar në punë dhe i shfrytëzojnë vikendet. Sfidë e QP Prishtinë mbetet kategoria e personave të cilët nuk kanë dënime përfundimtare ende, për shkak se nuk mund t'i gëzojnë të drejtat si të dënuar.

Për të paraburgosurit vet ligji e kufizon mundësinë e aktiviteteve të lira, mirëpo meqë QP Prishtinë ka edhe të dënuar, do të duhej të ofroreshin programe adekuate që do të ndikojnë pozitivisht në rehabilitimin e tyre. Përveç shëtitjes dhe disa aktiviteteve sportive, mundësitë tjera janë shumë të limituara në QP Prishtinë.

Në QP Prishtinë ka qenë shqetësuese hapësira e vizitave për të paraburgosurit. Hapësirat e vizitave kanë qenë të ndara me xham dhe kontakti fizik me familjarët/vizitorët ka qenë i pamundur. Me iniciativën e QP Prishtinë, këto janë ndryshuar dhe është hap një hapësirë e vogël në xham. Ky ndryshim ka pasur ndikim pozitiv tek të paraburgosurit edhe pse sipas tyre hapësira është shumë e vogël dhe disa nga të intervistuarit u ankuan se nuk po kanë mundësi që të paktën të përqafojnë fëmijët e tyre.

Ambientet e kuzhinës janë të mirëmbajtura dhe përveç dy frigoriferëve që nuk punonin aparaturat tjera ishin funksionale. Në kuzhinë janë të angazhuar katër kuzhinier dhe dymbëdhjetë të dënuar.

Nga bisedat me të burgosurit si dhe stafin korrektues, nuk kishte ankesa ndaj ushqimit që ju servohet. Stafit ushqimi i servohet në sallën afër kuzhinës, kurse të burgosurve nëpër dhomat e tyre.

Mostrat e ushqimit ishin duke u ruajtur në një frigorifer i cili nuk punonte. Gjatë monitorimit në kuzhinë, stafi monitoruesi evidentoi 3 pako me spec të kuq të bluar me afat të skaduar, në total 3 kg neto (afati i përdorimit: 06.06.2022-06.06.2023), njëra nga këto pako u identifikua në pjesën ku përgatitej buka dhe ishte në përdorim ndërsa dy të tjerat në depo. Përveç këtyre u evidentuan edhe 2 pako miell me nga 5kg me afat të skaduar (26.04.2022-12 muaj përdorim) dhe një pako sheqer 5kg me datë të skadimit më 14.05.2023.



***QKRMT ka rekomanduar që të ketë kontrollim të vazhdueshëm rreth afateve të produkteve ushqimore, në mënyrë që të evitohet përdorimi dhe prezenca e tyre jashtë afatit të paraparë.***

Librezat sanitare për stafin e kuzhinës ishin në pritje për tu validuar nga IKSHPK-ja dhe gjendeshin në ambientet e IKSHPK-së, prandaj nuk ka pasur mundësi të shikohen nga ekipi monitorues.

Si sfidë tjetër me të cilën po ballafaqohet QP Prishtinë janë rastet e dënimeve me gjoba, ngase ndaj tyre duhet të ndermirën të gjitha procedurat e pranimit dhe akomodimit, ndërsa pasi që e paguajnë gjobën po lirohen nga gjykata. Ka raste të tilla kur lirohen menjëherë të nesërmen pasi që janë pranuar.

Lidhur me masat disiplinore, ekipi monitorues hasi në një rast i cili ishte nën masën disiplinore të vetmisë për 12 ditë, ajo çfarë tërheqi vëmendjen e ekipit monitorues është qëndrimi i tij në veçim për 5 ditë derisa është vendosur për rastin, ndërsa ndaj të njëjtit ka filluar që të ekzekutohet masa disiplinore e vetmisë pa i'u llogaritur 5 ditët e veçimit, që në total i bie se i burgosuri në fjalë do të mbaj 17 ditë vetmi.

***QKRMT e konsideron të padrejtë mos llogaritjen e ditëve të veçimit deri sa të merret Vendimi për shqiptimin e masës së vetmisë.***

Lidhur me aplikimin e veçimit në këtë formë, drejtori njoftoi ekipin monitorues se do të ndryshohet kjo praktikë e vendosjes në veçim.

Nga bisedat me të burgosurit, ekipi monitorues gjithashtu pranoi ankesa nga disa të burgosur, lidhur me bastisjet që ndodhin, ku sipas tyre bastisjet zakonisht bëhen kur ata janë në shëtitje dhe pa prezencën e tyre.

Sa i përket një krahu të veçantë ku është instaluar sistemi elektronik për hapjen e dymëve me kartela, i njëjti ende nuk është funksionalizuar. Ky pilot projekt ishte investuar nga Ambasada Amerikane në Prishtinë.

## 8. QENDRA E PARABURGIMIT NË GJILAN

Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës (QKRMT), me datë 13 korrik 2023 ka realizuar një vizitë të rregullt monitoruese në Qendrën e Paraburgimit në Gjilan.

Nga observimet e bëra dhe bisedat me të burgosurit, drejtorin dhe stafin korrektues vërehet se në përgjithësi është një atmosferë/klimë e mirë. Ndër problemet e përgjithshme me të cilat ballafaqohet kjo qendër vazhdojnë të jenë: dëmet në infrastrukturën e objektit (P2 ishte jashtë funksionit për shkak të renovimit, ku funksiononte vetëm një krahë në të cilin ishin të vendosur 25 të burgosur), mungesa e ujit, mungesa e stafit si dhe vendosja dhe trajtimi i të burgosurve me çrregullime mendore. Nga ana e të burgosurve vazhdojnë ankesat lidhur me efikasitetin e punës së gjykatave dhe mungesën e aktiviteteve.

QP në Gjilan akomodon të paraburgosur por edhe një numër të të dënuarve. Në ditën e vizitës gjendeshin 29 të dënuar, me dënime të ndryshme. Gjithashtu ka të burgosur me probleme mendore, përdorues të substancave narkotike si dhe numri në rritje është i personave për dhunë në familje. Këto kategori paraqesin vështirësi në menaxhim adekuat, meqë as ambienti e as stafi nuk janë në përputhje me nevojat e tyre.

Një ndër çështjet më shqetësuese në QP Gjilan mbeten të burgosurit me probleme mendore. Në Institutin e Psikiatrisë Forenzike të Kosovës ka numër të vogël shtretërisht, andaj një numër i të burgosurve me probleme mendore shpesh vendosen në këtë qendër.

QP Gjilan ka të angazhuar gjithsej 109 anëtar të stafit, nga të cilët 87 oficerë korrektues. Është njëra nga institucionet korrektuese që ka staf edhe nga komunitetet jo shumicë. Ka nevojë për shtimin e numrit të oficerëve korrektues në raport me numrin e të burgosurve (rreth 200 të burgosur), për më tepër kohëve të fundit ka pasur edhe transferim të stafit në qendra tjera. Është evidentuar si praktikë që gjatë rekrutimit për QP Gjilan kanë aplikuar nga komunat e tjera dhe të njëjtit pas një kohë kanë kërkuar transfer për në qendrat më të afërta me vendbanimin e tyre.

Ekipi i QKRMT, pranoi ankesa edhe nga pjesëtar të stafit për kushte jo të mira të punës, si dhe mos furnizimi me uniforma të reja ishte njëra nga ankesat më të shpeshta, ku sipas tyre kanë kaluar më tepër se 5 vite që kur janë furnizuar për herë të fundit.

Në QP Gjilan janë të vendosur të dënuar dhe të paraburgosur, në mesin e të cilëve ka edhe shtetas të huaj. Gjatë monitorimit, vëmendje e posaçme ju kushtua trajtimit që ju bëhet të burgosurve, shërbimeve që ju ofrohen si dhe sjellja e stafit korrektues, me theks të veçantë keqtrajtimi eventual, qoftë fizik apo psikik. Nga monitorimi i realizuar, QKRMT ka pranuar ankesa dhe pohime nga të burgosurit për mos trajtim të denjë nga njëri ndërrim i stafit korrektues. Kishte disa raste të konflikteve mes të burgosurve, duke përfshirë incidente mes vete, po ashtu edhe raste të vetëlëndimeve si dhe një rast tentim vetëvrasje. Sipas të dhënave nga menaxhmenti në gjashtë mujorin e parë të vitit 2023 (deri në ditën e vizitës monitoruese) janë evidentuar 25 incidente, ndërsa në 4 raste janë shqiptuar vetmit si masë dënimore.

Në QP Gjilan ka të burgosur me çrregullime mendore për të cilët kërkohet ekzaminim psikiatrik në IPFK, por në mungesë të hapësirave në IPFK janë vendosur në këtë qendër. Vendosja e të paraburgosurve me probleme mendore mbetet ndër sfidat kryesore në sistemin korrektues të Kosovës. QP Gjilan nuk ofron kushte adekuate për trajtimin e kësaj kategorie, as nga aspekti i burimeve njerëzore profesionale, por as edhe nga kushtet materiale. Sipas menaxhmentit, 6 të burgosur me çrregullime mendore janë nën mbikëqyrje, ndërsa një nga ta ishte në vëzhgim permanent (në dhomën me kamerë). QP në Gjilan posedon një dhomë me kamerë për rastet e mbikëqyrjes permanente.

Një çështje shumë shqetësuese e evidentuar gjatë vizitës monitoruese është vendosja e të burgosurve nëpër dyshekë në dysheme. Për shkak defekteve sanitare në Pavionin 2, të burgosurit janë zhvendosur vetëm në krahun L-4, ku ishin të vendosur 25 të burgosur si dhe të tjerët në Pavionin 1.

*Për këtë çështje QKRMT ka reaguar përmes një raporti të veçantë i cili më datë 17.07.2023 iu është dërguar mekanizmave përgjegjës për mbikëqyrjen e vendeve të privimit nga liria. QKRMT kërkoi që QP në Gjilan në koordinim me Shërbimin Korrektues të Kosovës, urgjentisht të bëjë një zgjidhje për vendosjen e të burgosurve në kushte të akomodimit të pranueshme, ashtu siç parashihet me legjislacionin vendor dhe Konventat e zbatueshme në Republikën e Kosovës, në mënyrë që të mënjanohet shkelja e të drejtave të personave të privuar nga liria, pasi që vendosja e të paraburgosurve në kushtet të tilla të akomodimit, në këtë rast mbipopullimit brenda dhomave, mund të përbëjë trajtim çnjerëzor ose poshtërues nga pikë vështrimi fizik*

*Pas këtij reagimi Shërbimi Korrektues me datë 20.07.2023 njoftoi se kanë ndërmarrë veprime të menjëhershme ku të gjithë të burgosurit janë akomoduar në dhomat me shtretër sipas standardeve dhe janë duke u trajtuar si të burgosurit tjerë. Po ashtu, më datë 21.07.2023 QKRMT ka pranuar njoftimin nga Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës i Avokatit të Popullit se ky mekanizëm e ka realizuar një vizitë monitoruese në QP Prishtinë me datë 20.07.2023.*

Përkundër që QP në Gjilan është ndër qendrat më të reja e ndërtuar viteve të fundit, kushtet materiale për vendosjen e të burgosurve ballafaqohen me problemet e dëmtimeve nga uji në infrastrukturën e objektit. Gjatë vizitës monitoruese ekipi i QKRMT u njoftua se Pavioni 2 është në renovimeve për shkak të bllokimit të gypave të ujit dhe rregullimit të tyre. Lagështi kishte edhe në pjesët e korridoreve dhe në disa dhoma ku u vizituan të burgosurit.

Sipas menaxhmentit, pengesë tjetër në realizimin e investimeve më të mëdha në këtë qendër paraqet çështja e marrëveshjes ndërmjet Kosovës dhe Danimarkës, për dhënien e QP Gjilan në shfrytëzim për shtetin e Danimarkës dhe meqenëse ende nuk është ratifikuar marrëveshja në parlamentin e Kosovës, nuk po kanë mundësi që të bëjnë lëvizje në atë drejtim, ngase me hyrjen në fuqi të marrëveshjes, investimet do të kryhen sipas kërkesave dhe nevojave nga Danimarka.

Të burgosurit janë të vendosur nëpër dhoma 1she dhe 2she. Edhe pse QP Gjilan është në mesin e institucioneve korrektuese të reja, është e nevojshme renovimi i disa prej ambienteve. Dhomat e të burgosurve në shumë raste ishin të vizatuara apo te shkruara dhe të shkarravitura dhe në disa dhoma të burgosurit ishin detyruar të improvizonin në muret e dhomës sepse i gjithë muri ishte i mykur.

Si rezultat i renovimit në Pavionin 2, janë bërë edhe lëvizje të të burgosurve në krah të tjerë, me ç'rast ekipi i QKRMT gjatë monitorimit hasi në disa dhoma ku ishin të vendosur dyshek në dysheme, përkatësisht ekipi monitorues vizitoi 10 dhomat të cilit ishin dhoma njëshe me nga një shtrat por që ishte vendosur edhe nga një i burgosur në dysheme (në dyshek). ***QKRMT rekomandon që në secilën dhomë duhet të ketë shtretër për çdo person të vendosur aty, pavarësisht rrethanave të caktuara për arsye renovimi apo ndonjë arsye tjetër, ngase paraqet nivelin nën standard minimal të ofrimit të kushteve materiale-akomodimit për një person të privuar nga liria.*** Punimet për zgjerimin e hapësirave tek hyrja kryesore për zhvillimin më të lehtë të vizitave familjare ende nuk kishin përfunduar përkundër që punimet kanë qenë duke u zhvilluar edhe gjatë vizitës monitoruese të vitit 2022, gjë që tregon se punët në këtë pjesë janë duke shkuar shumë ngadalë.

Një tjetër çështje shqetësuese që ka evidentuar ekipi monitorues edhe gjatë vizitave të kaluara dhe vazhdon të jetë prezentë ende, është çështja e tualeteve të hapura në disa dhoma, për çka ekipi pranoi ankesa edhe nga të burgosurit, ngase paraqet një cenim privatësie dhe përveç kësaj, gjatë temperaturave të larta kundërmimi ishte mjaftë i rëndë, duke shtuar këtu se në disa dhoma kishte edhe rrjedhje uji.

Në shumicën e dhomave të vizituara mungonin karriget, apo në disa raste ishin shumë të dëmtuara dhe jashtë funksionit. Në mungesë të karrikave gjatë ushqyerjes të burgosurit duhet të ulen në shtrat apo në disa raste edhe në tokë (raste të evidentuara nga ekipi monitorues), sidomos shqetësuese ishte tek dhomat e mbipopulluara ku nga një i burgosur ishte vendosur në dysheme.

Sa i përket masave të vetmisë, ekzekutimi i tyre vazhdon të bëhet në dhomat e veçanta, të cilave iu mungon ndriçimi adekuat natyror dhe qasja në ajër të pastër. Sikurse edhe më parë, QKRMT vlerëson se këto dhoma nuk i plotësojnë kushtet për vendosjen e të burgosurve. Sikurse në QP Gjilan infrastruktura e dhomave të vetmisë është e njëjtë edhe në QP Prishtinë, por në QP Prishtinë asnjëherë nuk janë përdorur këto dhoma përshkak se nuk i plotësojnë kushtet fizike për vendosjen e të burgosurve. Prandaj, QKRMT përsërit rekomandimin që të rishikohet mundësia e përdorimit të këtyre hapësirave në kushte të tilla.

Stafi i QKRMT-së morri ankesa nga të burgosurit për produktet hixhienike sepse sipas tyre nuk ju sjellin mjaftueshëm dhe për të pastruar dhomat e tyre duhet të blejnë produktet me parat e tyre ndërsa për personat që jetojnë në kushte të dobëta ekonomike dhe nuk kanë mundësi t'i blejnë në kantinë, dhomat janë mjaftë të pa pastërta.

Në QP Gjilan në mungesë të aktiviteteve të lira, të burgosurit shumicën e kohës e kalojnë në dhomat e tyre duke shikuar TV. Nga dhomat e vizituara pati TV të cilët ofronin vetëm 3-4 kanale për shikim, disa deri në 16 mirëpo 12 nga to ishin në gjuhën serbe, megjithatë iu lejohen DVD dhe mundësin e posedimit të CD-ve. Furnizimin me TV të burgosurit e bëjnë me mjete vetanake përmes kantinës, ata që kanë mundësi.

Ekipi monitorues evidentoi se pajisjet për fikjen e zjarrit ishin pa afat. Servisimi (kontrolla) e fundit ishte bërë më datë 04.02.2021 me afat vlefshmërie për 6 muaj. Pra që nga data 04.08.2021 pajisjet për fikjen e zjarrit janë pa afat përdorimi.

Sa i përket aktiviteteve në QP Gjilan, të dënuarit janë të angazhuar në punë, kryesisht në mirëmbajtje, në kuzhinë dhe renovimet që bëhen në këtë institucion. Ndërsa ka edhe disa nga paraburgosurit të cilët me leje të gjykatës janë të angazhuar në punë.

Vizitat familjare realizohen me rregull, dy herë në muaj. Për të burgosurit të cilët nuk kanë vizita të rregullta, ju mundësohet komunikimi përmes Skype. Telefonatat zhvillohen përmes pakos të ofruar nga operatori i kontraktuar, me ç'rast të burgosurit duhet të paguajnë nga 5 Euro në muaj. Aktualisht telefonatat mund të zhvillohen vetëm brenda vendit, ndërsa për të burgosurit që kanë familjarë jashtë si dhe për të huajt i'u mundësohet komunikimi përmes SKYPE. Përveç vizitave dhe telefonatave, të paraburgosurve ju lejohen edhe shëtitje në ambient të hapur dy herë në ditë nga 1 orë.

Të paraburgosurit u ankuan në izolimin e tepërt dhe mungesën e aktiviteteve të lira. Kjo si rezultat i ndalesave dhe kufizimeve ligjore për këtë kategori, pasiqë legjislacioni në fuqi nuk parasheh mundësi për ofrimin e aktiviteteve shtesë apo angazhimit në punë për të paraburgosurit pa vendim nga gjykata. Edhe në QP Gjilan ka persona me paraburgime të gjata, që janë si rezultat i vonesave të gjykatave në vendosjen e rasteve, rigjykimet, etj. Gjatë 24 orëve, përveç shëtitjeve dy herë nga një orë, të paraburgosurit janë të mbyllur për pjesën tjetër të ditës. Përderisa janë me statusin e të paraburgosurit, ata kanë më pak të drejta, privilegje dhe aktivitete gjatë qëndrimit në institucionet korrektuese. Kjo situatë po ndikon në shtimin e pakënaqësive të të paraburgosurve.

Megjithatë përveç kufizimeve në bazë të statusit të të paraburgosurve, në këtë qendër të paraburgimit nuk ka asnjë hapësirë të veçantë për realizimin e aktiviteteve, dhe rrjedhimisht nuk organizohet asnjë aktivitet fizik edhe për të dënuarit e vendosur në QP Gjilan.

QKRMT u informua ishin realizuar dy aktivitete me të burgosurit, 'Biseda për zemërim' dhe 'Menaxhimi i zemërimit'.

Ekipi monitorues ka vizituar edhe ambientet e kuzhinës ku është takuar me zyrtarët përgjegjës. Në kuzhinë janë rreth 11 persona të angazhuar, 3 punëtor duke përfshi edhe kuzhinierin, kurse pjesa tjetër janë të dënuar që punojnë.

Ambienti i kuzhinës është i mirëmbajtur dhe shumica e pajisjeve janë funksionale, përveç shporeteve me gaz të cilët vazhdojnë të jenë jashtë funksionit si mungesë e plinit dhe si rezultat i kësaj përgatitja e ushqimit vazhdonte të bëhej vetëm me energji elektrike. Gjithashtu ekipi i QKRMT vërejti se sistemi i ventilimit ishte rregulluar. Mostrat e ushqimit ishin të ruajtura. Librezat sanitare po ashtu ishin të vërtetuara.

Të burgosurit e intervistuar u shprehën kryesisht të kënaqur me ushqimin që ju shërbehet. Disa nga të burgosurit u ankuan në ushqimin që u servohet në darkë dhe mëngjes, ku zakonisht u jepet ushqim i konservuar. Ushqimi iu shpërndahet nëpër dhoma.

Monitoruesit e QKRMT-së vizituan edhe ambientet ku ruhen rezervat e ushqimit. Në QP Gjilan janë dy depo ku ruhen rezervat e ushqimit, depoja e përditshme dhe depoja emergjente. Në depon ku mbanin mishin ekipi i QKRMT gjeti *1 pako me sheqer të hapur, me peshë 5kg, të cilës i kishte skaduar afati me dt. 01.06.2023, e cila u largua menjëherë nga përgjegjësi i kuzhinës.*

**Sipas të burgosurve, kishte mjaftë ankesa rreth trajtimit shëndetësor si dhe pritjeve për vizita.** Përveç vizitave mjekësore pati ankesa të veçanta në mungesë të trajtimit adekuat nga psikiatri si dhe për pritjet për trajtim nga stomatologu. Po ashtu kishte ankesa edhe për mungesë të barnave herë pas here.

## 9. QENDRA E PARABURGIMIT NË PEJË

Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës (QKRMT), me datë 19 Korrik 2023 ka realizuar një vizitë monitoruese në Qendrën e Paraburgimit në Pejë. QP në Pejë akomodon të paraburgosur por edhe të dënuar. Në ditën e vizitës gjendeshin 9 të dënuar, me dënime të ndryshme.

Në këtë qendër edhe këtë vit ka pasur ndryshime në stafin drejtues, ashtu që është ndërruar zv. i drejtorit të qendrës.

Në QP Pejë ka persona me paraburgime relativisht të gjata, ankesat kryesore të tyre kanë të bëjnë me efikasitetin e punës së gjykatave.

Në ditën e monitorimit prezent ishin gjithsej 77 të burgosur (pothuajse me kapacitet të plotë nga 80 vende gjithsej), nga të cilët 68 të paraburgosur dhe 9 të dënuar. Në IPFK gjendej 1 i burgosur. Për dallim nga vizita e fundit vërehet që ka pasur një rritje të lehtë të numrit të të burgosurve.

Sipas zyrtarëve të QP Pejë gjatë këtij viti ka pasur një rast të kontrabandimit, bëhet fjalë për një telefon, ku zyrtarët e qendrës kanë arritur që ta kapin gjatë bastisjes. Gjithashtu ka pasur raste edhe të tentim kontrabandës përmes USB, mirëpo të cilat janë parandaluar.

Në QP Pejë mosha mesatare e stafit korrektues është rreth 55 vjeçare. Rregullisht ka anëtar të stafit të cilët janë duke u pensionuar, me probleme shëndetësore si dhe transfere në qendrat tjera, një gjë e tillë po paraqet problem mjaft të theksuar në menaxhimin e duhur të stafit, ndërsa më të vështirë e bënë tani edhe periudha e pushimeve verore.

Nga monitorimi i realizuar, QKRMT nuk ka pranuar ankesa apo pohime nga të burgosurit për keqtrajtim në këtë qendër. Shumica nga të intervistuarit kanë deklaruar se kanë raporte të mira me stafin korrektues, megjithatë nga disa të burgosur pranuan pohime se disa pjesëtar të stafit korrektues sillen keq ndaj tyre. Nga observimet e bëra, përkundër disa ankesave, QKRMT vlerëson se në QP Pejë në përgjithësi ka një klimë të mirë mes të burgosurve dhe zyrtarëve korrektues. Sipas zyrtarëve të lart të qendrës, raste të përdorimit të forcës nuk ka pasur.



Është raportuar se ka incidente në mes të paraburgosurve, mirëpo ndodhin rrallë. Gjithashtu u raportua se ka pasur raste të vetëlëndimeve. Në QP Pejë kishte disa të burgosur me çrregullime mendore (gjithsej 18 nga janari 2023). Vendosja e të burgosurve me probleme mendore vazhdon të mbetet ndër sfidat kryesore në sistemin korrektues të Kosovës. QP Pejë nuk ofron kushte adekuate për trajtimin e kësaj kategorie, as nga aspekti i burimeve njerëzore profesionale, por as edhe nga kushtet materiale.

Herë pas here ka raste që vendosen nën mbikëqyrje të shtuar për shkak problemeve të shëndetit mendor. Sipas evidencave, gjatë periudhës së parë vitit 2023 (deri në ditën e vizitës monitoruese) kanë qenë 15 raste nën mbikëqyrje të shtuar.

**Nga vlerësimet e QKRMT-së, vendosja e të paraburgosurve me probleme mendore në qendra të paraburgimit, përveç që është në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe standardet e të drejtave të njeriut, është sfiduese për stafin e këtyre institucioneve që t'i trajtojnë dhe menaxhojnë këto raste, QKRMT e përsërit nevojën për vendosjen e personave me probleme të shëndetit mendor në një institucion të veçantë sa më shpejtë që është e mundur, i cili i plotëson kushtet materiale dhe njerëzore për trajtimin e kësaj kategorie.**

Sikurse edhe në qendrat tjera, ashtu edhe në QP Pejë fenomeni i të burgosurve për vepra që lidhen me narkotik është në rritje. Sipas oficerëve korrektues edhe kjo kategori të burgosurish shpesh janë sfiduese për tu menaxhuar.

Shqetësimet kryesore të të paraburgosurve ndërlidhen me punën e gjykatave por dhe me mungesën e aktiviteteve të lira.

Si shqetësim i veçantë gjatë kësaj vizite monitoruese ishte ballafaqimi me të nxehtit dhe pamjaftueshmërinë e oksigjenit, për shkak të temperaturave të larta që mbizotëronin gjatë kësaj periudhe kohore. Një gjë e tillë u vërejt edhe nga ekipi i QKRMT-së gjatë monitorimit, ku me të vërtetë ambientet brenda qendrës ishin mjaft të nxehta dhe pamjaftueshmëria e oksigjenit ishte e evidente. Rreth këtij problemi ekipi monitorues pranoi ankesa edhe nga vet stafi i qendrës. Për t'ua lehtësuar sado pak këtë gjendje, udhëheqësi i qendrës na njoftoi se e ka aprovuar kërkesën e të burgosurve për t'ua mundësuar blerjen e disa ventilatorëve të vegjël nga vet të burgosurit.

QKRMT gjithashtu konsideron se është me rëndësi që të paraqes ankesat e të burgosurve lidhur me çështjen e zvogëlimit të hapësirave ndërmjet të burgosurve dhe vizitorëve në ambientet për vizita. Më parë sipas tyre kanë pasur mundësi për kontakt fizik më të madh me familjarët e tyre, mirëpo tani ka mbetur vetëm një hapësirë shumë e vogël, gjë që paraqet shqetësim për të burgosurit, sidomos për ata të cilët kanë fëmijë. Lidhur me këtë çështje u njoftuam edhe gjatë takimit me udhëheqësit e qendrës dhe sipas tyre një gjë e tillë është bërë për arsye sigurie, me qëllim parandalimin e kontrabandimit.

**QKRMT vlerëson se zvogëlimi i hapësirës ndërmjet të burgosurve dhe vizitorëve në ambientet për vizita, paraqet një regres në trajtim ndaj të burgosurve, aq më tepër atyre me statusin e të dënuarve, ngase konsiderojmë që mundësia e kontaktit fizik e të burgosurve me familjarët e tyre, në veçanti e atyre që kanë fëmijë, paraqet një rëndësi të madhe në mirëqenien e të burgosurve në aspektin emocional e psikologjik. Ndërsa sa i përket aspektit të sigurisë konsiderojmë që nuk është e drejtë që për veprimet e disa individëve të pësojnë të gjithë të burgosurit e tjerë dhe gjithashtu konsiderojmë që kontrollimet e mirëfillta që bëhen gjatë hyrjes në qendër nga vizitorët janë të parapara për parandalimin e kontrabandës sikurse për çështje tjera sigurie.**

QP në Pejë aplikon sistemin elektronik elektronik të të dhënave i cili përfshinë një gamë të të dhënash për të burgosurit në këtë qendër, duke përfshirë të dhënat e përgjithshme të çdo të burgosuri si dhe të dhënat rreth shkeljeve dicitlinore, masave dicitlinore, vetmit, grevat e urisë, mbikëqyrjen e shtuar, rastet e vdekjeve, tentim vetëvrasjeve, etj. Sistemi përditësohet në vazhdimësi me të dhënat sipas rasteve, ku edhe mundësohet gjenerimi i të dhënave sipas llojeve të kërkesave. Këtë sistem, QP në Pejë e aplikon që nga viti 2010.

**QKRMT e vlerëson mirëmbajtjen dhe përditësimin e vazhdueshëm të sistemit elektronik të të dhënave dhe inkurajon edhe qendrat e tjera që ta aplikojnë në këtë mënyrë.**

QP në Pejë mbetet në mesin e institucioneve korrektuese të cilat ende janë të vendosura në objekte të vjetra. Udhëheqësit e qendrës njoftuan se gjatë 6-7 muajve të fundit është bërë gëlqerosja e të gjitha dhomave, ndërsa vazhdojnë të jenë prezentë problemi i nyjave sanitare dhe instalimi i ventilimit adekuat të dhomave dhe korridoreve. Përtej këtyre problemeve, vërehej se ka pastërti të mjaftueshme.

Për shkak të strukturës së objektit, dhomat janë të ngushta. Nëpër dhoma vendosen kryesisht nga 4 persona, edhe pse pranuam informata se ka raste kur vendosen nga 5 persona në një dhomë, që në raste të tilla njëri nga ta duhet të flejë në dyshek të vendosur në dysheme. Dhomat me hapësirat aktuale nuk i përmbushin kriteret ligjore për hapësirën e nevojshme që duhet të ketë secili i burgosur (Neni 35, LESP). Në dhomat aktuale nuk duhet të vendosen më shumë se 3 të burgosur.

**Vendosja e të burgosurve në dysheme (dyshek) është në kundërshtim me standardet për vendosjen dhe trajtimin e të burgosurve, andaj QKRMT rekomandon që kjo praktikë të ndalohet.**

Po ashtu, sipas infrastrukturës së këtij institucioni, dhomat e banimit nuk kanë dritare sipas standardeve, por të njëjtat kanë qasje në korridor, pastaj nga korridori përmes dritareve të tjera kanë qasje në dritë natyrale. Kushte këto që janë nën standardet minimale.

Mungesa e ventilimit nëpër dhoma dhe korridore është shqetësim i ngritur kohë më parë, dhe vazhdon të jetë situata e njëjtë nga vizitat paraprake. Në muret e disa dhomave janë vërejtur gjurmë të lagështisë të formuara nga rrjedhjet e ujit, sikurse edhe në disa nga banjot e dhomave të vizituara.

**QKRMT përsërit rekomandimin që ShKK duhet të ndërmerri veprime konkrete për intervenime më të përgjithshme sa i përket rregullimit të ventilimit dhe të nyjave sanitare me qëllim të ofrimit të kushteve më të mira për të burgosurit gjatë periudhës kohore sa janë duke qëndruar në këtë objekt. QKRMT mirëpret zbatimin e rekomandimit për ndërtimin e një objekti të ri, i cili është planifikuar me buxhetin për vitin 2024. Sa i përket furnizimit me ushqim, zyrtarët udhëheqës të qendrës deklarojnë se është i mjaftueshëm, mirëpo si problematik kohëve të fundit është paraqitur mungesa e furnizimit me produkte të higjienës, për çka pranuam ankesa edhe nga të burgosurit. Ekipi monitorues gjithashtu u njoftua se është bërë një furnizim i vogël me 50 çarçafë, mirëpo gjatë vizitave nëpër dhoma vërehej nevoja për furnizime tjera ngase shumica e dyshekëve ishin të dëmtuar dhe në gjendje jo të mirë.**

**Si ndryshim pozitiv dhe i mirëpritur nga të burgosurit është instalimi i sistemit të kablllovakut, ngase vazhdimisht ka pasur ankesa nga të paraburgosurit se qëndrimin prej 22 orësh mbyllur do t'ua lehtësonte sadopak shtimi i numrit të kanaleve.**

Vizitat familjare realizohen rregullisht ashtu siç parashihet me ligj. Aktualisht nuk kishte në mesin e të dënuarve që janë shfrytëzues të vikendeve. Sa i përket komunikimit përmes telefonit, vazhdon komunikimi përmes pakos 5 euro në muaj, sipas marrëveshjes që e ka bërë ShKK me PTK, ndërsa për të burgosurit që kanë familjarët e tyre jashtë vendit, i'u mundësohet komunikimi përmes SKYPE. Sa i përket aktiviteteve, në dispozicion për të dënuarit është një numër i kufizuar i tyre. Shumica nga të dënuarit janë të angazhuar në punë, kryesisht në kuzhinë dhe pastrim. E kanë në dispozicion shëtitoren, e cila është shumë e vogël. Gjithashtu kanë një tavolinë pingpongu.

Të paraburgosurit u ankuan në izolimin e tepërt dhe mungesën e aktiviteteve të lira. Kjo si rezultat i ndalesave dhe kufizimeve ligjore për këtë kategori, pasi që legjislacioni në fuqi nuk parasheh mundësi për ofrimin e aktiviteteve shtesë apo angazhimit në punë për të paraburgosurit (me përjashtime kur i lejon gjykata). Edhe në QP Pejë ka persona me paraburgime të gjata, që janë si rezultat i vonesave të gjykatave në vendosjen e rasteve, rigjykimet, etj. Gjatë 24 orëve, përveç shëtitjeve dy herë nga një orë, si dhe kohës për ngrënie, të paraburgosurit janë të mbyllur për rreth 22 orë gjatë ditës. Përderisa janë me statusin e të paraburgosurit, ata kanë më pak të drejta, privilegje dhe aktivitete gjatë qëndrimit në institucionet korrektuese. Lehtësim sadopak të kësaj gjendje ka bërë instalimi i sistemit të kablllovakut.

Hapësira e kuzhinës në përgjithësi ishte e mirëmbajtur dhe aparaturat shumica ishin në gjendje të rregullt pune edhe pse me prishje të shpeshta për shkak të vjetërsisë. Gjatë monitorimit të ambienteve të kuzhinës, ekipi monitorues nuk hasi në produkte ushqimore me afat të skaduar, vërehej një përmirësim i menaxhimit të produkteve ushqimore nga vizitat e mëhershme. Ekipi monitorues bëri edhe shikimin e mostrave të ushqimit dhe librezave sanitare, ku tek mostrat mungonte ajo e datës 18.07.2023, ndërsa sa i përket librezave sanitare, janë lajmëruar për vazhdim që 1 muaj së paku, mirëpo nuk janë sjellur ende. Konsiderojmë se është me rëndësi të ceket gjithashtu numri i vogël i stafit që punonte në kuzhinë. Aktualisht ishin të punësuar 2 staf zyrtar dhe 2 të burgosur.

Të burgosurit e intervistuar u shprehën kryesisht të kënaqur me ushqimin që ju shërbehet. Disa nga të burgosurit u ankuan në ushqimin që u servohet në darkë, ku zakonisht u jepet ushqim i konservuar. Tri vaktet e ushqimit ju shërbehet nëpër salla të përbashkëta. Kjo ka ndikuar në mbajtjen e pastërtisë nëpër dhoma.

## 10. QENDRA E PARABURGIMIT NË PRIZREN

Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës (QKRMT), me datë 01 nëntor 2023 ka realizuar një vizitë monitoruese në Qendrën e Paraburgimit në Prizren.

QP në Prizren akomodon të paraburgosur por edhe të dënuar. Kapaciteti i QP Prizren në të kaluarën ka qenë 88, ndërsa tani është 72+2 shtretër.

Në ditën e vizitës gjendeshin 67 të burgosur nga të cilët 53 në paraburgim dhe 15 të dënuar, me dënime të ndryshme, në mesin e tyre kishte edhe të dënuar me 17, 14 dhe 12 vjet burgim. Në këtë vizitë stafi i QKRMT-së u informua se ishte një person me rrezikshmëri shumë të lartë.

Drejtuesit e institucionit njoftuan ekipin se mbetet sfiduese trajtimi i personave me çrregullime mendore. Në total ishin 10 persona me çrregullime mendore, në ditën e vizitës ishin 9, ndërsa njëri nga ta ishte në IPFK. Nga 10 këta persona njëri ishte në vëzhgim të shtuar-çdo 30 minuta. Shpeshherë ndodhë që të burgosurit me çrregullime mendore të shkaktojnë probleme në institucion, siç ishte rasti i ndodhur para disa ditëve, ku i burgosuri kishte Vendim për Masë të Trajtimit të Detyrueshëm psikiatrik, mirëpo në mungesë të vendeve në IPFK ishte vendosur në QP Prizren dhe i njëjti kishte shkaktuar probleme gjatë qëndrimit në këtë institucion. I njëjti ishte transferuar për QK Dubrave.

Në QP Prizren gjithmonë ka qenë një praktikë e mirë e vizitave nga ana e kryetarit të Gjykatës Themelore të Prizrenit, mirëpo me ndryshimet e bëra në Gjykatën Themelore të Prizrenit, të paraburgosurit për herë të fundit janë vizituar në prill të këtij viti nga kryetarja e re.

Sipas menaxhmentit, gjatë vitit 2023 (deri në ditën e vizitës monitoruese) në QP Prizren nuk ka pas raste të kontrabandës dhe nuk është raportuar për ndonjë incident apo raste të vetëlëndimeve të rënda.

QP Prizren i ka të angazhuar 92 anëtar të stafit, nga ta 77 uniformë dhe 15 civil. Nuk ka pasur rekrutime të reja të stafit korrektues.

QKRMT nuk ka pranuar ndonjë ankesë nga të burgosurit sa i përket trajtimit jo të duhur nga stafi. Të intervistuarit kanë deklaruar se stafi sillet mirë me ta dhe është gjithmonë në gatishmëri për ta. QKRMT ka vërejt në përgjithësi një klimë të mirë mes të burgosurve dhe zyrtarëve korrektues.

Në QP Prizren gjendeshin dhjetë të burgosur me çrregullime mendore. Sipas menaxhmentit të QP Prizren, aktualisht janë duke i menaxhuar mirë, megjithatë njëri nga ta ishte në vëzhgim të shtuar. QP Prizren nuk ofron kushte adekuate për trajtimin e kësaj kategorie, as nga aspekti i burimeve njerëzore profesionale, por as edhe nga kushtet materiale.

**QKRMT rekomandon ShKK-në të ketë parasysh statusin si qendër e paraburgimit, strukturën e objektit, përgatitjen e stafit si dhe lokacionin e institucionit, me rastin e vendosjes së personave me çrregullime mendore.**

Shqetësimet kryesore të të paraburgosurve ndërlidhen me punën e gjykatave por dhe me mungesën e aktiviteteve të lira në QP në Prizren.

Të dënuarit e QP Prizren paraqiten shqetësimet e tyre edhe ndaj punës së Panelit për Lirim me Kusht (PLK). Kanë ankesa ndaj shqyrtimit që ju bëhet kërkesave të tyre, përgjigjet e vonuara të PLK-së, etj. Po ashtu, ankesat e të dënuarve ishin edhe rreth pakos ushqimore. Fillimisht me futjen e pakove ushqimore në ligj, kjo qendër kishte filluar zbatimin e saj menjëherë ani pse qendrat tjera ende nuk kishin filluar. Të dënuarit kishin vazhduar marrjen e pakove për 9 muaj nga 5kg dhe me mundësi që ushqimin të konsumonin në dhomat e tyre. Për një periudhë kjo pako u ndalua deri në nxjerrjen e Rendit të ri Shtëpiak, me ç'rast kishte rifilluar, mirëpo tani të dënuarit mund të pranonin vetëm 3 kg ushqim dhe të njëjtin duhet ta konsumojnë gjatë vizitës familjare. Kjo gjë nuk është prit mirë nga të dënuarit për shkak se gjatë vizitës familjare koha nuk po ju mjafton si dhe nuk po mund ta shijojnë ashtu siç duhet ngase nuk po ndihen rehat përball familjarëve të tyre.

Po ashtu kishte ankesa të shumta sa i përket të drejtës në lirim të parakohshëm, ku sipas të dënuarve, Gjykata Themelore në Prizren kryesisht po i vonon përgjigjet e kërkesave të dënuarve për lirim të parakohshëm.

Ekipi i QKRMT-së hasi edhe në ankesa nga disa të burgosur sa i përket listës së produkteve të kantinës, ata kërkuan që me përfundimin e tenderit të kompanisë për kantinë, të ndryshohej lista e produkteve dhe të bëhej e njëjtë si e qendrave korrektuese tjera në Kosovë. Nga të dënuarit në këtë qendër pati kërkesa edhe për mundësimin e pajisjeve për gatim të ushqimit (pllaka elektrike), ngase sipas tyre në qendrat tjera kjo i'u mundësohet të dënuarve.

QP në Prizren mbetet në mesin e institucioneve korrektuese të cilat ende janë të vendosura në objekte të vjetra. Mirëpo, edhe pse është një institucion mjaft i vjetër, i ndërtuar në vitin 1964, pastërtia ishte në nivel shumë të lartë. Higjiena mbahet nga vet të burgosurit, ku disa nga të burgosurit janë të angazhuar në punë të pastrimit.

Gjatë këtij viti ishte bërë renovimi i banjove ku ishte rregulluar bojleri, pllakat si dhe sistemi i ventilimit. Sistemi i ventilimit ishte rregulluar vetëm në njërën anë ndërsa në tjetrën tek të burgosurit ende nuk ishte rregulluar dhe kjo po i shkakton pakënaqësi edhe të dënuarve për shkak të aromës jo të mirë që vjen nga banjot nëpër dhoma, ndërsa arsyeja sipas menaxhmentit qëndron për faktin se kompania e kontraktuar nuk ka mundur të siguroj pajisjen sipas kapacitetit dhe kriterëve që kërkohen.

**Ajrosja e rregullt, e sidomos në dhomat në QP Prizren brenda të cilave janë të vendosura toaletet, funksionimi i rregullt i ventilimit është i nevojshëm. Marrë parasysh gjithashtu faktin se objekti është ndërtim i vjetër dhe hapësirat e ngushta për vendosjen e të burgosurve, duhet të konsiderohet rregullimi sa më i shpejtë i ventilimit, më qëllim të ofrimit të kushteve më të mira për të burgosurit.**

Nëpër dhoma kanë qenë të vendosur kryesisht nga 4 persona, ndërsa që nga gushti 2023 për shkak të strukturës së objektit dhe dhomave të ngushta numri nëpër dhoma është reduktuar në 3 persona, në përjashtim të dy dhomave të cilat janë më të mëdha. Sipas menaxhmentit, tani në këto dhoma ka hapësira prej 4 m<sup>2</sup> për një të burgosur, çka nënkupton se është brenda standardeve të kërkuara. Kjo praktikë po vazhdon ende pasi që ka vend për të vazhduar në këtë mënyrë por në rast se ndodh të ketë mbipopullim shtretërit e larguar do rikthehen. Si pasojë e këtij ndryshimi gjatë stinës së verës, qëndrimi në këto dhoma ka qenë më i lehtë, andaj edhe për të burgosurit ka qenë e mirëpritur. Po ashtu, gjatë verës të burgosurve i është mundësuar edhe hapja e dymëve që të ketë më shumë ajër dhe përdorimi i flladitëseve deri në ora 2 të natës.

QKRMT e ka mirëpritur zvogëlimin e numrit të burgosurve të vendosur nëpër dhomë, duke pasur parasysh kushtet e këtij institucioni dhe rekomandon që edhe në vijim mos të vendosen më shumë se 3 të burgosur brenda dhomave.

Në Qendrën e Paraburgimit në Prizren ishin dy dhoma të cilat përdorshin në raste të shqiptimit të masës së vetmisë. Njëra ishte e pajisur me kamerë, mirëpo kur përdoret vetëm për shqiptimin e vetmisë e jo për vëzhgim, kamera nuk përdoret për shkak të privatësisë.

Vizitat familjare në QP Prizren zhvilloheshin normal sipas planit të vizitave, ndërsa Skype aktualisht është në dispozicion për të burgosurit të cilët nuk kanë vizita.

Sa i përket kontaktit me telefon, çështja e mungesës së kartelave për thirrje telefonike vazhdon të jetë prezente, ndërsa si alternativ SHKK ka bërë zgjidhje në bashkëpunim me operatorin telefonik që kabina telefonike të punoj pa kartela, ndërsa të burgosurit duhet të paguajnë shumën prej 5 euro në muaj në kompensim të minutave që shfrytëzojnë për komunikim. Mirëpo, për ata që kishin të afërmit e tyre jashtë Kosovës, ishte problematike të kontaktonin me ta, ngase sipas mënyrës aktuale, pakoja e ofruar nga operatori nuk ju mundëson një gjë të tillë. Telefonatat bëhen 2 herë në javë nga 15 minuta për të paraburgosurit. Ndërsa të dënuarit kishin qasje në përdorimin e telefonit, sa herë të dëshironin nga ora 7:00-19:00.

Sa i përket aktiviteteve, në dispozicion për të dënuarit është një numër i kufizuar i tyre. 15 nga të dënuarit janë të angazhuar në punë, kryesisht në kuzhinë dhe pastrim. Pagesat e tyre janë ekzekutuar me rregull. E kanë në dispozicion shëtitoren, e cila është shumë e vogël. Kanë pasur një tavolinë pingpongu por që është dëmtuar nga shiu.

***Duke marrë parasysh se disa nga të dënuarit kanë dënime të gjata, këto aktivitete të kufizuara nuk janë të mjaftueshme. Kjo paraqet problem në risocializimin dhe rehabilitimin e tyre. QKRMT rekomandon ShKK të ndërmerr veprime për shtimin e programeve rehabilituese për të dënuarit e QP Prizren.***

Të paraburgosurit treguan se janë të izoluar për një kohë të gjatë të ditës dhe nuk kanë shumë aktivitete. Kjo si rezultat i ndalesave dhe kufizimeve ligjore për këtë kategori, pasi që legjislacioni në fuqi nuk parasheh mundësi për ofrimin e aktiviteteve shtesë apo angazhimit në punë për të paraburgosurit. Edhe ne QP Prizren ka persona me paraburgime të gjata, që janë si rezultat i vonesave të gjykatave në vendosjen e rasteve, rigjykimet, etj. Gjatë 24 orëve, përveç shëtitjeve dy herë nga një orë, si dhe kohës për ngrënie, të paraburgosurit janë të mbyllur për rreth 22 orë gjatë ditës. Përderisa janë me statusin e të paraburgosurit, ata kanë më pak të drejta, privilegje dhe aktivitete gjatë qëndrimit në institucionet korrektuese.



Përkundër objektit të vjetër, hapësira e kuzhinës ishte e mirëmbajtur shumë mirë në përgjithësi. Kuzhina ishte e pastër dhe vetëm një pllakë nuk punonte sepse kishte mungesë të gazit. Menyja ditore ishte e përcaktuar nga niveli qendror. Në ditën e vizitës ushqimi ishte i përgatitur mirë dhe i mjaftueshëm.

Të burgosurit e intervistuar u shprehën kryesisht të kënaqur me ushqimin që ju shërbehet. Tri vaktet e ushqimit ju shërbehet nëpër salla të përbashkëta. Kjo ka ndikuar në mbajtjen e pastërtisë nëpër dhoma. Sallat e ushqimit mbaheshin shumë pastër. Mostrat e ushqimit dhe librezat sanitare ishin në rregull.

## Përmbushja e rekomandimeve nga Raporti vjetor për vitin 2023

Rekomandimi	Zbatimi i rekomandimit	Rekomandimi vazhdon
<p>➤ Te ndërmerren veprime konkrete për përmirësimin e trajtimit të të burgosurve, duke përfshirë:</p>		
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përditësimin dhe avancimin e programeve rehabilituese në institucionet korrektuese;</li> </ul>	Kanë filluar disa programe.	2024 ✓
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Zhvillimin e mëtejshëm të vlerësimit fillestar dhe të planit individual;</li> </ul>	Realizuar pjesërisht.	2024
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Forcimin e shërbimeve sociale, rritjen e numrit të punëtoreve social;</li> </ul>	3 punëtorë social kanë fillu punën në viti 2023, ndërsa 5 janë në pritje për vitin 2024.	2024
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Zhvillimin e programe specifike për trajtimin e të burgosurve me varësi nga substancat narkotike;</li> </ul>	Ka fillu në Lipjan një program me një OJQ. Kanë përfituar 6 të mitur.	2024 ✓
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të ofrohet trajtim i përshtatshëm për të burgosurit me probleme mendore;</li> </ul>	I pa zbatuar.	2024
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të funksionalizohet Pavioni D në QK Dubravë;</li> </ul>	Është funksionalizuar Pavioni D.	✓
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të sigurohen hapësira të nevojshme për vendosjen dhe trajtimin e grave dhe të miturve me probleme të shëndetit mendor;</li> </ul>	I pa zbatuar.	2024

<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të shtohen kapacitetet akomoduese në Institutin e Psikiatrisë Forenzike;</li> </ul>	I pa zbatuar.	2024
<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Të sigurohet arsim gjithëpërfshirës për të miturit e privuar nga liria;</li> </ul>	Është zbatuar.	✓
<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Të forcohet mekanizmi i brendshëm i ankesave, në aspekt të rritjes së konfidencialitetit;</li> </ul>	I pa zbatuar.	2024
<ul style="list-style-type: none"> <li>➤ Të ndërmerren veprime për respektimin e garancive kundër keqtrajtimit:</li> </ul>		
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të zbatohen në përpikëri procedurat me rastin e përdorimit të forcës;</li> </ul>	Sipas vizitave të QKRMT-së dhe gjetjeve, kjo nuk është realizuar duke marrë parasysh rastet që kanë ndodhur në QKM dhe në QP Prishtinë.	2024
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Në rast të përdorimit të forcës, të burgosurit t'i mundësohet menjëherë qasja tek mjeku, kurse për stafin korrektues të bëhet vlerësim i detajuar mbi nevojën e përdorimit të forcës;</li> </ul>	Sipas vizitave të QKRMT-së dhe gjetjeve kjo nuk është realizuar duke marrë parasysh rastet që kanë ndodhur në QKM dhe në QP Prishtinë.	2024
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Inspektorati i Ministrisë së Drejtësisë të zhvillojë hetime të menjëhershme dhe të detajuara në rastet e pohimeve për keqtrajtimit apo përdorimit të forcës;</li> </ul>	Sipas vizitave të QKRMT-së dhe gjetjeve kjo nuk është realizuar duke marrë parasysh rastet që kanë ndodhur në QKM dhe në QP Prishtinë.	2024

<p>➤ Të zhvillohen politika adekuate për menaxhimin dhe parandalimin e incidenteve mes të burgosurve, vetëlëndimeve, tentim vetëvrasjeve dhe vetëvrasjeve;</p>	<p>Nuk ka pasur suksese në parandalimin e lëndimeve dhe vetëlëndimeve, duke pasur parasysh rritjen e numrit të tyre.</p> <p>Ka pasur sukses në parandalimin e vetëvrasjeve dhe tentim-vetëvrasjeve.</p>	<p>2024</p> <p>✓</p>
<p>➤ Ministria e Drejtësisë dhe ShKK, brenda kompetencave të tyre, të adresojnë çështjen e funksionimit të mirëfilltë të Panelit për Lirim me Kusht;</p>	<p>Sipas të dhënave të ShKK-së, gjatë vitit 2023 rreth 50% e rasteve janë liru përmes Panelit për Lirim me Kusht.</p>	<p>2024</p> <p>✓</p>
<p>➤ Të shtohen trajnimet profesionale për të dënuarit si dhe aktivitetet ku ata mund të angazhohen gjatë kohës së lirë;</p>	<p>Janë shtuar disa aktivitete.</p>	<p>2024</p> <p>✓</p>
<p>➤ Të ndërmerren veprime lidhur me parandalimin e korrupsionit;</p>	<p>Gjatë vitit 2023 ka pasur 14 raste të largimeve nga puna për shkak të korrupsionit dhe në çdo institucion korrektues janë punësuar zyrtarët për sinjalizim</p>	<p>2024</p> <p>✓</p>
<p>➤ Të planifikohet ndërtimi i objekteve të reja për institucionet korrektuese: Qendrën Korrektuese për Femra, Qendrën e Paraburgimit në Pejë, Qendrën e Paraburgimit në Prizren;</p>	<p>Është ndarë buxheti dhe ka filluar projektimi i këtyre objekteve.</p>	<p>✓</p>

➤ Të krijohen hapësira të veçanta për gratë shtatzëna dhe nënat me fëmijë brenda institucioneve korrektuese;	Ka filluar ndërtimi i objektit të ri.	✓
➤ Të mirëmbahen dhe rinovohen sipas nevojës të gjitha institucionet korrektuese;	Ka pasur renovime në disa Pavione.	2024
➤ Të sigurohet qëndrueshmëri në menaxhimin e ShKK-së dhe institucioneve korrektuese;	Në 50% të institucioneve janë emëruar drejtorët.	2024 ✓
➤ Të shtohet numri i stafit civil dhe zyrtarëve korrektuese si dhe të përmirësohen kushtet e punës për ta;	Kanë filluar punën 45 oficerë korrektuese dhe ka filluar rekrutimi i 70 oficerëve korrektues.	2024 ✓
➤ Të nxjerrën të gjitha Udhëzimet Administrative që dalin nga Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale;	Gjatë vitit 2023 janë nxjerrë 12 Udhëzime Administrative, ndërsa pritet të miratohen edhe 8 të tjera.	
➤ Të rishikohet Rendi shtëpiak dhe të përshtatet sipas llojeve të institucioneve korrektuese.	Është nxjerrë Rendi Shtëpiak i ri, mirëpo nuk është realizuar rekomandimi sa i përket përshtatjes sipas llojeve të institucioneve korrektuese.	2024 ✓

**Publikimet 2024:**  
Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve  
të Torturës (QKRMT), Prill 2024.

**Kontakti:**  
QKRMT  
Rr.Hamëz Jashari 16b/2  
10000 Prishtinë, Kosovë  
Tel: +383 (0) 38 243 707  
E-mail: info@krct.org  
Web-faqja: www.krct.org

**Katalogimi në botim – (CIP)**  
**Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”**

343.26 (496.51)“2023”(047)

Haliti, Fatmire

Të drejtat e njeriut në institucionet korrektuese në Kosovë : raport monitorimi -2023 / Fatmire Haliti. - Prishtinë : Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës, 2024. - 128 f. : ilustr. ; 28 cm.

**ISBN 978-9951-774-14-7**





ISBN 978-9951-774-14-7



9 789951 774147